



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Divjakë

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË DIVJAKË

Tiranë, 2023

PËRMBAJTJA

SHKURTIME.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	18
II. HYRJE.....	21
1. Objekti i Auditimit.....	21
2. Qëllimi i auditimit.....	21
3. Identifikimi i çështjes.....	22
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	22
5. Përgjegjësitë e audituesve	22
6. Kriteret e vlerësimit	23
7. Standardet e auditimit	25
8. Metodat e auditimit	25
9. Dokumentimi i auditimit.....	26
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	28
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Divjakë	28
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	29
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	29
2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	39
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.....	58
2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	78
2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.....	102
2.6. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	106
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	115
A. MASA ORGANIZATIVE.....	115
B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE T	125
C. MASA DISIPLINORE	128
D. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL	131

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Divjakë dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Divjakë nga data 01.07.2021 deri në datën 30.09.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 8 Akte Konstatimi dhe 1 Akt Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi në Bashkinë Divjakë, mbi funksionimin dhe veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm gjatë vitit 2021, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sektori i auditimit të brendshëm ka dy punonjës, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës. - Nuk është kryer auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. - Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit. - Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se nuk është planifikuar kryerja e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. - Në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2021 nuk është dhënë opinion i auditimit. - Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, Prokurimet publike etj. - Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësisë publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e sektorit të auditimit të brendshëm. 	<p>Pika 2.1., faqe 29-39</p>	E lartë	<p>1. Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në njësinë e auditimit të brendshëm Divjakë, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.</p> <p>2. Njësia e Auditimit të Brendshëm, Divjakë, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk të lartë, siç janë ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkinë Divjakë.</p> <p>3. Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Divjakë, të marrë masa për të arkivuar në</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me shkronjën “ç” të nenit 6, nenin 13, shkronjën “ç” të nenit 14 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020 të MFE “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.</p>			<p>arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.</p> <p>4. Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Divjakë, të marrë masa që çdo vit të kryejë auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe këshillave për titullarin e njësisë publike, nëse sistemet e MFK janë ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit financiar.</p>
2	<p>Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit rezultoi si vijon:</p> <p>1. Niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2021 paraqitet i realizuar në vlerën 805,745 mijë lekë nga 1,056,589 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 76%. Në nivelin e realizimit të buxhetit ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të të ardhurave për vitin 2021 i cili paraqitet në 44%. Për periudhën Janar-Shtator 2022 paraqitet i realizuar në vlerën 540,220 mijë lekë nga vlera 767,543 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 70%.</p> <p>2. Në fund të 9 mujorit 2022 (30.09.2022), Bashkia Divjakë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlerën 63,690,532 lekë. Ndërsa detyrimet nga buxheti i shtetit janë në vlerën 4,154,257 lekë. Nga analiza e detyrimeve të prapambetura në fund 9 mujorit 2022 (30.09.2022), janë të pa likuiduara gjithsej 149 raste me vlerë 49,698,550 lekë. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 32,200,102 lekë. 37 fatura për mallra në vlerën 6,725,906 lekë. 78 fatura për shërbime në vlerën 6,169,113 lekë. 4 vendime gjyqësore në vlerë 4,603,429 lekë. <p>3. Për vitin 2022 janë planifikuar fonde për projekte dhe investime në shumën 166,252 mijë lekë, me burim financimi nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar. Aktualisht Bashkia Divjakë ka 41 kontrata të lidhura që nga viti 2018-2022 me vlerë totale 902,972,468 lekë, ku 3 kontrata janë për afate që përfshijnë vitin 2023 dhe 2024 për likuidim. Për të gjitha këto kontrata është likuiduar deri më 31.12.2020 vlera 217,033,450 lekë, gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 196,789,674 lekë, deri më</p>	<p>Pika 2.2., faqe 39-58</p>	<p>E lartë</p>	<p>Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtorja e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të palikuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>30.09.2022 është likuiduar vlera 75,122,971 lekë dhe mbetet ende për t'u likuiduar vlera 39,326,998 lekë që i përket kontratave të përfunduara.</p> <p>Vlera e detyrimeve të prapambetura më 30.09.2022 është 9.85% e shpenzimeve vjetore të miratuara.</p>			
3	<p>Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave në Bashkinë Divjakë u konstatua se për vitin 2021 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat paraqitet në masën 44%, nga 316,869 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 139,357 mijë lekë, ose 117,512 mijë lekë më pak. Niveli i ulët i realizimit i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat ka ardhur si rezultat i:</p> <p>1. Mos planifikimi i saktë i të ardhurave sipas zërave. Lidhur me planifikimin e taksave të ndara apo atyre që vilen nga agjentët tatimore si tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale, taksa mbi automjetet e përdorura, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore në Bashkinë Divjakë nuk ka një bazë të dhënash të subjekteve që duhet të paguajnë këtë detyrim.</p> <p>2. Mosmarrjen e masave të duhura ligjore ndaj taksapaguesve familjarë dhe privat për mos pagesën e taksave dhe tarifave në mënyrë vullnetare brenda afatit.</p> <p>Procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar si duhet. Nuk ka dokumentacion të plotë lidhur me kërkesat që Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore dërgon për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar të dhëna lidhur me planifikimin e të ardhurave vjetore. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DTV për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “<i>Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021</i>” dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “<i>Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022</i>”.</p>	<p><i>Pika 2.2., faqe 39-58</i></p>	E lartë	<p>Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë.</p> <p>Të marrë masa që të vendosë një korrespondencë me institucionet e tjera që administrojnë të dhënat lidhur me taksat e ndara me qëllim marrjen prej tyre të informacionit të duhur për të bërë një planifikim sa më të saktë të të ardhurave për këto taksa. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.</p>
4	<p>Administrimi i dokumentacionit dhe procesi i menaxhimit të të ardhurave nga taksapaguesit privat dhe abonentët familjarë në Bashkinë Divjakë kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk ka regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë</p>	<p><i>Pika 2.2., faqe 39-58</i></p>	E lartë	<p>Bashkia Divjakë të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit , ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifatat</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>strukturat e Bashkisë Divjakë i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistruar në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.</p> <p>Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTAV që mund të rezultojë në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike të kompjuterave me pasojë humbjen e të dhënave të DTAV. Gjithashtu, administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; neni 4, zbatimimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë”.</p>			<p>vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.</p>
5	<p>1. Nga krahasimi i pasqyrave financiare hartuara nga Bashkia Divjakë, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 5,329,592,175 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 5,239,247,615 lekë, me një diferencë prej 90,344,560 lekë më pak në PF në subjekt. Kjo diferencë tregon se në sistemin e thesarit nuk është paraqitur vlera 90,344,560 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo diferencë korrespondon në Pasivin e Bilancit me shumën e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 30,589,616 lekë dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”, në vlerën 59,754,945 lekë.</p> <p>2. Nga auditimi, u konstatua se llogaria 215 “Mjete transporti” është shtuar për vlerën neto 62,201,067 lekë, për makineri dhe pajisje sipas Aneksit PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilat i përkasin llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, e cila është pakësuar për të njëjtën vlerë. Sa më sipër, këto dy llogari të aktivitetit nuk paraqesin vlerën reale.</p> <p>3. Nga verifikimi i regjistrave të aktiveve, u konstatua se për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, paraqiten probleme në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e</p>	Pika 2.3., faqe 58-78	E lartë	<p>1. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.</p> <p>2. Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësive, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>3. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Divjakë të merren masa për</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunitat. Regjistrat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për këtë arsye, vlera e këtyre dy llogarive (214 dhe 215) në pasqyrat financiare, nuk jep siguri të arsyeshme se është e saktë.</p> <p>4. Nga Bashkia Divjakë nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të aseteve, përkatësisht në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” dhe rrjedhimisht nuk është kryer marrja në dorëzim, kolaudimi, vlerësimi, nuk është kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, nuk është aplikuar në ASHK Lushnjë për regjistrimin e të gjitha aseteve, resurseve dhe pasurive të tjera, si dhe nuk është bërë regjistrimi në kontabilitet i këtyre pasurive veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikat 37, 42-60, 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.</p> <p>5. Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të ardhurat dhe debitorët nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitorë të familjarëve, bizneseve, etj, nuk janë kontabilizuar në mënyrë të saktë dhe të plotë. Në listën e debitorëve mungojnë disa persona të cilët janë gjobitur nga IMTV, lista e debitorëve progresivë, e disponueshme në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore mbyllet me numër rendor 418, ndërkohë që lista analitike e kontabilitetit mbyllet me numër rendor 162, etj. Gjithashtu, konstatohet se nuk janë përlllogaritur dhe kontabilizuar kamatëvonesat.</p>			<p>nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transport”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.</p> <p>4. Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH, duke llogaritur edhe kamatëvonesat përkatëse. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”.</p>
6	<p>Gjendja e llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 99,323,241 lekë për llogarinë 231, në total 99,148,142 lekë. Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 497,139,142 lekë, të cilat janë me fonde të deleguara. Vlera e kontraktuar (me TVSh), për investimet në</p>	Pika 2.3., faqe 58-78	E lartë	<p>1. Drejtoria Ekonomike dhe e Financës të marrë masa për analizimin e saktë dhe sistemimin e vlerave me saktësi sipas posteve në bilancin kontabël, për llogaritë 230/231 “Investime në proces”.</p> <p>2. Drejtoria Ekonomike dhe e</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>proces gjatë vitit 2021 është 497,148,142 lekë, nga të cilat 496,126,333 lekë për objektin “Furnizim me ujë për zonat bregdetare Remas, Bashkia Divjakë” me kontratë nr. 360/12 datë 02.04.2021 me operator ekonomik “A.C.” shpk dhe 1021,809 lekë për “Mbikëqyrje punimesh për objektin furnizim me ujë zonat bregdetare Remas”, me kontratë nr. 545/1 datë 01.04.2021, me operator C.E.C.G..</p> <p>Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2021 nuk paraqet vlerën reale, pasi duhet të pasqyronin vlerën 497,139,142 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Divjakë.</p> <p>Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.</p> <p>Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32, etj. Investimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2021, janë paraqitur në Aneksin PF24, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p>			<p>Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve kontabël duke respektuar të gjitha hapat e regjistrimit në kontabilitet, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”. - Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”. - Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”. - Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues. - Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				<p>“Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.</p> <p>- Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivitetet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.</p>
7	<p>Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021 ka qenë 30,589,616 lekë ose me rritje në vlerën 8,026,368 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë Divjakë ndaj subjekteve për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga verifikimi analitik i llogarisë 466 rezulton një diferencë prej 116,905 lekë e pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare. Për sa më sipër, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk paraqet vlerën e saktë.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.</p>	Pika 2.3., faqe 58-78	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejohet likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhblokimin e fondeve të ngurtësuar.</p>
8	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022 për punë publike dhe mallra, rezulton se në 5 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me tipologjinë e objektit të prokuruar dhe kontratës së lidhur. Veç sa më sipër, në përbërjen e NJP dhe KVO, për 2 raste është konstatuar mungesa e specialistëve të fushës, në përputhje me objektin e prokurimit, ndërsa në 1 rast rezulton se ka pasur copëzim të fondeve dhe shmangie nga procedurat standarde të prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, 3 të nenit 34, neni 73, pika 1 në nenin 80, pika 3 në nenin 92, shkronja “d” në pikën 1 në</p>	Pika 2.4., faqe 78-103	E lartë	<p>1. Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e NJP dhe KVO, të ketë specialist të fushës në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që vendimmarrja, menaxhimi dhe vlerësimi të jenë objektiv.</p> <p>2. Njësia e Prokurimit Bashkia Divjakë të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.</p> <p>3. Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat e nevojshme, për eliminimin</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	nenin 98 në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Nenin 73, pika 2 e nenit 74, paragrafi 1 i nenit 75, pika 2 në nenin 76, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.			e copëzimit të fondeve në procedurat e prokurimit publik.
9	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, rezultoi se në 2 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe shkronjën “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.	Pika 2.4., faqe 78-103	E lartë	Kryetari i Bashkisë Divjakë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetin e institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.
10	<p>1. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit: Shtesë anësore + shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat, me zhvillues A.M. adresë Tërbuf, Rikonstruksion dhe shtesë anësore + shtesë kati 1 kat, me zhvillues A.S. adresë Babunjë, Shtëpi banimi 1 kat në A.Z., adresë Divjakë, rezultoi se nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës.</p> <p>2. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit: Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve bujqësore, me zhvillues F.K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf si dhe Magazinë bujqësore me zhvillues R. ShPK, adresë fshati Mizë, rezultoi se nuk është respektuar intesiteti i lejuar sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, të miratuar për lejet e ndërtimit.</p> <p>3. Nga auditimi i lejes së ndërtimit: Godinë bujtinë 2 kate + papafingo, me zhvillues D.T., me adresë Kamenicë, Divjakë, rezultoi se nuk është marrë mendim pozitiv nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi” pika “ë”, neni 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës” dhe neni 38 “Intesiteti i ndërtimit”.</p>	Pika 2.5., faqe 103-107	E lartë	Nga ana e DPZHTK, Bashkia Divjakë, të merren masa që në lejet e ndërtimit të respektohet distanca e lejuar nga kufiri i pronës, si dhe intesiteti i lejuar, sipas planit të përgjithshëm vendor dhe legjisllacionit në fuqi.
11	<p>Nga auditimi i lejes së ndërtimit “Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve bujqësore me zhvillues F.K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf”, rezultoi se:</p> <p>1. Objekti i ndërtuar nuk ka zbatuar plotësisht projektin e miratuar, duke u pajisur dhe me</p>	Pika 2.5., faqe 103-107	E lartë	<p>1. Nga ana e DPZHTK, Bashkia Divjakë, të merren masa për të mos miratuar certifikatë përdorimi për objekte të cilat nuk kanë respektuar projektin e miratuar.</p> <p>2. Nga ana e IMT të merren masa</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Certifikatë përdorimi, në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27 “Certifikata e përdorimit”.</p> <p>2. Në lidhje me zbatimin e projektit të miratuar u konstatuan ndryshime në fasadë dhe volume, konkretisht në pjesën anësore nuk është respektuar vendosja e dritareve sipas projektit të miratuar dhe në fasadën ballore, në pjesën e majtë ka një shtesë volumi e cila nuk paraqitet në projektin e miratuar. Nga ana e IMT Bashkia Divjakë nuk është mbajtur asnjë procedurë në lidhje me këto ndryshime të projektit të miratuar me zbatimin e tij në terren në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”.</p>			<p>për tu inspektuar të gjithë objektet të cilat janë me leje ose pa leje ndërtimi dhe të vazhdojë procedurat ligjore për objektet të cilat kanë shkelur lejen e ndërtimit dhe ato pa leje.</p>
12	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 57 rekomandime të dhëna janë pranuar plotësisht nga subjekti, ndërsa 28 rekomandime ose 49% prej tyre janë zbatuar.</p> <p>Nga 20 masa organizative të rekomanduara janë zbatuar 8, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces zbatimi 4 dhe nuk janë zbatuar 6 prej tyre.</p> <p>Nga 2 masa për shërblim dëmi të rekomanduara në vlerën 9,867 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, por nuk janë zbatuar.</p> <p>Nga 6 masa për eliminimin e efekteve negative financiare në menaxhimin e fondeve publike të rekomanduara në vlerën 552,673 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, 1 masë është zbatuar, 2 janë në proces zbatimi në vlerën 481,313 mijë lekë, 1 masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 28,000 mijë lekë dhe 2 masa nuk janë zbatuar në vlerën 120,000 mijë lekë.</p> <p>Nga 19 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 19.</p> <p>Nga 10 masa administrative të rekomanduara në vlerën 6,100 mijë lekë, në zbatim të shkresës së APP për mangësi të evidentuara, rezulton se nga titullari i institucionit nuk janë nxjerrë urdhërat për arkëtimin vullnetar të gjobave, si dhe nuk janë marrë masat për arkëtimin e vlerës, rekomandimi nuk është zbatuar.</p>	<p>Pika 2.6., faqe 107-116</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përshpejtimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 686/22 datë 07.01.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Divjakë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.</p>
13	<p>Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 174 qytetarë me vlerë totale 8,009,732 lekë, ndërsa për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin 25 qytetarë me vlerë totale 1,091,511 lekë. Gjithashtu, nuk kanë paguar ende</p>	<p>Pika 2.2., faqe 39-58</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masat e duhura ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 615 debitorë në vlerën 23,245,985 lekë, si dhe në vijimësi për të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë të bashkëpunohet me Agjencinë</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>detyrimin 416 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 me vlerë totale 14,144,742 lekë. Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në 23,245,985 lekë për 615 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021”, dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”.</p>			<p>Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.</p>
<p>14</p>	<p>Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Divjakë rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën 86,473,273 lekë dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifatat për personat fizikë/juridikë, detyrimet nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet dhe detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e vaditjes.</p> <p>Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive në Bashkisë Divjakë më datë <u>31.12.2021</u> janë në vlerën 440,270,998 lekë.</p> <p>Më datë <u>30.09.2022</u> janë në vlerën 507,492,800 lekë të përbëra nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Detyrime për taksën e ndërtesës në vlerën 31,869,336 lekë; - Detyrime për taksën e tokës bujqësore në vlerën 326,826,181 lekë; - Detyrime nga taksa e truallit në vlerën 1,204,743 lekë; - Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 32,823,179 lekë; - Detyrime nga biznesi i madh në vlerën 8,664,192 lekë; - Detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.) në vlerën 104,945,289 lekë; - Detyrime nga tarifa e ujitjes në vlerën 409,050 lekë. <p>Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se deri më datë 31.12.2021 shuma e arkëtuar nëpërmjet Ujësllësisë Kanalizime SH.A Divjakë në rolin e agjentit tatimor të bashkisë është 1,368,100 lekë dhe detyrime progresive që Ujësllësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë 1,754,400 lekë. Deri më datë</p>	<p>Pika 2.2., faqe 39-58</p>	<p>E lartë</p>	<p>Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën totale 507,492,800 lekë, e përbërë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 31,869,336 lekë detyrime për taksën e ndërtesës; - 326,826,181 lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore; - 1,204,743 lekë detyrime nga taksa e truallit; - 32,823,179 lekë detyrime nga biznesi i vogël; - 8,664,192 lekë detyrime nga biznesi i madh; - 104,945,289 lekë detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.); - 409,050 lekë detyrime nga tarifa e ujitjes. <p>a- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.</p> <p>b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	30.09.2022 sipas akt rakordimit shuma e arkëtuar për taksat e bashkisë është 1,033,000 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë në vlerën 2,684,100 lekë .			<p>c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.</p> <p>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DTAV të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p> <p>e- DTAV të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Divjakë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</p> <p>f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</p> <p>Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për të koordinuar punën me strukturat e Ujësjetllësit me qëllim kalimin e detyrimeve që ky i fundit ka ndaj Bashkisë Divjakë për taksat dhe tarifatat e arkëtuara për llogari të bashkisë.</p>
15	<p>Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Divjakë, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 19 subjekte. Këto subjekte përpara fillimit të aktivitetit pajisen me autorizimet përkatëse, referuar kuadrit ligjor në fuqi për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje. Lidhur me pagesën e autorizimit Bashkia Divjakë përgjithësisht për subjektet që nuk kanë paguar menjëherë të gjithë vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite, ka ndjekur praktikën e pagesës me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë duke i pajisur ato me autorizime 1 vjeçare.</p> <p>Nga auditimi rezulton se:</p> <p>1. Subjekti “M.” është pajisur me autorizim 5 vjeçar më datë 11.02.2020 dhe është dakordësuar për të kryer pagesën e autorizimit me këste vjetore 200,000 secili. Nga auditimi rezulton se, subjekti ka kryer</p>	<i>Pika 2.2., faqe 39-58</i>	E lartë	<p>1. Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e gjyqësore në arkëtimin e vlerës 1,000,000 lekë, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlera 800,000 lekë në ngarkim të subjektit “M.”. - Vlera 200,000 në ngarkim të subjektit “M.S.F. SHPK”. <p>2. Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Juridik Bashkia Divjakë, të ndjekin të gjitha hapat ligjore ndaj subjekteve “K.O. SHPK” dhe “L. ShPk” me qëllim fillimin e aktivitetit vetëm pas pajisjes me autorizimin përkatës dhe kryerjes së pagesave</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>vetëm një pagesë deri në Nëntor 2022 nga 3 pagesa që duhet të bënte. Vlera totale e detyrimit ndaj Bashkisë Divjakë është 800,000 lekë.</p> <p>2. Subjekti “K.O. SHPK” ka qenë i pajisur me autorizim deri më datë 04.12.2020 në vijim nuk është pajisur me autorizim të ri për ushtrimin e aktivitetit. Subjekti “K.O. SHPK” ka paguar një vlerë prej 100,000 lekë në vitin 2022 por nuk është pajisur me autorizim. Detyrimet që ka ndaj bashkisë për autorizimin janë në vlerën 900,000 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë. Për subjektin K.O. ShPk nga Bashkia Divjakë është dërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare në të gjitha bankat e nivelit të dytë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë është bllokuar aktiviteti me urdhrin nr. 180 datë 11.10.2022.</p> <p>3. Subjekti “M.S.F. SHPK” nuk ka paguar vlerën prej 200,000 lekë për vitin 2022.</p> <p>4. Subjekti “L. ShPk” që nga viti 2020 nuk është i pajisur me autorizim, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën 1,000,000 lekë. Për subjektin L. ShPk është dërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare të gjitha bankave të nivelit të dytë, si dhe është bërë bllokimi i aktivitetit nga Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore me urdhrin nr. 182 datë 11.10.2022.</p> <p>Për periudhën objekt auditimi është konstatuar se subjektet “M.”, “K.O. SHPK”, “M.S.F. SHPK”, “L. ShPk” kanë ushtruar aktivitet në kundërshtim me përcaktimet ligjore duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën totale 2,900,000 lekë.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie të licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.</p>			<p>për llogari të bashkisë për shumën 1,900,000 lekë, nga e cila:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlera 900,000 lekë nga subjekti “K.O. SHPK SHPK”. - Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “L. SHPK. <p style="text-align: right;"><i>Menjëherë</i></p> <p>3. Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të ndërpresë praktikën e ndarjes e këste të pagesës së tarifës për licencat/autorizimet.</p>
16	<p>Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Divjakë gjatë vitit 2021 ka konstatuar 23 raste të shkeljes së legjislacionit në fushën e mbrojtjes së territorit. Për këto raste janë mbajtur proces verbalet përkatëse të konstatimit të kundërvajtjes ku në 22 raste është vendosur masa administrative “gjobë” me vlerë 500,000 lekë për secilin kundërvajtës, ndërsa në 1 rast është marrë vendim për pezullim punimesh. Vlera totale e gjobave të vendosura është 11,000,000 lekë. Për gjobat e vendosura në vitin 2021 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, Kryeinspektori i</p>	Pika 2.2., faqe 39-58	E lartë	<p>Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të ndjekin të gjitha hapat për të dërguar në gjykatë 22 gjobat e vendosura me qëllim shndërrimin e tyre në “titull ekzekutiv”, si dhe të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e gjobave të papaguara për vitin 2021 në vlerën 11,000,000 lekë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>IMTV në bashkëpunim me Sektorin Juridik nuk ka ndjekur procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimit të tyre. Përkatësisht, IMTV dhe Sektori Juridik nuk kanë “dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë”, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, rrjedhimisht nuk kanë ndjekur as hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë. Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, në vlerën 6,600,000 lekë.</p> <p>Si rezultat, për vitin 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 17,600,000 lekë (11,000,000 nga gjobat dhe 6,600,000 nga kamatëvonesat).</p>			
17	<p>Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit. - Nuk është hartuar “Harta e procesit për proceset kryesore të veprimtarisë së institucionit”. - Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut. - Nuk është miratuar plani i zhvillimit strategjik me afat 5 vjeçar. - Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të liçencuara. - Drejtoria e Financës nuk përdor program të licencuar për mbajtjen e kontabilitetit por operon me programin “EXCEL” ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.</p>	Pika 2.1., faqe 29-39	E mesme	<p>1. Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të bashkisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin 2 herë në vit të risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.</p> <p>2. Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investime në programe kompjuterike të liçencuara (për mbajtjen e kontabilitetit) në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve të brendshme për ngritjen profesionale të stafit.</p>
18	<p>Bashkia Divjakë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi, ka</p>	Pika 2.2.,	E mesme	<p>Bashkia Divjakë të marrë masa që qiramarrësit P.M., H.M., L. SHPK,</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	lidhur 12 kontrata për dhënien me qira të tyre me qëllim krijimin e të ardhurave. Këto kontrata janë lidhur me afat kohor nga 1-20 vjet. Nga auditimi rezulton se pagesat e qirasë për vitin 2021 janë kryer rregullisht nga të gjithë qiramarrësit, ndërsa për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë 4 qiramarrës (P.M., H.M., L. SHPK, F.S.), me vlerë totale të detyrimit 1,159,880 lekë . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kushteve të kontratave përkatëse.	faqe 39-58		F.S. të zbatojnë me përpikmëri kushtet e kontratave me qëllim pagesën e detyrimeve për qiranë në afat. Për qiramarrësit që tejkalojnë afatet e pagesës të aplikohet kamatëvonesa referuar kushteve të kontratave.
19	Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat e ndjekura për hartimin e PBA-së dhe dokumentimit të procesit rezulton se: - Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave; - Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve; - Nuk është dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik; - Në dokumentin e PBA-së nuk janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, nuk janë analizuar risqet financiare dhe fiskale të bashkisë, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.	Pika 2.2., faqe 39-58	E mesme	Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Financës e Buxhetit, të marrin të gjitha masat që për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm: - Të dërgojnë për miratim në Këshillin Bashkiak raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave; - Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së; - Procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së dhe puna e bërë nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të dokumentohet në çdo fazë; - Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë, të cilat cenojnë drejtpërdrejt arritjen e objektivave të bashkisë.
20	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, rezultoi se: Në 8 raste nuk dokumentohet përllogaritja e fondit limit; Në 9 raste dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit përcaktuar në ftesën për ofertë, si dhe një 1 rast nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion; Në 6 raste OE shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret fituese të kërkuara nga AK; Në 6 raste nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit nga operatori ekonomik, si dhe nuk janë llogaritur penalitetet për mosdorëzimin e mallit në afat sipas afatit të kontratave. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në	Pika 2.4., faqe 78-103	E mesme	Kryetari Bashkisë Divjakë dhe komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që të dokumentojë çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve. Në rastet kur OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura nga AK, duhet të bëhet skualifikimi dhe kalimi tek operatori ekonomik i radhës. Gjithashtu në rastet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, të bëhet verifikimi i formës dhe përmbajtjes së tij, si dhe të llogariten penalitetet për mos dorëzimin e mallit në afat sipas kontratave.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>Republikën e Shqipërisë</i>”, i ndryshuar, neni 52. Gërma “dh”, “ë”, “gj” të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “<i>Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike</i>”, i ndryshuar. Shkronjën “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “<i>Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës</i>”. Neni 12, 13 i Normave Teknike Profesionale për Arkivat.</p>			

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i modifikuar (kualifikuar) mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Divjakë, për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre, si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar (kualifikuar)** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Divjakë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, “*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*”, si dhe ISSAI 30 “*Kodi Etik*” apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 “*Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n*”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përparatjen e opinionit të kualifikuar të auditimit. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2021 ka marrë në konsideratë vlerën e materialitetit **10,415,408** lekë për shpenzimet dhe **8,507,870** lekë për të ardhurat.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

1. Nga krahasimi i pasqyrave financiare hartuara nga Bashkia Divjakë, me Pasqyrat Financiare në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 5,329,592,175 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 5,239,247,615 lekë, me një diferencë prej 90,344,560 lekë më pak në PF në subjekt. Kjo

diferencë tregon se në sistemin e thesarit nuk është paraqitur vlera 90,344,560 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo diferencë korrespondon në Pasivin e Bilancit me shumën e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 30,589,616 lekë dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”, në vlerën 59,754,945 lekë.

2. Nga auditimi, u konstatua se llogaria 215 “Mjete transporti” është mbivlerësuar për vlerën neto 62,201,067 lekë, për makineri dhe pajisje sipas Aneksit PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilat i përkasin llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, e cila është nënvlerësuar për të njëjtën vlerë. Sa më sipër, këto dy llogari të aktivitetit nuk paraqesin vlerën reale.

3. Nga verifikimi i regjistrave të aktiveve, u konstatua se për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Regjistrat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për këtë arsye, vlera e këtyre dy llogarive (214 dhe 215) në pasqyrat financiare, nuk jep siguri të arsyeshme se është e saktë.

4. Nga Bashkia Divjakë nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të aseteve, përkatësisht në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” dhe rrjedhimisht nuk është kryer marrja në dorëzim, kolaudimi, vlerësimi, nuk është kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, nuk është aplikuar në ZVRPP/ASHK Lushnjë për regjistrimin e të gjitha aseteve, resurseve dhe pasurive të tjera, si dhe nuk është bërë regjistrimi në kontabilitet, i këtyre pasurive, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikat 37, 42-60, 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

5. Gjendja e llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet 99,323,241 lekë. Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 497,139,142 lekë, të cilat janë me fonde të deleguara. Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2021 nuk paraqet vlerën reale, pasi duhet të pasqyronin vlerën 497,139,142 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Divjakë.

6. Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021 ka qenë 30,589,616 lekë ose me rritje në vlerën 8,026,368 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë Divjakë ndaj subjekteve për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga verifikimi analitik i llogarisë 466 rezultoi një diferencë prej 116,905 lekë e pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare. Për sa më sipër, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk paraqet vlerën e saktë.

II. Opinion i modifikuar (kualifikuar) për përputhshmërinë:

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Divjakë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që

lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Divjakë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Divjakë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “*Baza për Opinionin*”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar (kualifikuar) të përputhshmërisë.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme¹ për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000) si më poshtë:

1. Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Divjakë rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën **86,473,273 lekë** dhe përbëhet nga detyrimet që kanë taksapaguesit privat dhe familjar për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë edhe detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e vaditjes.

Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive në Bashkisë Divjakë më datë 31.12.2021 janë në vlerën **440,270,998 lekë**.

2. Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022 për punë publike dhe mallra, u konstatua se në 5 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veç sa më sipër, në përbërjen e NJP dhe KVO, për 2 raste është konstatuar mungesa e specialistëve të fushës, në përputhje me objektin e prokurimit.

3. Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, u konstatua se në 2 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.

4. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, u konstatua se:

Në 8 raste nuk dokumentohet përllogaritja e fondit limit;

Në 9 raste dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit të përcaktuar në ftesën për ofertë, si dhe një 1 rast nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion;

Në 6 raste rezulton se OE shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret fituese të kërkuara nga AK;

Në 6 raste nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit nga operatori ekonomik.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Divjakë:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financiare dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5,

¹ ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “*Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme*”

datë 21.02.2022, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 886/1, datë 03.10.2022 “*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Divjakë*”, i ndryshuar me shkresën nr. 886/2, datë 03.11.2022, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Divjakë nga data 05.10.2022 deri në datën 18.11.2022, u krye “*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*”, për periudhën nga data 01.07.2021 deri më 30.09.2022, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., *Përgjegjës Grupi*;
2. E.V.;
3. E.R.;
4. A.G. dhe
5. A.Z., *anëtarë*.

1. Objekti i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e

raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Divjakë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. F.K., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. F.M., Drejtore i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe

vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Divjakë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;
- VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”;
- VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e

- *qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e prokurimeve publike:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- Ligji Nr. 107-2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodatat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe

- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- **Kontrolli aritmetik**

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese**

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

- **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- **Intervista**

- **Raporte dhe Informacione**

- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në

përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Divjakë

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Divjakës, i shpallur qytet me vendim qeverie në vitin 1996.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34,254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezultojnë një popullsi 53,372 banorësh. Territori i bashkisë së re është 309.58 km² dhe me densitet popullsie 172.40 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Divjakës përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Rremas është e dobët. Një pjesë e territorit të kësaj bashkie është parku kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës. Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore. Divjaka ka perspektivë të mirë për zhvillimin e turizmit detar si dhe ekoturizmit. Gjatë viteve të fundit është shfaqur turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje në lagunën e Karavastasë. Turizmi është zhvilluar më së shumti për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.²



Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative aktuale është miratuar me VKB nr. 66, datë 28.12.2021 dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 315, datë 30.12.2021 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Divjakë, Institucioneve në varësi dhe Njësi Administrative dhe Funksionet e deleguara për vitin 2022”, me ndryshime. Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 300 datë 29.12.2020. Numri i miratuar i punonjësve të Bashkisë Divjakë, funksioneve të transferura dhe gjendjes civile ka qenë 462 punonjës.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësi	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Divjakë	Qyteti Divjakë Fshatrat: Mizë, Xengë, Germenj i Madh, Germenj i Vogël, Hallvaxhias, Bregas, Dushk Cam, Zharnec, Bishtçukas.
Tërbuf	Fshatrat: Çermë Shkumbin, Çermë Proshkë, Sulzotaj, Çermë e Sipërme, Tërbuf, Shënepremte, Çermë Pasha
Grabjan	Fshatrat: Grabjan, Stravec, Ferras
Gradishtë	Fshatrat: Këmishtaj, Mertish, Gorica, Sopës, Fier Seman, Gradishtë, Gungas, Spolet, Babunjë
Remas	Fshatrat: Remas, Muçias, Karavasta Fshat, Gure, Kryekuq, Kamenicë, Karavasta e re, Adriatik

Kuadri ligjor:

Bashkia Divjakë e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për

² Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-divjake/pasaporta-e-bashkise-divjake/>

secilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Divjakë është z. F.K. dhe Këshilli Bashkiak i Divjakës përbëhet nga 31 anëtarë, të cilët janë mandatuar në shtator 2019.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Divjakë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

- Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

- Për periudhën objekt auditimi 2021-2022, ka pasur dy Rregullore të Brendshme, përkatësisht Rregullore e Brendshme miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Divjakë nr. 248, datë 25.10.2018, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me Urdhërin nr. 120/1, datë 23.03.2022.

Nuk është miratuar Kodi i Etikës, por rregullat mbi etikën përshkruhen në rregulloren e brendshme në nenin 19, Kreu III. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore, komunikimi mbi rregulloren e brendshme është kryer verbalisht.

- Për ndëshkimin e rasteve korruptive ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjisllacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nga institucioni nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Informacionit dhe Marrdhënieve me Publikun), duke i'u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga

Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 16, Kreu III të Rregullores së Brendshme.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Për vitin 2021-2022 janë kryer vlerësimet e punonjësve.

Në lidhje me parimin 2: *“Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.*

- Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Për vitin 2022, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga struktura në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe rrisqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi të fondeve të alokuara.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3: *“Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.*

- Në rregulloren e brendshme, janë të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht sektori i menaxhimit të kontratave me sektorin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shkëmbimin e informacionit sa kontrata për punë publike janë lidhur, subjektet, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Divjakë apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave.

Për vitin 2021, numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 63 datë 28.12.2020. Miratuar në total numri 475 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara konfirmuar nga prefekti i qarkut Fier me shkresën nr. 8/1 prot., datë 12.01.2021, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 462 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 315 datë 30.12.2021. Miratuar në total numri 462 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara konfirmuar nga prefekti i qarkut Fier.

- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

- Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

Në lidhje me parimin 4: *“Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.*

- Në Bashkinë Divjakë nuk është hartuar *“Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”*, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme, por vetëm trajnimet e zhvilluara nga ASPA.

- Për Bashkinë Divjakë Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, si dhe Zëvendëskryetari për dy funksione (autorizuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhër nr. 38 datë 31.01.2022) i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtore e Financës dhe Buxhetit.

Në lidhje me parimin 5: “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

- Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin i institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi nuk ka patur raste të delegimit të detyrave.

Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”.

Për vitin 2022, me Urdhër të kryetarit të Bashkisë nr. 37 datë 31.01.2022 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Bashkia Divjakë nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Nuk administrohen proçesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”.

- Nga Bashkia Divjakë përcaktohen objektiva sasior. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

- Janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

- Është krijuar regjistri i riskut, ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut, por nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Mbetet problematikë menaxhimi

i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

- Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.

- Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar ku citohet se: "*Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut*".

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word- it.

- Në Bashkinë Divjakë, po ashtu Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Në lidhje me parimin 8: "*Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime*".

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin 9: "*Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm*".

Bashkia Divjakë nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10: "*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivite të kontrollit*".

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë Urdhërat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur rregjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhëri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimin dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimin për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Divjakë, si dhe veprimeve me arkën, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë si Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Drejtoria e Kadastrës Divjakë, Drejtoria e Transportit Rrugor. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.

- Bashkia Divjakë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin 11: “*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*”.

- Bashkia Divjakë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

- Në Bashkinë Divjakë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Në strukturën e Bashkisë Divjakë është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.

Në lidhje me parimin 12: “*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave*”.

- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

- Ekzistojnë procedurë kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët

përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë së Financës.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Bashkia Divjakë disponon faqen e saj zyrtare në ëeb.ëëë.bashkiadivjakë.gov.al ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme, si dhe shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë.

Për periudhën objekt auditimi nga Bashkia Divjakë janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit mbi vendimarrjen e saj, por mungon dokumenti justifikues i konsultimeve publike.

Në lidhje me parimin 14: “Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor”. Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e komunikimit brenda institucionit.

Në lidhje me parimin 15: “Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenin nr. 15 kreu III “Marrëdhëniet me Publikun”.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email. Grupi auditues konstaton se nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me

monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia Divjakë lidhur me pyetëtorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, e ka plotësuar dhe raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në lidhje me parimin 17: “*Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë*”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Titulli i gjetjes: Mosfunksionimi i plotë i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullive, mashtrimeve dhe veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në rregulloren e brendshme.

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.

- Nuk janë përcaktuar objektivat konkret dhe të matshëm për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, por trajnimi i stafit të Bashkisë Divjakë zhvillohet vetëm nëpërmjet trajnimeve që ofrohen nga ASPA, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve e përhershme, të përkohshme dhe të strukturave konsultative të bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

“Menaxhimi i Riskut”

- Në Bashkinë Divjakë është krijuar regjistri i riskut, por nuk është përditësuar minimalisht dy herë në vit. Gjithashtu nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut. Mbetet problematikë menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Në Bashkinë Divjakë, Drejtoria Financës nuk përdor program të licencuar për mbajtjen e kontabilitetit por operon me programin “EXCEL” ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengojn marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Divjakë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të liçencuara.

- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Divjakë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Z. F.K., Kryetar i Bashkisë Divjakë, Znj. F.M. në funksionin e Drejtorit të Financës dhe Buxhetit, Znj. Zh.A., Specialiste e Sektorit të Auditit të Brendshëm, për detyrat që ngarkohen ndaj këtij sektori në hartimin e rregjistrit të riskut dhe Znj. A.M., Drejtor i Burimeve Njerëzore.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.1., faqe 12-23.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitet publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Risk i shtuar, i cili ndikon negativisht në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Mungesa e hartimit të plan-veprimit të menaxhimit të MFK, sjellë mosidentifikimin dhe vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Divjakë, si dhe drejtorët e drejtorive të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin 2 herë në vit të risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investime në programe kompjuterike të liçencuara (për mbajtjen e kontabilitetit) në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedurë në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e

paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve të brendshme për ngritjen profesionale të stafit.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.

Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 315 datë 30.12.2021, si pjesë përbërëse e strukturës organizative për zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66 datë 28.12.2021, “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Divjakë, Institucioneve në varësi dhe Njësisve Administrative dhe Funksionet e deleguara për vitin 2022”. Auditimi i Brendshëm i Bashkisë Divjakë është i organizuar më 3 (tre) punonjës, 1 (një) përgjegjës auditimi dhe 2 (dy) specialistë auditimi duke u bazuar në Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 10 dhe në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” pika 3.

Nga auditimi, u konstatua se struktura e Auditimit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi (01.07.2021-30.09.2022) nuk ka në organikën e vet 3 auditues sipas VKM-së sipër cituar, por është e organizuar me 1 auditues, znj. A.S. e cila është e certifikuar dhe emëruar si Përgjegjëse e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe për vitin 2022, NJAB është e organizuar me 1 auditues, znj. Zh.A. e cila është e paçertifikuar dhe emëruar në detyrë si specialiste e Auditimit të Brendshëm sipas shkresës nr. 1019/1 prot., datë 03.03.2022. Si rezultat, funksionimi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm nuk është në nivelin e duhur në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Divjakë, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” e VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Struktura e sektorit të Auditimit të Brendshëm, është paraqitur në **Aneksin AB1**, bashkëlidhur.

2.1.3. Vlerësimi i veprimtarisë të njësisë së auditimit të brendshëm.

Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin Publik”, Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Nga auditimi rezultoi se:

Për vitin 2021, Plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr. 928 prot., datë 09.03.2021, përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE, raporti i veprimtarisë së sektorit të AB, sipas të cilit janë planifikuar për t’u kryer 3 auditime dhe janë realizuar 3, paraqitur në **Aneksin AB2**, bashkëlidhur.

Për aktivitetin e vitit 2021 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 1322 prot., datë 18.03.2022.

Për vitin 2022, Plani vjetor i auditimeve i miratuar me nr. 1324 prot., datë 18.03.2022, përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE, raporti i veprimtarisë së sektorit të AB sipas të cilit janë planifikuar për t’u kryer 3 auditime dhe janë realizuar 3, paraqitur në **Aneksin AB3**, bashkëlidhur.

- Plani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2021 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 3854 prot., datë 20.10.2020.

- Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1024 prot., datë 09.03.2022.

- Karta e auditimit të brendshëm është miratuar nga Titullari i Bashkisë Divjakë me Urdhërin nr. 1600/1 prot., datë 27.04.2021.

- Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë është miratuar Kodi i Etikës për audituesit e brendshëm me nr. 1600/2 prot., datë 27.04.2021.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2021-2022, konstatohet se janë dhënë 16 rekomandime gjithsej, Rekomandimet janë paratuar të gjitha, prej të cilave 9 prej tyre janë zbatuar dhe 7 janë në proces zbatimi. Në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në **Aneksin AB4**, bashkëlidhur.

Titulli i gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Divjakë, përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022.

Situata: Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sa i përket numrit të punonjësve dhe çertifikimit të tyre nuk ka qenë në përputhje me përcaktimet ligjore, të cituara më sipër rast pas rasti.

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;

- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

- Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2021-2022 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”, pasi nuk jepet informacion për shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse; veprimet e ndërmarra nga titullari i njesisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;

- Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 është hartuar nga specialisti i sektorit të auditimit të brendshëm, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “c” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”;

- Nuk ka gjetur zbatim Urdhëri nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njesisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të sektorit të auditit të brendshëm.

- Në auditimet e kryera për periudhën e vitit 2020-2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Kjo ka sjellë që titullari i njesisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera;

- Për vitin 2022 nuk është realizuar auditimi i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në përputhje me planin vjetor të vitit 2022 miratuar me shkresën nr. 1324 prot., datë 18.03.2022, si dhe konstatohet që është kryer auditim për sektorin e Shërbimeve Turistike, por nuk administrohet relacion për ndryshimin e planit të auditimeve, apo të jetë bërë ndryshimi i planit të auditimeve.

Nr.	Planifikuar	Kryer
1	Spektori mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	Spektori mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi
2	Drejtorja e rrugëve rurale	Drejtorja e rrugëve rurale
3	Drejtorja e Financës dhe Buxhetit	Spektori i Shërbimeve Turistike

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuarra si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohet me përgjegjësi Z. F.K., Kryetar i Bashkisë Divjakë, Znj. F.M., Drejtore e Financës dhe Buxhetit, Znj. A.S., ish Përgjegjëse e Sektorit të njesisë auditimit të brendshëm, Znj. Zh.A., Specialiste e Sektorit të njesisë auditimit të brendshëm Divjakë.

Kriteri: Shkronja “ç” e nenit 6, neni 13, shkronja “c” dhe “ç” e nenit 14 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020 të MFE “Për

miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016”; UMFE nr. 42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në njësinë e auditimit të brendshëm Divjakë, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar.

- Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi 2: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Divjakë, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk të lartë, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkinë Divjakë.

Rekomandimi 3: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Divjakë, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

Rekomandimi 4: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Divjakë, të marrë masa që çdo vit të kryejë auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe këshillave për titullarin e njësisë publike, nëse sistemet e MFK janë ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit financiar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4527/23 datë 28.12.2022, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 886/5 datë 30.12.2022, “*Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit*”.

Pretendimet e subjektit:

Nga shqyrtimi i observacioneve të dërguara mbi Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në Bashkinë Divjakë me shkresën nr. 886/2 prot., datë 03.11.2022, nuk vërehen fakte apo prova të reja, por janë të njëjta me ato të dërguara më parë nga ana e Drejtorisë Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme Bashkia Divjakë, në lidhje me Aktin e Konstatimit nr. 1 dhe 2, datë 18.11.2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit të KLSH-së, shprehet se çështjet e ngritura në observacion janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në mënyrë shteruese dhe për pasojë nuk merren në konsideratë.

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021.

➤ *Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024*

Titulli i gjetjes: Parregullsi në hartimin e programit buxhetor afatmesëm sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Situata: Nga auditimi i procedurave për hartimin e PBA-së 2022-2024 rezultoi se për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhëri nr. 13, datë 18.01.2021 i titullarit “*Për krijimin*

e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve”.

Më datë 02.04.2021 titullari i bashkisë ka nxjerrë Udhëzimin nr. 89/1 datë 02.04.2021 “Për përgatitjen e PBA-së 2022-2024”.

Tavanet përgatitore janë miratuar me VKB nr. 18, datë 30.03.2021 “Tavanet përgatitore të shpenzimeve për PBA-në 2022-2024 për Bashkinë Divjakë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 373/1 Prot, datë 07.04.2021.

PBA 2022-2024 është dërguar për mendime në MFE me shkresën nr. 2143 Prot, datë 04.06.2021.

Nga MFE me shkresën nr. 10877 Prot, datë 18.06.2021 janë dërguar mendimet mbi PBA-në 2022-2024.

Faza e parë e PBA-së është miratuar në Këshillin Bashkiak në muajin Qershor me VKB nr. 33 datë 30.06.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 727 Prot, datë 15.07.2021.

Tavanet përfundimtare janë miratuar me VKB nr. 54 datë 25.10.2021 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm Vjetor 2022-2024”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1314/1 Prot, datë 03.10.2021.

PBA 2022-2024 është miratuar me VKB nr. 69, datë 28.12.2021 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë, dhe ndërmarrjet vartëse të bashkisë për vitin 2022 dhe programin buxhetor afatmesëm 2022-2024”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 13/1 Prot, datë 12.01.2022.

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

- Nuk është miratuar nga KB raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;
- Nuk është dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;
- Në dokumentin e PBA-së nuk janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 12; UMFE nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”.

Ndikimi/Efekti: PBA nuk është hartuar në përputhje me përcaktimet dhe udhëzimet e MFE.

Shkaku: Moszbatim i përcaktimeve ligjore dhe mosndjekja e hapave sipas udhëzimeve të MFE.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin të gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm:

- Të dërgojnë për miratim në KB raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Taveve Përgatitore të PBA-së;

- Procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së dhe puna e bërë nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të dokumentohet në çdo fazë;
- Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

➤ *Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2021*

Buxheti i vitit 2021 dhe 2022 është miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, konkretisht:

Për vitin 2021, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 66 datë 28.12.2020 “*Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023*”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 8/1 Prot. datë 12.01.2021

Për vitin 2022, buxheti është miratuar me VKB nr. 69, datë 28.12.2021 “*Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë, dhe ndërmarrjet vartëse të bashkisë për vitin 2022 dhe programin buxhetor afatmesëm 2022-2024*”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 13/1 Prot, datë 12.01.2022.

I detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitet 2021 dhe 2022 paraqitet në **Anekset B1** dhe **B2** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, sipas të cilave rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki+Njësia e Varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale) për vitet 2021 dhe 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **674,513 mijë lekë** për vitin 2021 dhe në **625,110 mijë lekë** për vitin 2022.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

- Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Lushnjë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Divjakë, konstatohet se buxheti vjetor ka pësuar ndryshime gjatë vitit sipas nevojave të bashkisë.

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2021 dhe 2022 paraqiten në **Anekset B3** dhe **B4** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se të ardhurat dhe shpenzimet përfundimtare të miratuara për vitin 2021 janë në shumën **696,406 mijë lekë** dhe të ardhurat dhe shpenzimet përfundimtare të miratuara për vitin 2022 janë në shumën **645,951 mijë lekë**.

Nga auditimi i ndryshimeve të bëra në buxhet rezulton se:

- Gjatë vitit buxhetor 2021 dhe gjatë periudhën janar – shtator 2022 ka patur lëvizje të vogla;
- Ndryshimet janë shoqëruar me relacion shpjegues, por nuk ka një analizë se si ndikojnë ndryshimet në realizimin e objektivave të synuara të bashkisë.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Lushnjë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Gjatë vitit 2021-2022 janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Lushnjë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Realizimi i treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur në **Aneksin B5** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2021 paraqitet i realizuar **805,745** mijë lekë nga **1,056,589** mijë lekë të planifikuara ose në masën 76%. Në nivelin e realizimit të buxhetit ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të të ardhurave për vitin 2021 i cili paraqitet në 44%.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për paga në masën 39.7% ndjekur nga shpenzimet për projekte dhe investime në masën 33.7% dhe shpenzimet operative 20.1%, tregues të cilat paraqiten në **Aneksin B6** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ *Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës*

Në fillim të vitit 2021 fondi rezervë dhe i kontigjencës është planifikuar në vlerën 23,004 mijë lekë. Ky fond është realizuar në vlerën 6,610 mijë lekë ose në masën 28.7%. Për vitin 2022, periudha janar-shtator ky fond është planifikuar në vlerën 1,430 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 900 mijë lekë ose në masën 63%.

Fondi rezervë dhe i kontigjencës është përdorur për blerje produktesh ushqimore, pagesë qiraje për familjet e dëmtuara nga tërmeti, ndihmë ekonomike familjeve në nevojë, rimbursim i invalidëve për transport urban etj, në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2020 “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare*”.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikohen procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Me fondet e vitit buxhetor 2021 dhe 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballduara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “*Detyrimet e prapambetura*”, sipas llojeve të detyrimeve të grupuara në raportin vjetor të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Bashkia Divjakë ka dërguar periodikisht në MFE³ raportimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021. Rezulton se detyrimet në mbyllje të vitit 2021 janë në shumën **103,805,786**

³ Shkresa nr. 1378 Prot., datë 09.04.2021 “*Detyrimet e prapambetura për periudhën Janar-Mars 2021*”; Shkresa nr. 2715 Prot., datë 09.07.2021 “*Detyrimet e prapambetura për periudhën Prill-Qershor 2021*”;

lekë, nga të cilat 92,060,203 lekë janë detyrime të Bashkisë Divjakë dhe 11,745,583 lekë janë detyrime të institucionit të varësisë, Agjencia e Shërbimeve Komunale (ASHK). Detyrimet e prapambetura të raportuara në MFE janë të rakorduara me Degën e Thesarit Lushnje si dhe rakordojnë me detyrimet e paraqitura në bilanc në llogaritë e klasës 4 (92,060,203).

Nga auditimi, u konstatua se detyrimet e Bashkisë Divjakë në fillim të vitit 2022 janë në vlerën 103,805,788 lekë, gjatë periudhës janar-shtator 2022 janë krijuar detyrime totale në vlerën 63,062,419 lekë, ndërkohë që janë shlyer detyrime në vlerën 103,177,675 lekë duke sjellë që vlera totale e detyrimeve të Bashkisë Divjakë më 30.09.2022 të jetë 63,690,532 lekë e përbërë nga 49,698,656 lekë detyrime të bashkisë dhe 13,991,876 detyrime të njësisë së varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale.

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2021 janë paraqitur në **Aneksin B7** dhe deri në datën 30.09.2022 janë paraqitur në **Aneksin B8** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Detyrimet e prapambetura për Agjencinë e Shërbimeve Komunale janë paraqitur të detajuara përkatësisht sipas periudhave në **Anekset B9** dhe **B10** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Detyrimet e prapambetura për bashkinë janë paraqitur të detajuara sipas periudhave, përkatësisht në **Anekset B11-B18** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyruara më sipër konstatohet se, në fund të vitit 2021 dhe në fund të 9 mujorit 2022 (30.09.2022), Bashkia Divjakë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, përkatësisht në fund të vitit 2021 detyrimet janë në vlerën **103,805,788** lekë, dhe më 30.09.2022 janë në vlerën **63,690,532** lekë. Ndërsa detyrimet nga buxheti i shtetit janë në vlerën **4,154,257** lekë.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, në fund të vitit 2021 janë të palikuiduara gjithsej 187 raste me vlerë **92,060,203** lekë. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:

31.12.2021

- a. 39 fatura për shpenzime për investime në vlerën 73,228,671 lekë (kryesisht sistemim asfaltim i infrastrukturës rrugore, rehabilitim rrjeti ujitës, ndërtim ujësjellësi apo kanalesh ujitëse, mbikëqyrje dhe kolaudim), për të cilat ka patur likuidime pjesore në rastet që kanë patur dokumentacion ligjor.
- b. 70 fatura për mallra në vlerën 9,345,507 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme.
- c. 74 fatura për shërbime në vlerën 4,033,990 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme gjatë periudhës objekt auditimi.
- d. 4 vendime gjyqësore në vlerë 5,452,037 lekë, për të cilat ka patur likuidime të plota dhe pjesore gjatë vitit 2021.

30.09.2022

- a. 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 32,200,102 lekë (kryesisht sistemim asfaltim i infrastrukturës rrugore, rehabilitim rrjeti ujitës, ndërtim ujësjellësi apo kanalesh ujitëse, mbikëqyrje dhe kolaudim), për të cilat ka patur likuidime pjesore në rastet që kanë patur dokumentacion ligjor.
- b. 37 fatura për mallra në vlerën 6,725,906 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme.
- c. 78 fatura për shërbime në vlerën 6,169,113 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme gjatë periudhës objekt auditimi.
- d. 4 vendime gjyqësore në vlerë 4,603,429 lekë, për të cilat ka patur likuidime të plota dhe pjesore gjatë vitit 2022.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit

Shkresa nr. 4109 Prot, datë 06.10.2021 “Detyrimet e prapambetura për periudhën Janar-Shtator 2021”;
Shkresa nr. 1651 Prot, datë 07.04.2022 “Detyrimet e prapambetura për periudhën Janar-Mars 2022”.

buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar edhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat e veta të Bashkisë Divjakë, si dhe nga buxheti i shtetit.

Në vitin 2021 dhe 9 mujorin e vitit 2022, për realizimin e investimeve janë përdorur fondet e Bashkisë nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar e buxhetit të shtetit në rehabilitim kanalesh ujëtare, rehabilitim ujësjellës, sistemim, asfaltim dhe rikonstruksion rrugësh dhe lagjesh, shpronësime dhe blerje materiale të ndryshme.

Për vitin 2021 janë planifikuar fonde për projekte dhe investime në shumën 292,456 mijë lekë ndërsa për vitin 2022 janë planifikuar 166,252 mijë lekë, me burim financimi nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është 157,203,215 lekë. Nga këto 4 kontrata me vlerë 32,285,842 lekë janë lidhur nga Bashkia Divjakë dhe 3 kontrata me vlerë 124,917,373 lekë janë për financime nga ministritë e linjës. Aktualisht Bashkia Divjakë ka 41 kontrata të lidhura që nga viti 2018-2022 me vlerë totale 902,972,468 lekë, ku 3 kontrata janë për afate që përfshijnë vitin 2023 dhe 2024 për likuidim. Për të gjitha këto kontrata likuidimet paraqiten si vijon: është likuiduar deri më 31.12.2020 vlera 217,033,450 lekë, gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 196,789,674 lekë, deri më 30.09.2022 është likuiduar vlera 75,122,971 lekë dhe mbetet ende për t'u likuiduar vlera **39,326,998 lekë** që i përket likuidimeve të kontratave të përfunduara.

Nga buxheti i shtetit janë financuar projektet në vijim:

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit:

- Ndërtim kopshti me drekë në Fshatin Çermë Nj. A. Tërbuf, vlera e kontratës 6,7261,984 lekë, nga të cilat Ministria 35,145,718 lekë, vlerë e likuiduar gjatë vitit 2020-2021.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

- Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas, Loti 1- Njësia Administrative Remas Viti 2021, vlera e kontratës 98,895,564 lekë, është likuiduar.

- Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas, Loti 1- Njësia Administrative Remas Viti 2022, vlera e kontratës 25,000,000 lekë, likuiduar vlera 20,000,000 lekë dhe mbetet vlera 5,000,000 lekë.

- Mbikëqyrje punimesh për tenderin: Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas Loti 1 Nj.A Remas, Viti 2021, vlera e kontratës 1,021,809 lekë, likuiduar vlera 727,677 lekë, mbetur vlera 294,132 lekë.

- Mbikëqyrje punimesh për tenderin: Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas Loti 1, Nj. A. Remas, Viti 2022, vlera e kontratës 510,904 pa likuiduar.

Burimet e financimit të buxhetit vjetor dhe realizimi sipas burimeve të financimit, paraqitur të detajuara sipas periudhave, përkatësisht në **Anekset B19-B20** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e kontratave të palikuiduara deri më 30.09.2022 duke përfshirë dhe kontratat e lidhura më parë është 39,326,998 lekë. Projektet e investimeve me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre janë paraqitur në **Aneksin B21** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku rezulton se për vitin 2021 **me të ardhurat e veta** kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 "*Paga e shpërblime*" në masën 28%.

- Shpenzimet në artikullin 602 "*Shpenzime operative për mallra e shërbime*" në masën 48.4%.

- Shpenzimet në artikullin 230-231 "*Investime*" në masën 23.7%.

Referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total janë përballuar:

Për vitin 2021, nga të ardhurat e veta në shumën 147,155 mijë lekë ose në masën 20%, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike në shumën 250,609 lekë ose në masën 34%,

nga transferta e kushtëzuar në shumën 225,440 mijë lekë ose në masën 30.5%, nga Ministrinë e Linjës në shumën 115,184 mijë lekë ose në masën 15.5%.

Pra duke u nisur nga burimi i financimit rezulton se rolin kryesor në financimin e buxhetit vjetor për funksionet e kësaj njësie vendore, kryesisht përballohen nga fondet e alokuara nga buxheti i shtetit dhe në masë të vogël nga të ardhurat e veta rreth 20%.

Për periudhën janar-shtator 2022 referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total janë përballuar, nga të ardhurat e veta në shumën 77,067 mijë lekë ose në masën 16.2%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 219,785 lekë ose në masën 46.3%, nga transferta e kushtëzuar në shumën 177,515 mijë lekë ose në masën 37.5%.

➤ *Vështirësia financiare*

Vështirësia financiare e Bashkisë Divjakë është llogaritur referuar përvcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 55, pika 1.

Nga të dhënat e audituara në Bashkinë Divjakë dhe të paraqitura në **Aneksin B22** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, vlera e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021 është 14.93%, që tregon se Bashkia Divjakë është në kufirin e klasifikimit “me vështirësi financiare”. Në datën 30.09.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet 9.85%.

➤ *Raportet e Monitorimit*

Për vitin 2021 Bashkia Divjakë me shkresën nr. 1442 Prot, datë 29.03.2022, ka përcjellë në MFE Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2021. Në vijimësi raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë përcjellë në rrugë elektronike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Raportet e monitorimit përgjithësisht është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”. Raportet e monitorimit janë paraqitur për diskutime edhe në Këshillin Bashkiak.

Titulli gjetjes: Mbi realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.

Situata: 1. Gjatë vitit buxhetor 2021 dhe gjatë periudhës janar-shtator 2022, buxheti ka patur lëvizje të vogla. Ndryshimet e bëra janë shoqëruar me relacion shpjegues, por nuk ka një analizë se si ndikojnë këto ndryshime në realizimin e objektivave të synuara të bashkisë;

2. Niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2021 paraqitet i realizuar **805,745** mijë lekë nga **1,056,589** mijë lekë të planifikuara ose në masën 76%. Në nivelin e realizimit të buxhetit ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të të ardhurave për vitin 2021, i cili paraqitet në 44%. Për periudhën Janar-Shtator 2022 paraqitet i realizuar **540,220** mijë lekë nga **767,543** mijë lekë të planifikuara ose në masën 70%.

3. Në fund të vitit 2021 dhe në fund të 9 mujorit 2022 (30.09.2022), Bashkia Divjakë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, përkatësisht në fund të vitit 2021 detyrimet janë në vlerën **103,805,788** lekë, dhe më 30.09.2022 janë në vlerën **63,690,532 lekë**. Ndërsa detyrimet nga buxheti i shtetit janë në vlerën **4,154,257 lekë**.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, të paraqitura në **Anekset B7-B18** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, rezulton që në fund të vitit 2021 janë të palikuiduara gjithsej 187 raste me vlerë **92,060,203** lekë. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:

31.12.2021

a. 39 fatura për shpenzime për investime në vlerën 73,228,671 lekë (kryesisht sistemim asfaltim i infrastrukturës rrugore, rehabilitim rrjeti ujitës, ndërtim ujësjellësi apo kanalesh ujitëse, mbikëqyrje dhe kolaudim), për të cilat ka patur likuidime pjesore në rastet që kanë patur dokumentacion ligjor.

- b. 70 fatura për mallra në vlerën 9,345,507 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme.
- c. 74 fatura për shërbime në vlerën 4,033,990 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme gjatë periudhës objekt auditimi.
- d. 4 vendime gjyqësore në vlerë 5,452,037 lekë, për të cilat ka patur likuidime të plota dhe pjesore gjatë vitit 2021.

30.09.2022

- a. 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 32,200,102 lekë (kryesisht sistemim asfaltim i infrastrukturës rrugore, rehabilitim rrjeti ujitës, ndërtim ujësjellësi apo kanalesh ujitëse, mbikëqyrje dhe kolaudim), për të cilat ka patur likuidime pjesore në rastet që kanë patur dokumentacion ligjor.
- b. 37 fatura për mallra në vlerën 6,725,906 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme.
- c. 78 fatura për shërbime në vlerën 6,169,113 lekë. Janë kryer likuidime të plota dhe të pjesshme gjatë periudhës objekt auditimi.
- d. 4 vendime gjyqësore në vlerë 4,603,429 lekë, për të cilat ka patur likuidime të plota dhe pjesore gjatë vitit 2022.

4. Për vitin 2021 janë planifikuar fonde për projekte dhe investime në shumën 292,456 mijë lekë ndërsa për vitin 2022 janë planifikuar 166,252 mijë lekë, me burim financimi nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është 157,203,215 lekë. Nga këto 4 kontrata me vlerë 32,285,842 lekë janë lidhur nga Bashkia Divjakë dhe 3 kontrata me vlerë 124,917,373 lekë janë për financime nga ministritë e linjës. Aktualisht Bashkia Divjakë ka 41 kontrata të lidhura që nga viti 2018-2022 me vlerë totale 902,972,468 lekë ku 3 kontrata janë për afate që përfshijnë vitin 2023 dhe 2024 për likuidim. Për të gjitha këto kontrata likuidimet paraqiten si vijon: është likuiduar deri më 31.12.2020 vlera 217,033,450 lekë, gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 196,789,674 lekë, deri më 30.09.2022 është likuiduar vlera 75,122,971 lekë dhe mbetet ende për t'u likuiduar vlera **39,326,998 lekë** që i përket likuidimeve të kontratave të përfunduara.

5. Për vitin 2021 **me të ardhurat e veta** Bashkia Divjakë përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “*Paga e shpërblime*” në masën 28%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “*Shpenzimet operative për mallra e shërbime*” në masën 48.4%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “*Investime*” në masën 23.7%.

Referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total janë përballuar:

Për vitin 2021, nga të ardhurat e veta në shumën 147,155 mijë lekë ose në masën 20%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 250,609 lekë ose në masën 34 %, nga transferta e kushtëzuar në shumën 225,440 mijë lekë ose në masën 30.5 %, nga Ministritë e Linjës në shumën 115,184 mijë lekë ose në masën 15.5%.

Pra duke u nisur nga burimi i financimit rezulton se rolin kryesor në financimin e buxhetit vjetor për funksionet e kësaj njësie vendore, kryesisht përballohen nga fondet e alokuara nga buxheti i shtetit dhe në masë të vogël nga të ardhurat e veta rreth 20%.

Për periudhën janar-shtator 2022 referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total janë përballuar, nga të ardhurat e veta në shumën 77,067 mijë lekë ose në masën 16.2%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 219,785 lekë ose në masën 46.3 %, nga transferta e kushtëzuar në shumën 177,515 mijë lekë ose në masën 37.5 %.

6. Nga të dhënat e audituara në Bashkinë Divjakë vlera e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021 është 14.93%, që tregon se Bashkia Divjakë është në kufirin e klasifikimit “me vështirësi financiare”. Më datë 30.09.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet 9.85%.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” nenet 42, 43, 47, 50, 52 dhe 65; ligji nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”. neni 40, 42; UMFEnr. 09 datë 20.07.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të*

buxhetit” pika 106, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Kreu “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti.

Shkaku: Mosprogramimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash reale dhe ndryshimet e bëjnë të paqëndrueshëm dhe jo efektiv procesin e buxhetimit, ndërsa moslikuidimi i detyrimeve sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. Ndryshimet e bëra në buxhet të shoqërohen me analizë lidhur me ndikimin që kanë në realizimin e objektivave të bashkisë.

Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2021, Struktura organizative e Bashkisë Divjakë është miratuar me Urdhërin e Kryetarit nr. 300 datë 29.12.2020, ndërsa për vitin 2022 me Urdhërin nr. 315 Prot, datë 30.12.2021. Referuar këtyre urdhërave, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore ka patur në përbërjen e saj 14 punonjës, 1 Drejtor, 2 Përgjegjës Sektori dhe 11 specialistë/inspektorë për taksat dhe tarifatat vendore.

Titulli i gjetjes: Nivele të ulëta të realizimit të të ardhurave në Bashkinë Divjakë

Situata: Viti 2021: Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Divjakë është miratuar me VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penaltitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 08/1 Prot, datë 12.01.2021.

Viti 2022: Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Divjakë është miratuar me VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penaltitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 158 Prot, datë 17.01.2021.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Divjakë për vitin 2021 dhe 9 mujin 2022 në mijë lekë, është paraqitur në **Aneksin A1**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku referuar të dhënave për vitin 2021 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Divjakë paraqitet në masën 44%, nga 316,869 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 139,357 mijë lekë (minus 117,512 mijë lekë).

Nga auditimi, u konstatua se niveli i ulët i realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Divjakë për vitin 2021 (44%) ka ardhur si rezultat i:

1. Mosplanifikimit të saktë dhe efektiv i të ardhurave sipas zërave;

Lidhur me planifikimin e taksave të ndara apo atyre që vilen nga agjentët tatimore si tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale, taksa mbi automjetet e përdorura,

Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore në Bashkinë Divjakë nuk ka një bazë të dhënash të subjekteve që duhet të paguajnë këtë detyrim si dhe nuk ka të dhëna lidhur me ecurinë e xhiros të bizneseve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Divjakë. Si rezultat planifikimi i këtyre taksave nuk është i saktë.

2. Mosmarrjen e masave të duhura ligjore ndaj taksapaguesve familjarë dhe fizikë/juridikë për mos pagesën e taksave dhe tarifave në mënyrë vullnetare brenda afatit.

Konstatohet se taksapaguesit familjarë kanë detyrime në vlera të larta ndaj bashkisë (trajtuar më gjerë në vijim) dhe nga Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore nuk janë gjetur mekanizma efektiv për të nxitur pagesat me qëllim uljen në borxhit nga familjet.

Gjithashtu, vërehet se, edhe pse ka një korrespondencë midis drejtorive të ndryshme brenda bashkisë lidhur me grumbullimin e informacionin gjatë procesit të planifikimit të të ardhurave, të dhënat nuk arrijnë të sigurojnë informacion të saktë për një planifikim efektiv. Për shembull, mund të përmendim këtu taksën e ndikimit në infrastrukturë që planifikohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit e cila ka nivelin e realizimit 7% apo të ardhurat nga qiratë që planifikohen nga Sektori Juridik.

Procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar si duhet. Nuk ka dokumentacion të plotë lidhur me kërkesat që Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore dërgon për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar të dhëna lidhur me planifikimin e të ardhurave vjetore. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DTV për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021*” dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022*”.

Për 9 mujorin e vitit 2022 niveli i realizimit të të ardhurave paraqitet 79% dukshëm më i lartë krahasuar me vitin 2021.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: VKB nr. 61, datë 28.12.2020 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021*” dhe VKB nr. 65, datë 28.12.2021 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022*”.

Ndikimi/Efekti: Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në nivelin e realizimit të buxhetit.

Shkaku: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Të marrë masa që të vendosë një korrespondencë me institucionet e tjera që administrojnë të dhënat lidhur me taksat e ndara me qëllim marrjen prej tyre të informacionit të duhur për të bërë një planifikim sa më të saktë të të ardhurave për këto taksa. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.

➤ *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*

Titulli i gjetjes: Mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

Situata: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, neni 9, pika

3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

Në Bashkinë Divjakë struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Përmbledhja e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, është paraqitur në **Aneksin A2**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, nga legalizimet e bëra ndër vite nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 699 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara me vlerë totale të detyrimeve 26,218,070 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë. Gjatë vitit 2022 kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 109 individë me vlerë totale 4,063,596 lekë dhe janë ende debitorë 590 individë në vlerë totale të detyrimit 22,154,474 lekë.

Për vitin 2022 (deri më datë 30.09.2022), janë legalizuar gjithsej 47 objekte me vlerë totale të detyrimit për t’u paguar 1,910,503 lekë. Nga auditimi rezulton se, kanë paguar detyrimet 22 qytetarë/individë me vlerë 818,992 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 25 qytetarë me vlerë totale 1,091,511 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë. Për të bërë të mundur arkëtimin e kësaj takse janë njoftuar të gjithë debitorët si dhe janë marrë masa duke dërguar shkresa në bankat e nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare. Lidhur me këto debitorë janë marrë masat e parashikuara në kuadrin ligjor për uljen e borxhit. Detyrimet e krijuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë janë dërguar në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për t’u kontabilizuar.

*Nga auditimi rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin 25 qytetarë me vlerë totale **1,091,511** lekë, ndërsa nuk kanë paguar ende detyrimin 590 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2022 me vlerë totale **22,154,474** lekë. Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në **23,245,985** lekë për **615** objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021”, dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore””, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, ligji nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore””, i ndryshuar, neni 1, në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, VKB nr. 61, datë 28.12.2020 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet

administrative për vitin 2021” dhe VKB nr. 65, datë 28.12.2021 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Divjakë, nga mos arkëtimi i vlerës prej **23,245,985 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e masave efektive nga strukturat e Bashkisë Divjakë të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 615 debitorë në vlerën 23,245,985 lekë** si dhe në vijimësi për të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➤ *Administrimi i taksave dhe tarifave vendore*

Titulli i gjetjes: Mbi administrimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Divjakë.

Situata: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Divjakë kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe të Ardhura Vendore nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk ka regjistra fizikë) çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Divjakë i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTAV, i cili mund të rezultojë në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatëvonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike të kompjuterave me pasojë humbjen e të dhënave të DTAV. Gjithashtu, administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë”.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTAV.

Shkaku: Mosangazhim i nivelit drejtues për të vendosur në objektivat e bashkisë krijimin e një sistemi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Divjakë të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit , ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifatat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Titulli i gjetjes: Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Divjakë dhe masat e marra për uljen e tij.

Situata: Taksat dhe tarifat familjare

➤ *Taksa mbi tokën bujqësore*

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, Aneksi 1. Referuar paketës fiskale, Bashkia Divjakë ka miratuar taksën e tokës bujqësore lekë/ha në vit sipas **Anekseve A3 dhe A4** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi konstatohet se, detyrimi që familjet kanë për taksën e tokës bujqësore në Bashkinë Divjakë më datë 31.12.2021 është 300,013,608 lekë për 10,110 familje, ndërsa më 30.09.2022 është 326,826,181 lekë për 10,236 familje.

Në krahasim me vlerën totale të borxhit tatimor në Bashkinë Divjakë, borxhi për taksën e tokës bujqësore në vitin 2021 përbën 64.3% të borxhit total të Bashkisë (466,489,068 lekë), ndërsa më 30.09.2022 përbën 61.5 % të borxhit total të Bashkisë (531,147,835 lekë).

➤ *Taksa dhe tarifa të tjera familjare*

Detyrimet për taksat dhe tarifat familjare të krijuara gjatë vitit 2021 janë paraqitur të detajuara në **Aneksin A5**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përmbledhja e detyrimeve për taksat dhe tarifat familjare të krijuara gjatë vitit 2021, është paraqitur e detajuar në **Aneksin A6**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi rezultoi se në datën 31.12.2021, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Divjakë për taksat dhe tarifat familjare është **409,805,256 lekë** dhe përbëhet nga:

- Detyrime për taksën e tokës bujqësore 10,110 familje në vlerën **300,013,608 lekë**;
- Detyrime për taksën e ndërtesës 7,125 familje në vlerën **27,139,491 lekë**;
- Detyrime për taksën e truallit 6,386 familje në vlerën **1,044,592 lekë**;
- Detyrime për tarifën e pastrimit 7,985 familje në vlerën **51,668,825 lekë**;
- Detyrime për tarifën e gjelbërimit 6,489 familje në vlerën **5,262,191 lekë**;
- Detyrime për tarifën e ndriçimit 6,488 familje në vlerën **3,177,677 lekë**;
- Detyrime për tarifën e mirëmbajtjes së kanaleve 9,756 familje në vlerën **17,099,890 lekë**;
- Detyrime të tjera 7,665 familje në vlerën **4,398,982 lekë**.

Vlera e borxhit për taksapaguesit familjarë më datë 30.09.2022 është në total **465,254,599 lekë** dhe përbëhet nga:

- Detyrime për taksën e tokës bujqësore 10,236 familje në vlerën **326,826,181 lekë**;
- Detyrime për taksën e ndërtesës 7,593 familje në vlerën **31,869,336 lekë**;
- Detyrime për taksën e truallit 6,839 familje në vlerën **1,204,743 lekë**;
- Detyrime për tarifën e pastrimit 8,422 familje në vlerën **62,730,903 lekë**;
- Detyrime për tarifën e gjelbërimit 7,026 familje në vlerën **7,091,012 lekë**;
- Detyrime për tarifën e ndriçimit 6,565 familje në vlerën **3,354,686 lekë**;
- Detyrime për tarifën e mirëmbajtjes së kanaleve 9,878 familje në vlerën **26,040,044 lekë**;
- Detyrime të tjera 8,301 familje në vlerën **6,137,94 lekë**.

➤ *Agjenti tatimor*

Ujësjiellës Kanalizime SH.A. Divjakë është agjent tatimor për vjeljen e taksave dhe tarifave të Bashkisë Divjakë. Me shkresën nr. 70 Prot, datë 17.03.2022 Ujësjiellësi ka raportuar Bashkisë Divjakë listën e debitorëve për vitin 2021 ku rezultojnë debitorë 2920 familje me vlerë detyrimi progresiv 10,090,100 lekë nga i cili vetëm detyrimi i krijuar në vitin 2021 është 975,900 lekë, i cili është i përfshirë te borxhi progresiv. Nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2021 shuma e arkëtuar nëpërmjet ujësjiellësit nga taksat e bashkisë është 1,368,100 lekë dhe detyrime progresive që Ujësjiellësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë 1,754,400 lekë. Ndërsa deri më

datë 30.09.2022 sipas akt rakordimit shuma e arkëtuar për taksat e bashkisë është 1,033,000 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjiellësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë në vlerën 2,684,100 lekë.

➤ *Detyrimet nga subjektet fizikë/juridikë*

Gjendja e subjekteve tatimpaguese në Bashkinë Divjakë, është paraqitur në **Aneksin A7**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku shihet se për vitin 2021 në Bashkinë Divjakë janë hapur 24 biznese dhe janë mbyllur 30.

Nga auditimi i dokumentacionit që administron Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore.

Nga auditimi rezultoi se në datën 31.12.2021, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Divjakë për subjektet fizikë/juridikë është **30,465,961 lekë** dhe përbëhet nga:

- Detyrime nga biznesi i vogël për 261 subjekte në vlerën **24,535,781 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh për 11 subjekte në vlerën **5,929,961 lekë**;

Me shkresën nr. 1434 Prot. datë 28.03.2022, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhura Vendore ka dërguar borxhin tatimor progresiv në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës. Detyrimet janë dërguar sipas Njësive Administrative së bashku me listat analitike sipas klasifikimit të debitorëve në subjekte fizik/juridik apo në debitorë familjarë.

Përmbledhja e borxhit tatimor në datën 31.12.2021, është paraqitur në 000 lekë, në **Anekset A8 dhe A9**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2021 është 86,473,273 lekë nga të cilat:

- Detyrime për taksën e ndërtesës në vlerën **6,276,414 lekë**;
 - Detyrime për taksën e tokës bujqësore në vlerën **40,420,818 lekë**;
 - Detyrime nga taksa e truallit në vlerën **197,263 lekë**;
 - Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **3,275,808 lekë**;
 - Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **1,018,688 lekë**;
 - Detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.) në vlerën **24,147,343 lekë**;
 - Detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **10,936,589 lekë**;
- (Taksa e ndikimit në infrastrukturë është audituar e ndarë nga detyrimet totale)*
- Detyrime nga tarifa e ujitjes në vlerën **200,350 lekë**.

Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresiv gjendet në **Aneksin A10**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ *Masat e marra për uljen e borxhit*

Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore në Bashkinë Divjakë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të audituar lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Divjakë rezulton se të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore janë marrë masat si vijon:

- Janë nxjerrë Urdhërat e bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesve drejtuar bankave të nivelit të dytë;
- Janë dërguar shkresa në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Fier për vendosjen e barrës siguroese të cilat shoqërohen me listën emërore të debitorëve;
- Janë dërguar shkresa në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë për vendosjen e barrës hipotekore të cilat shoqërohen me listën e subjekteve debitore;
- Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore ka dërguar kërkesë për mbështetje nga Sektori Juridik dhe i Prokurimeve Publike në Bashkinë Divjakë lidhur me vazhdimësinë e procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga subjektet debitore.

Efektet financiare që kanë ardhur si rezultat i masave të marra cituar më sipër janë:

Deri më datë 31.12.2021 kanë paguar detyrimet 132 biznese debitore në vlerën 6,544,090 lekë. Deri më 30.09.2022 kanë paguar detyrimet 52 subjekte debitore me vlerë 2,357,547 lekë. Ndërsa nga taksapaguesit familjarë deri më datë 31.12.2021 kanë paguar 2413 familje në vlerën totale 33,674,899 lekë, ndërsa për vitin 2022 (30.09.2022) kanë paguar 2084 familje në vlerën totale 28,583,817 lekë.

Gjithashtu, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore me shkresën nr. 1424 Prot, datë 28.03.2022 i ka dërguar Sektorit Juridik dhe të Prokurimeve Publike në Bashkinë Divjakë listën e debitorëve me qëllim fillimin masave të tjera ligjore për subjektet debitore.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Divjakë.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën totale **507,492,800 lekë**, e përbërë nga:

- **31,869,336 lekë** detyrime për taksën e ndërtesës;
- **326,826,181 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore;
- **1,204,743 lekë** detyrime nga taksa e truallit;
- **32,823,179 lekë** detyrime nga biznesi i vogël;
- **8,664,192 lekë** detyrime nga biznesi i madh;
- **104,945,289 lekë** detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.);
- **409,050 lekë** detyrime nga tarifa e ujitjes.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DTAV të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DTAV të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Divjakë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për të koordinuar punën me strukturat e Ujësjetës me qëllim kalimin e detyrimeve që ky i fundit ka ndaj Bashkisë Divjakë për taksat dhe tarifatat e arkëtuara për llogaritë të bashkisë.

➤ *Akt marrëveshjet për pagesën me këste të detyrimeve*

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 77, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë gjatë vitit 2021 dhe periudhës janar- shtator 2022 ka lidhur akt marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve vendore me 17 taksapagues familjarë dhe me 21 taksapagues fizikë/juridik debitorë ndaj bashkisë për taksat dhe tarifatat vendore. Lidhur me hyrjen në marrëveshje me Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave palët e interesuara kanë paraqitur kërkesë pranë DTA dhe marrëveshjet janë nënshkruar për borxhin e mbartur dhe jo atë të periudhës aktuale.

Të dhënat lidhur me aktmarrëveshjet e lidhura me familjet dhe bizneset janë paraqitur në **Aneksin A11** dhe **A12** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se 17 marrëveshje janë lidhur me familjet debitorë për vlerën totale 1,202,659 lekë. Në momentin e lidhjes së marrëveshjes është paguar vlera deri në 20% e borxhit në total 266,326 lekë dhe vlera e mbetur prej 936,333 lekë duhej të paguhej me këste sipas marrëveshjeve përkatëse. Nga 17 akt marrëveshje të lidhura vetëm 2 kanë zbatuar kushtet e dakordësuara duke paguar borxhin e plotë dhe 7 kanë paguar pjesërisht. Vlera totale e arkëtuar është 240,575 lekë. Ndërsa nuk kanë paguar borxhin plotë apo të pjesshëm ndaj bashkisë 15 familje në vlerën totale 695,758 lekë.

Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore nga ana e saj, për të gjithë qytetarët që kishin nënshkruar akt marrëveshje dhe nuk i kanë qëndruar kushteve të dakordësuara ka bërë ndërprerjen e tyre duke marrë masa të tjera për arkëtimin e borxhit në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi trajtuar më gjerësisht në rubrikën “Masat për uljen e borxhit”.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se 21 marrëveshje janë lidhur me subjektet fizikë/juridikë debitorë për vlerën totale 3,831,945 lekë. Në momentin e lidhjes së marrëveshjes është paguar vlera deri në 20% e borxhit në total 869,818 lekë dhe vlera e mbetur prej 2,962,127 lekë duhej të paguhej me këste sipas marrëveshjeve përkatëse. Nga 21 akt marrëveshje të lidhura vetëm 6 kanë zbatuar kushtet e dakordësuara duke paguar borxhin e plotë, ndërsa të tjerët kanë paguar vetëm disa këste. Vlera totale e arkëtuar është 1,357,134 lekë. Ndërsa nuk kanë paguar rregullisht këstet e aktmarrëveshjeve 15 subjekte në vlerën totale 1,604,993 lekë. Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore nga ana e saj, për të gjithë subjektet që kishin nënshkruar akt marrëveshje dhe nuk i kanë qëndruar kushteve të dakordësuara ka bërë ndërprerjen e tyre duke marrë masa të tjera për arkëtimin e borxhit në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi trajtuar më gjerësisht në rubrikën “Masat për uljen e borxhit”.

➤ *Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira*

Titulli i gjetjes: Mospagesë e detyrimeve për kontratat e qirave

Situata: Bashkia Divjakë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi⁴ për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 12 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur me afat kohor nga 1-20 vjet. Të dhënat për kontratat e lidhura si dhe pagesat e bëra për qiranë janë paraqitur në **Aneksin A13**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

⁴ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Nga auditimi rezulton se pagesat e qirasë për vitin 2021 janë kryer rregullisht nga të gjithë qiramarrësit, ndërsa për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë 4 qiramarrës (P.M., H.M., L. SHPK, F.S.) me **vlerë totale të detyrimit 1,159,880 lekë**.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Kontratat e qirave.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Divjakë, në vlerën 1,159,880 lekë.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Divjakë nuk janë angazhuar sa duhet me qëllim sigurimin e pagesave nga qiramarrësit referuar përcaktimeve të kushteve të kontratës.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa që qiramarrësit të zbatojnë me përpikmëri kushtet e kontratave me qëllim pagesën e detyrimeve për qiranë në afat. Për qiramarrësit që tejkalojnë afatet e pagesës të aplikohet kamatë vonesa referuar kushteve të kontratave.

➤ *Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve*

Titulli i gjetjes: Mbi pagesën e autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse.

Situata: Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Divjakë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 19 subjekte të paraqitura në **Aneksin A14** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se, në Bashkinë Divjakë subjektet që tregtojnë lëndë djegëse me pakicë pajisen me autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit referuar kuadrit ligjor në fuqi me afate nga 1 deri në 5 vite. Lidhur me pagesën e autorizimit Bashkia Divjakë përgjithësisht për subjektet që nuk kanë paguar menjëherë të gjithë vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite, ka ndjekur praktikën e pagesës me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë duke i pajisur ato me autorizime një vjeçare.

Nga auditimi rezultoi se:

1. Subjekti “M.” është pajisur me autorizim 5 vjeçar më datë 11.02.2020 dhe është dakordësuar për të kryer pagesën e autorizimit me këste vjetore 200,000 secili. Nga auditimi rezulton se, subjekti ka kryer vetëm një pagesë deri në Nëntor 2022 nga 3 pagesa që duhet të bënte. Vlera totale e detyrimit ndaj Bashkisë Divjakë është **800,000 lekë**.

2. Subjekti “K.O. SHPK” ka qenë i pajisur me autorizim deri më datë 04.12.2020 në vijim nuk është pajisur me autorizim të ri për ushtrimin e aktivitetit. Subjekti “K.O. SHPK” ka paguar një vlerë prej 100,000 lekë në vitin 2022 përsëri nuk është pajisur me autorizim. Detyrimet që ka ndaj bashkisë për autorizimin janë në vlerën **900,000 lekë** vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë. Për subjektin K.O. SHPK nga Bashkia Divjakë është dërguar Urdhër bllokimi i llogarive bankare në të gjitha bankat e nivelit të dytë për vitin 2021

me shkresë nr. 4348 Prot, datë 17.10.2021, dhe për vitin 2022 me shkresën nr. 5065 Prot, datë 12.10.2022. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë është bllokuar aktiviteti me Urdhërin nr. 180 datë 11.10.2022.

3. Subjekti “M.S.F. SHPK” nuk ka paguar vlerën prej **200,000 lekë** për vitin 2022.

4. Subjekti P. SHPK, referuar ekstraktit historik të shkarkuar nga QKB më datë 26.03.2022 ka pezulluar aktivitetin pa afat.

5. Subjekti “L. ShPk” që nga viti 2020 nuk është i pajisur me autorizim, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën **1,000,000 lekë**. Për subjektin L. ShPk është dërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare të gjitha bankave të nivelit të dytë me shkresën nr. 5064 Prot, datë 12.10.2022, si dhe është bërë bllokimi i aktivitetit nga Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore me Urdhërin nr. 182 datë 11.10.2022.

Për periudhën objekt auditimi është konstatuar se subjektet “M.”, “K.O. SHPK”, “M.S.F. SHPK”, “L. ShPk” kanë ushtruar aktivitet në kundërshtim me përcaktimet ligjore, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën totale 2,900,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore si vijon:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, neni 4, neni 15, neni 20, “Autorizimet”, pika 2, “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11⁵, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë **deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje**”;

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3 “Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore”.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, neni 4, neni 15, neni 20, pika 2.

VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Divjakë.

Shkaku: Puna jo efektive e DAPPLL në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masa që subjektet “M.” dhe “M.S.F. SHPK” të kryejnë rregullisht këstet e pagesave ndaj Bashkisë Divjakë. Në vijimësi pajisja e tyre me autorizim të bëhet menjëherë në përfundim të afatit të autorizimit aktiv pa lënë hapësira për ushtrimin e aktivitetit pa qenë të pajisur me autorizimet përkatëse. Gjithashtu, DTAV në bashkëpunim me Sektorin Juridik të ndjekin të gjitha hapat ligjore ndaj subjekteve “K.O. SHPK” dhe “L. ShPk” me qëllim fillimin e aktivitetit vetëm pas pajisjes me autorizimin përkatës dhe kryerjes së pagesave për llogari të bashkisë.

⁵ Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 11.

- *Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Divjakë gjatë vitit 2021 dhe 9 mujori 2022*

Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Divjakë grupi i auditimit auditoi dokumentacionin mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifatat vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Për periudhën nën auditim janë identifikuar 5 operatorë ekonomikë që kanë fituar të drejtën për të kryer punime të ndryshme në territorin e Bashkisë Divjakë. Pagesat për detyrimet vendore janë paraqitur në **Aneksin A15** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku shihet se nuk ka paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Divjakë për vitin 2021 në vlerën totale **80,000 lekë** Operatori Ekonomik “A.S.”. Kjo vlerë është paguar gjatë vitit 2022 (26.07.2022) dhe më 30.09.2022 nuk ka debitorë nga OE që kanë lidhur kontrata të ndryshme me Bashkinë Divjakë.

- *Mbi realizimin e të ardhurave nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit*

Titulli i gjetjes: Mbi pagesën e gjobave të vendosura nga IMTV.

Situata: Organizimi dhe funksionimi i IMTV Divjakë

Për vitin 2021 IMTV ka patur në strukturën e saj 3 punonjës, 1 Kryeinspektor dhe 2 inspektorë⁶, ndërsa për vitin 2022 4 punonjës, 1 Kryeinspektor dhe 3 inspektorë⁷.

Struktura organizative e Bashkisë Divjakë është miratuar me Urdhërin e Kryetarit nr. 300 datë 29.12.2020 ndërsa për vitin 2022 me Urdhërin nr. 315 Prot, datë 30.12.2021.

Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Divjakë u konstatua se për vitin 2021 janë mbajtur në total 23 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Për këto 23 kundërvajtje është dhënë 1 masë për “Pezullim të punimeve”, 22 masa “Dënim me gjobë”. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2021 është 11,00,000 lekë.

Për periudhën janar-shtator 2022 janë mbajtur në total 4 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Për këto 4 kundërvajtje janë dhënë 4 masa “Dënim me gjobë”. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2022 është 165,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se, gjobat e vendosura në vitin 2022 janë arkëtuar të gjitha. Lidhur me 22 gjobat e vendosura gjatë vitit 2021 me vlerë totale 11,00,000 lekë rezulton se nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë gjobë.

Për gjobat e vendosura në vitin 2021 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, Kryeinspektori i IMTV në bashkëpunim me Sektorin Juridik nuk ka ndjekur procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimin e tyre. Përkatësisht, IMTV dhe Sektori Juridik nuk ka “dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhërin e Ekzekutimit për secilën gjobë”, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4⁸, rrjedhimisht nuk ka ndjekur as hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë.⁹ Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë¹⁰.

⁶ Urdhëri i Kryetarit nr. 300 datë 29.12.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Divjakë, Institucioneve në varësi dhe NjA për vitin 2021”.

⁷ Urdhëri i Kryetarit nr. 315 datë 20.12.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Divjakë, Institucioneve në varësi dhe NjA për vitin 2022”.

⁸ Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve”, pika 4.

⁹ Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9 “Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative”, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.

¹⁰ Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 3.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se gjobat e vendosura nga IMTV për periudhën 2021 janë kontabilizuar si detyrime nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Për sa më sipër rezulton se, **për vitin 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 11,000,000 lekë.**

Informacioni i detajuar mbi gjobat e vendosura nga IMTV, është paraqitur në **Aneksin A16**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.2., faqe 23-43.

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3 pika 5.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Divjakë

Shkaku: Mos marrja e masave nga IMTV dhe Sektori Juridik për të mundësuar arkëtimin e tyre.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Inspektoriati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të ndjekin të gjitha hapat për të dërguar në gjykatë 22 gjobat e vendosura me qëllim shndërrimin e tyre në “titull ekzekutiv” si dhe të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitin 2021 në vlerën **11,000,000 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet në aktivitetin e IMTV-së ngarkohen me përgjegjësi, z. A.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike (NC), z. R.J. me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së deri më dtë 17.01.2022 (KP), I.K. me detyrë Inspektor deri më 17.01.2022 dhe Kryeinspektor nga data 17.01.2022 (KP).

Për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor ngarkohen me përgjegjësi, z. F.V. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore deri më datë 01.02.2022 dhe në vijim Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit dhe Kontrollit (NC), z. R.M. me detyrë Përgjegjës i SVK deri më datë 01.02.2022 dhe në vijim me detyrë Drejtor i DTAV (NC), z. R.B. me detyrë Inspektor i taksave dhe Tarifave Vendore në NjA Tërbuf (NC), z. D.Q. me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në NjA Gradishtë (NC), z. Xh.M. me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në NjA Rremas (NC), znj. E.H. me detyrë Inspektore e Taksave dhe Tarifave Vendore në NjA Grabian për periudhën nën auditim (NC), z. E.M. (NC) dhe z. J.Z. (NC) me detyrë Inspektorë Kontrolli.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

➤ **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2021**

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022. Bilanci i vitit 2021 është përgatitur nga z. P.T., me detyrë përgjegjës i zyrës së financës, është konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Divjakë, z. F.K., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe është depozituar dhe miratuar nga Dega e Thesarit Lushnjë në datën 31.03.2022, brenda limiteve të përcaktuara me ligj.

Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, centralizator dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.

Partitarët analitikë të të gjitha llogarive janë mbajtur dhe përditësuar rregullisht dhe llogaritë inventariale të magazinës janë rakorduar llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;
- Pasqyrat statistikore;
- Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7, a dhe b: Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Krahas formateve të mësipërme, për vitin 2021 janë përpiluar edhe pasqyrat financiare të konsoliduara, ku jepen sqarime për palët e lidhura. Bashkia Divjakë ka në zotërim një njësi shpenzuese, me NIPT K24116401U e cila është krijuar me VKB Divjakë nr. 9 datë, 17.12.1997 e emërtuar “*Agjencia e Shërbimit Komunal Divjakë*”, me aktivitet mirëmbajtjen dhe shërbimin ndaj komunitetit për pastrim dhe gjelbërim në territorin e Bashkisë Divjakë. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë depozituar pranë Degës së Thesarit Lushnjë me shkresën nr. 1992 Prot., datë 29.04.2022 dhe miratuar nga Dega e Thesarit Lushnjë në datën 12.05.2022. Pasqyrat financiare të konsoliduara japin një informacion më të plotë financiar rreth aktivitetit ekonomik të Bashkisë Divjakë. Aktivitet janë sistemuar sipas llogarive përkatëse të klasës 2 (terrene, ndërtesa, rrugë, skema ujitëse dhe paisje). Për vitin 2021, vlera e aktiveve afatgjata në kosto historike është 5,249,463,304 lekë, për vitin 2020 vlera e tyre është 4,851,486,800 lekë, pra ka një rritje prej 397,976,504 lekë. Detyrimet afatgjata ose llogaria 467 për vitin 2021 është në vlerën 103,805,788 lekë ndërsa për vitin 2020 është në vlerën 130,213,660 lekë, me një rënie të detyrimeve në vlerën 26,407,872 lekë.

Për vitin 2021 llogaria 101 “*Fondet bazë*” merr gjithë kapitalizimin e fondeve në aktive si dhe ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit ushtrimor. Pra fondet bazë marrin në kredi shtesën në llogarinë 105 për vlerën 101,612,233 lekë, shtesën në llogarinë 106 për vlerën 311,942,724 lekë, pakësim të fondit për ndryshim negativ të gjendjes së inventarit në llogarinë 1012 për vlerën 21,002,056 lekë, shtesën në pakësim të fondit nga amortizimi, për vlerën 235,301,159 lekë, llogaria 1013, pakësimi i fondi nga nxjerrja jashtë përdorimi e aktiveve, llogaria 1015 në vlerën 15,578,453 lekë si dhe shtesë fondi në vlerën 60,056,054 lekë të llogarisë 85.

Detyrimet afatgjata ose llogaria 467 për vitin 2021 është në vlerën 103,805,788 lekë, për vitin 2020 është në vlerën 130,213,660 lekë, pra ka një ulje të detyrimeve prej 26,407,872 lekë.

PF të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, kreu IV, pika 98 e në vijim.

Agjencia e Shërbimit Komunal është përfituese e fondeve nga Bashkia Divjakë, e cila në vetvete është një njësi me natyrë shpenzuese. Fondi nga buxheti për këtë njësi për vitin 2021 është 65,538,609 lekë.

Shpenzimet kryesore të Agjencisë së Shërbimit Komunal janë paraqitur në **Aneksin PF1**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Aktivitet e trupëzuara që ka në përdorim kjo njësi shpenzuese, janë paraqitur në **Aneksin PF2**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2021 aktivitetet e trupëzuara kanë një rënie në krahasim me vitin 2020, ku vlera e aktiveve për vitin 2020 ka qenë 22,503,021 lekë pra një rënie prej 1,351,775 lekë. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e shtesës në pakësim të kostove historike nga daljet jashtë përdorimit të aktiveve dhe amortizimit vjetor. Konkretisht, pakësimet nga daljet jashtë përdorimit janë në llogarinë 214 për vlerën 339,590 lekë, në llogarinë 215 për vlerën 966,000 lekë (Kamionçinë tip benz), në llogarinë 218 për vlerën 499,800 lekë. Shtesa e krijuar nga ushtrimi vjetor është krijuar me blerje në llogarinë 214 për vlerën 1,945,800 lekë, “*Blerje Kosha metalikë për pastrim dhe vegla pune*”. Në fund të vitit 2021 është bërë inventarizimi i aktiveve për vitin 2021. Inventarizimi i aktiveve është kryer sipas dispozitave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Është ngritur urdhëri nr. 61 datë 01.12.2021, “*Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të trupëzuara të Agjensisë të Shërbimeve Komunale për vitin 2021*”, me numër prot. 267 dhe urdhëri nr. 62 datë 01.12.2021 “*Për ngritjen e komisionit të asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit nga komisioni i vlerësimit të aktiveve të Agjensisë së Shërbimeve Komunale për vitin 2021*” me numër prot. 268.

➤ **Oasja dhe metodologjia e auditimit**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruar nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2021 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **10,415,408 lekë** për shpenzimet dhe **8,507,870 lekë** për të ardhurat, sipas **Aneksit PF3**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Mbi vlerësimin e riskut**

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Divjakë ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët (me dëgën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepcave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.

Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përlogaritur (**10,415,408 lekë**) u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajt nëntor-dhjetor 2021, në vlerën 522,691,058 lekë për muajin nëntor dhe 690,442,868 lekë për muajin dhjetor.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si: Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

➤ **Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit**

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmimi nga të tretët:

Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabile. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

➤ **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021:**

Mbajtja e kontabilitetit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe në UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.02.2022; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, etj.

Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Divjakë në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2021.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivët, Detyrimet dhe Kapitali.

Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sigurtë të situatës financiare.

Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse.

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Divjakë në 31.12.2021, sipas **formatit F1**, është paraqitur në **Aneksin PF4**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit..

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivitetit.

Titulli i gjetjes: Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2021. Rakordimi i të dhënave në PF të disponueshme në Bashkinë Divjakë, me PF të disponueshme në Degën e Thesarit.

Situata:

➤ **AKTIVET**

I. Aktivët Afat shkurtër

1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre:

Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Divjakë, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivitetit në PF në Bashki, vlera është 5,329,592,175 lekë, ndërsa në totalin e Aktivitetit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 5,239,247,615 lekë, me një diferencë prej 90,344,560 lekë më pak në PF në subjekt. Kjo diferencë tregon se në sistemin e thesarit nuk është paraqitur vlera 90,344,560 lekë në llogarinë 520. Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, në PF në subjekt ka vlerën 90,344,560 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo diferencë korrespondon në Pasivin e Bilancit me shumën e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 30,589,616 lekë dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”, në vlerën 59,754,945 lekë. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 594,681,453 lekë, e barabartë me totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë detajuar në **Aneksin PF5**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ku konstatohet se kjo llogari ka pësuar një rritje me 8,062,367 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit dhe krahasimi me PF në thesar, u konstatua se kjo diferencë në Pasivin e Bilancit përbëhet nga shuma e llogarive 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për vlerën 30,589,616 lekë dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”, për vlerën 59,754,945 lekë.

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar në **Aneksin PF6**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej transaksione, për vlerën totale **740,396,149 lekë**, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale **967,321,840 lekë** sipas **Aneksit PF7**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga auditimi, u konstatua se është realizuar 76% e planit vjetor të shpenzimeve.

2. Gjendje Inventari qarkullues:

Llogaritë e inventareve paraqiten në vlerën totale 66,970,262 lekë, me një rritje prej 20,691,275

lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Llogaria 31 “*Materiale*”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 29,056,975 lekë, me një rritje prej 21,998,268 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, ndërsa llogaria 32 “*Inventar i imët*”, paraqitet në vlerën 37,913,287 lekë, me një zbritje prej 1,306,993 lekë nga viti ushtrimor parardhës. Këto zbritje janë si rezultat i amortizimit dhe nxjerrjes së materialeve jashtë përdorimit. Nga rakordimi i vendimit për nxjerrjen jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përse i përket llogarisë 32 “*Inventar i imët*” dhe llogarisë 31 “*Materiale*”. Nga analiza e kryer për llogarinë 32 “*Inventar i imët*”, nga Bashkia Divjakë dhe Njësitë Administrative përkatëse gjatë vitit 2021 ka pasur zbritje për vlerën 1,306,993 lekë dhe materiale të nxjerra jashtë përdorimit për vlerën 2,298.245 lekë. Diferencat me pasqyrimin në bilanc i përkasin shtesave gjatë periudhës.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

3. Llogaritë e arkëtueshme:

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten në vlerën totale 527,711,191 lekë, me një rritje prej 126,727,433 lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën debitore 487,062,104 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është rritur për vlerën 117,819,594 lekë. Brenda kësaj është përfshirë vlera prej 53,447,482 lekë, për debitorë nga tarifat vendore, e rekomanduar nga KLSH në auditimin e PF të vitit 2020.

Kjo llogari përbëhet nga detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontroleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021. Në mënyrë analitike kjo llogari është paraqitur e detajuar në **Aneksin PF8**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në këtë nënzë paraqiten edhe tepricat debitorë të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj., kur ato klasifikohen si afatshkurtra.

Vihet re se gjatë vitit 2021 janë arkëtuar gjithsej 8,068,531 lekë nga Bashkia Divjakë. Për vlerën e paarkëtuar, Bashkia Divjakë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e Urdhërave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115, të Kodit Civil në R. Sh. dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.Sh. (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “*Për kundërvajtjet Administrative*” (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Në Bashkinë ka mangësi dokumentacioni vërtetues, gjë që e bën të pamundur kërkimin në rrugë zyrtare dhe ligjore të detyrimeve të papaguara në favor të saj.

Detyrimet e klientëve janë kërkesa afatshkurtra dhe nëse nuk i mbledh subjekti, atëherë parimi i vijimësisë (qëndrueshmërisë) vihet në pikëpyetje.

Bashkia nuk ka bërë analizë për vlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe për vjetërsinë e tyre dhe nuk ka politika të shkruara rreth procedurave për njohjen e provizioneve. Mungesa e analizave të duhura rreth të arkëtueshmeve dhe politikave të duhura rreth procedurave për njohjen e provizioneve ndikon në besueshmërinë e vlerës së tyre.

Gjithashtu për vlerat mbi një vit, drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme.

Nga auditimi i të ardhurave dhe debitorëve nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitore të familjarëve, bizneseve, etj, nuk janë kontabilizuar në mënyrë të saktë dhe të plotë. Në listën e debitorëve mungojnë disa persona të cilët janë gjobitur nga IMTV, lista e debitorëve progresivë, e disponueshme në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore mbyllet me numër rendor 418, ndërkohë që lista analitike e kontabilitetit mbyllet me numër rendor 162, etj. Gjithashtu, konstatohet se nuk janë përlllogaritur dhe kontabilizuar kamatëvonesat.

Llogaria 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*”, në fund të vitit ushtrimor 2021, paraqitet në bilanc për vlerën 40,649,087 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” për vlerën 23,278,596 lekë, llogaria 42 “*Detyrimet ndaj personelit*” për vlerën 12,426,894 lekë, llogaria 431 “*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa*” për vlerën 781,937 lekë, llogaria 435 “*Sigurime shoqërore*” për vlerën 3,659,788 lekë, llogaria 436 “*Sigurime shëndetësore*” për vlerën 501,872 lekë dhe llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, muaji dhjetor për vlerën 92,060,205 lekë. Nga auditimi nuk u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin, të drejta*” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4. Të tjera aktive afatshkurtra

Llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet për vlerën 92,060,205 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 27,204,517 lekë. Vlera e kësaj llogarie në bilanc është e barabartë me vlerën e paraqitur në PF të disponueshme në sistemin e thesarit. Detyrimet e Bashkisë Divjakë, sipas natyrës janë paraqitur në **Aneksin PF9**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Analiza e detajuar e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”, është paraqitur në **Aneksin PF10**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, nga pasqyra e mësipërme vërehet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të prapambetura është e trashëguar nga periudha përpara reformës territoriale.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitorë e kësaj llogarie, **është e kuadruar** me shumën e llogarisë kreditore në pasiv të bilancit, përkatësisht me llogarinë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në shumën 92,060,205 lekë, në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi 1, “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022.

Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

II. Aktivet Afatgjata

1. Aktivet afatgjata jomateriale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas UMF nr. 8, datë 9.03.2018 përfshin primet e emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit. Aktivet afatgjata jomateriale janë paraqitur në **Aneksin PF11**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” në Bashkinë Divjakë në datën 31.12.2021 përbëhet nga 16 studime dhe kërkime nga të cilat:

15 studime e projektme në vlerën 24,832,607 lekë, i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Divjakë, e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat për 15 projekte.

1 projekt “*Oponencë e projektit të furnizimit me ujë zona bregdetare Remas*”, për vlerën

562,869 lekë ka qënë me fonde të deleguara.

Nga verifikimi i llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” për vitin 2021 rezulton se 3 studime dhe kërkime në vlerën prej 6,300,000 lekë kanë filluar të vihen në zbatim, si më poshtë:

1. Studim projektim “*Rikualifikimi urban i bllokut të ish-gazit Divjakë*”;
2. Hartim projekti: “*Rikonstruksion i rrugëve të rajonit të Sotallarëve*”;
3. Hartim projekti: “*Ndërtimi godinës së Bashkisë Divjakë*”;

Për këto asete njësia publike nuk ka përlllogaritur norma amortizimi duke i qëndruar Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-05).

Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit. Për aq kohë sa objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar. Detajet e llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” janë paraqitur në **Aneksin PF12**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Aktive afatgjata materiale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5, i përmirësuar.

Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

Vlera e kësaj nënrubrike është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Detajet e nënrubrikës “*Aktive afatgjata materiale*” janë paraqitur në **Aneksin PF13**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në datën 31.12.2021, paraqitet për vlerën 155,168,580 lekë ndërsa në vitin 2020 ka qënë për vlerën 158,733,255 lekë, ndryshuar nga viti ushtrimor paraardhës. Detajet e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” janë paraqitur në **Aneksin PF14**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” në datën 31.12.2021, paraqitet për vlerën 0 lekë, po kështu edhe në datën 31.12.2020. Në pasqyrat financiare të Bashkisë Divjakë nuk është pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Divjakë me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*”, pika 8, shtojca nr. 6, me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Divjakë, sipas shtojcës 24, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 52 (pesëdhjetë e dy).

Gjendja e llogarisë 212 “*Ndërtime e konstruksione*” në datën 31.12.2020, ka qënë në vlerën 1,184,477,965 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qënë 1,214,105,076 lekë, me një pakësim në vlerën 20,369,094 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 871,790,469 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur me gjendjen reale. Gjendja e kësaj llogarie është analizuar në **Aneksin PF15**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*” në datën 31.12.2020, ka qënë në vlerën 3,208,482,023 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qënë 3,533,241,902 lekë, me një shtese në vlerën 324,759,879 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.

Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 2,891,309,813 lekë. Në bilanc kjo

Ilogari është paraqitur me gjendjen reale. Gjendja e kësaj llogarie është analizuar në **Aneksin PF16**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e Ilogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 47,207,279 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 75,866,363 lekë, me një shtesë në vlerën 28,659,084 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit dhe nxjerrje jashtë përdorimi për vlerën 365,155 lekë, sipas urdhërit nr. 51 datë 07.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë “*Per nxjerjen e aktiveve nga përdorimi*”, sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 dhe njohjes së Këshillit Bashkiak sipas informacionit me nr. Prot 1255/4 date 15.03.2022.

Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto e kësaj llogarie është 50,166,006 lekë. Gjendja e kësaj llogarie është analizuar në **Aneksin PF17**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e Ilogarisë 215 “*Mjete transporti*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 125,495,831 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie 125,495,831 lekë, pra është e pandryshuar. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit. Nxjerrje jashtë përdorimi nuk ka.

Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 79,743,210 lekë. Në bilanc kjo llogari është e pandryshuar. Gjendja e kësaj llogarie është analizuar në **Aneksin PF18**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se llogaria 215 “*Mjete transporti*” është mbivlerësuar për vlerën neto **62,201,067 lekë**, për makineri dhe pajisje sipas **Aneksit PF19**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilat i përkasin Ilogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*”, e cila është nënvlerësuar për të njëjtën vlerë. Sa më sipër, këto dy llogari të aktivitetit nuk paraqesin vlerën reale.

Gjendja e Ilogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 60,292,595 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 61,192,344 lekë, me një shtesë në vlerën 899,749 lekë. Pakësimet në këtë llogari janë për vlerën e amortizimit dhe daljet jashtë përdorimit me vlerë 4,049,891 lekë, sipas urdhërit nr. 294 datë 03.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë “*Për ngritjen e komisionit të vlerësimit*” sipas UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” dhe njohjes së Këshillit Bashkiak, sipas informacionit me nr. 1255/4 Prot., datë 15.03.2022. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 25,077,031 lekë. Në bilanc, kjo llogari është paraqitur me vlerën e mësipërme. Gjendja e kësaj llogarie është analizuar në **Aneksin PF20**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këto zëra të aktivitetit nuk është mbajtur regjistër aktivesh ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivitetit, vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim. Gjithashtu identifikohet problematika e mosbërjes së inventarizimit vjetor të tyre, në kundërshtim me pikën 30 të UMF 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” dhe 215 “*Mjete transporti*”, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Inventarizimi i aktiveve:

Në Bashkinë Divjakë inventarizimi është kryer çdo vit në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime.

Nga Kryetari i Bashkisë Divjakë, është nxjerrë urdhëri nr. 283 datë 03.12.2021 “Për ngritjen e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit të Aktiveve të Bashkisë Divjakë për vitin 2021”. Janë ngritur 10 urdhëra për komisione inventarizimi, përkatësisht me numrat 284, 285, 286, 287, 288, 289, 290, 291, 292 dhe 293 me datë 03.12.2021, si dhe urdhëri numër 294 datë 03.12.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Divjakë për vitin 2021” si dhe urdhëri nr. 295 datë 03.12.2021 “Për ngritjen e komisionit të asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit të Bashkisë Divjakë për vitin 2021”.

Është kryer procesi i vlerësimit nga komisioni i vlerësimit më datë 02.03.2022 me nr. 1043/1 prot., Vendimi i Kryetarit të Bashkisë me nr. 51 datë 07.03.2022 “Për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi” me nr. 1043/2 Prot. Proçesverbali i komisionit të asgjësimit më datë 09.03.2022, me nr. 1215 Prot. Është bërë njohja e Këshillit Bashkiak për procesin e inventarizimit të aktiveve të vitit 2021 me informacionin e datës 15.03.2022 me nr. 1255/4 Prot.

Sipas pasqyrës së aktiveve, janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive afatgjata sipas vendimit nr. 51 date 07.03.2022 “Për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi”, nga llogaria 212 “Inventar i ndërtesave”, objekte në vlerën 9,258,017 lekë.

Nga llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vitin 2021, janë nxjerrë jashtë përdorimit vlera prej 100,000 lekë.

Nga llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” për vitin 2021, janë nxjerrë jashtë përdorimit materiale në vlerën 365,155 lekë.

Nga llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2021, janë nxjerrë jashtë përdorimit në vlerën 4,049,891 lekë.

Nga rakordimi i urdhërit përkatës për nxjerrje jashtë përdorimit, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve të qëndrueshme nuk rezultuan diferenca.

➤ Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2021.

Për vitin 2021, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”), nuk pasqyrohet në Pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.7 “Amortizimi”, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022.

Nga auditimi i Bilancit, Formatit 7, a dhe b: “Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)”, u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Divjakë për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2021 paraqitet për vlerën 901,563,023 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet për vlerën 1,121,739,344 lekë.

Nga PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera e llogarisë 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, është 1,121,739,344 lekë.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos

së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivitetit. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2021 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa dhe rrugë	Vlera e mbetur	5% vl/mbetur
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	5% vl/metur
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Për aktivitetet në proces nuk është llogaritur amortizim, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Nga auditimi, u konstatua se Bashkia Divjakë ka trashëguar nga reforma territoriale pasuritë e ish komunave të cilat janë konsoliduar në bashkinë aktuale të Divjakës. Lloji dhe sasia e pasurive të transferuara/konsoliduara në Bashkinë është paraqitur në **Aneksin PF21**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për ish komunën Grabjan, konstatohet se nuk ka dalë VKM-ja për miratimin e listës përfundimtare të pronave, por ka dalë VKM-ja nr. 133, datë 11.3.2004, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Grabjan”. Në Bashkinë Divjakë nuk ka informacion në lidhje me listën e inventarit të pronave të trashëguara nga kjo ish komunë.

Nga Bashkia Divjakë nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të aseteve, dhe rrjedhimisht nuk është kryer marrja në dorëzim, kolaudimi, vlerësimi, nuk është kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, nuk është aplikuar në ZVRPP/ASHK Lushnjë për regjistrimin e të gjitha aseteve, resurseve dhe pasurive të tjera, si dhe nuk është bërë regjistrimi në kontabilitet, i këtyre pasurive, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikat 37, 42-60, 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Nga grupi i auditimit u konstatua se nuk janë zbatuar kërkesat e pikës 13 pikës 21 të VKM-së nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Sa më sipër, marrja në dorëzim e këtyre pronave dhe aseteve të qëndrueshme nuk është bërë me procesverbale të nënshkruara nga përfituesi, Bashkia Divjakë apo ish-komunat, sot Njësi Administrative dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, administratë, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, funeral, zhvillim ekonomik, troje të lira, infrastrukturë, strehim, mbrojtje civile, bujqësi dhe ushqim.

Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30 dhe pika 35/a.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 43-63.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i

ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Divjakë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

Rekomandimi 2: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Rekomandimi 3: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

Rekomandimi 4: Nga Bashkia Divjakë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH, duke llogaritur edhe kamatëvonesat përkatëse. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”.

3. Aktivet Afatgjata Financiare:

Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2021 paraqiten në vlerën 395,095,000 lekë. E njëjta vlerë konstatohet edhe në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.

Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe QKB-së, u konstatua se Bashkia Divjakë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Sh.a. Divjakë, me K63731401A e cila është shoqëri aksionare me objekt “Ujësjetllës kanalizime”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 355,095 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **395,095,000 lekë**. Këto të drejta, Bashkia Divjakë i ka trashëguar nga reforma territoriale, si përfituese e pasurisë së ish-komunave Terbuf, Grabian, Gradishtë, Remas dhe Bashkisë Divjakë. Kjo vlerë është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël për vitin ushtrimor 2021, konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”. Gjithashtu, u konstatua se që nga viti 2013, nuk

është bërë asnjë ndryshim në kapitalin aksionar të kësaj shoqërie, pavarësisht se janë bërë vazhdimisht investime në rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve.

4. Investimet:

Titulli i gjetjes: Mosparaqitje e saktë e vlerës së llogarive 230/231 “Investime”

Gjendja e llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 99,323,241 lekë për llogarinë 231, në total 99,148,142 lekë. Vlerat e pasyruara në PF të disponueshme në Bashkinë Divjakë, janë të barabarta me vlerat e pasqyruara në PF në sistemin e thesarit.

Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 497,139,142 lekë, të cilat janë me fonde të deleguara. Vlera e kontraktuar (me TVSh), për investimet në proces gjatë vitit 2021 është 497,148,142 lekë, nga të cilat 496,126,333 lekë për objektin “Furnizim me ujë për zonat bregdetare Remas, Bashkia Divjakë” me kontratë nr. 360/12 datë 02.04.2021 me operator ekonomik “A.C.” shpk dhe 1021,809 lekë për “Mbikëqyrje punimesh për objektin furnizim me ujë zonat bregdetare Remas”, me kontratë nr. 545/1 datë 01.04.2021, me operator C.E.C.G..

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021, sipas aneksit nr. 9 pika 2. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, “Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël)”, “Aktive afatgjata materiale”, etj. Investimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2021, janë paraqitur në **Aneksin PF24**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2021 nuk paraqet vlerën reale, pasi duhet të pasqyronin vlerën 497,139,142 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Divjakë.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 43-63.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e investimeve të Bashkisë Divjakë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Financës të marrë masa për analizimin e saktë dhe sistemimin e vlerave me saktësi sipas posteve në bilancin kontabël, për llogaritë 230/231 “Investime në proces”.

➤ **PASIVET**

I. Pasivet Afat shkurt

1. Llogari të pagueshme:

Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Në datën 31.12.2021, shuma e llogarive 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore”, është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 40,649,087 lekë.

Analiza e grupit të llogarive të pagueshme për vitin 2021 është paraqitur në **Aneksin PF25**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2021 për Llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në bilanc paraqiten në vlerën 23,278,596 lekë. Në këtë llogari paraqiten detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2021.

Analiza e Llogarisë 401 “Furnitorë për mallra, produkte e shërbime”, është paraqitur në **Aneksin PF26**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 12,426,894 lekë, përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit për muajin dhjetor 2021.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 781,937 lekë përfaqëson detyrimet për tatimin mbi pagat e personelit në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 3,659,788 lekë përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 501,872 lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimet shëndetësore në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.

Në mbyllje të periudhës raportuese, llogaritë kreditore 42; 431; 435 dhe 436 në vlerën totale 17,370,491 lekë, përfaqësojnë detyrime të njësisë publike Bashkia Divjakë për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, shëndetësore si dhe tatimin mbi pagë, të përlllogaritura për pagesë në muajin dhjetor 2021, të cilat janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.

Detyrime të tjera afatshkurtra:

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht. Llogaritë për detyrime të tjera afatshkurtra janë paraqitur në **Aneksin PF27**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Titulli i gjetjes: Mosmarrja në dorëzim e kontratave të investimeve të mbyllura, mbajtja e garancisë përtej limiteve kohore.

Situata: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 22,527,248 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,589,616 lekë ose me rritje në vlerën 8,026,368 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të

Bashkisë Divjakë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Divjakë, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se shifra është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në bilancin e Bashkisë Divjakë.

Në mënyrë analitike, Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Aneksin PF28**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Divjakë, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Në pasqyrat financiare të Bashkisë Divjakë llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është në vlerën 30,589,616 lekë dhe rakordon me degën e thesarit Lushnjë. Nga verifikimi analitik i llogarisë 466 rezulton një diferencë prej 116,905 lekë. Për sa më sipër, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk paraqet vlerën e saktë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 43-63.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kap II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” i ndryshuar pikat 42-50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekt: Mosmarrja në dorëzim e objekteve janë verime të cilat nuk garantojnë nëse objekti është zbatuar sipas kushteve teknike të projekt/preventivave, si është realizuar dhe nëse është realizuar brenda kushteve teknike. Gjithashtu, moskryerja e këtij veprimi bën që nga Bashkia Divjakë të mos bëhet vlerësimi i subjekteve mbi cilësinë e punimeve dhe nëse këto subjekte janë shoqëri të besueshme për kryerjen e punimeve me cilësi dhe në afatet të caktuar, si dhe vënia në vështirësi ekonomike e OE, të cilëve iu nevojiten fondet e ngurtësuara për të vazhduar veprimtarinë e tyre ekonomike.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 369,242,510 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie është 487,062,104 lekë ose me rritje në vlerën 117,819,594 lekë.

Në mënyrë analitike, llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Aneksin PF29**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjendja e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 119,264,722 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 92,060,205 lekë ose me zbritje në vlerën 27,204,517 lekë.

Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit. Në mënyrë analitike, Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Aneksin PF30**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

Gjendja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*” (Kapitali i nënshkruar) në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 3,966,706,930 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 4,165,057,977 lekë ose me rritje në vlerën 198,351,047 lekë.

Gjendja e llogarisë 85 “*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*” (*Humbja/fitimi i ushtrimit*) në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 46,504,974 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 59,754,945 lekë ose me rritje në vlerën 13,249,971 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Llogaritë 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*” për vitin 2020 është në vlerën 2,200,000 dhe për vitin 2021 kjo llogari është mbyllur me vlerën 99,323,241 leke për investimin në proces “*Furnizim me ujë të pishëm zona bregdetare Remas, Bashkia Divjakë*” dhe 106 “*Teprica e Granteve kapitale të huaja*”, si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 0 (zero).

Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepriçë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarrë në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim. Pasqyra e performancës financiare në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Aneksin PF31**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.

Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:

a. Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);

b. Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;

i. fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);

ii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivët afatgjata materiale dhe aktivët afatgjata jo materiale*);

iii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*SKK 3 “Instrumentet Financiare”*);

iv. Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet

Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së

pasqyrës së performancës.

Pasqyra e përfundimit tregon, minimalisht, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja është rreshti i fundit i kësaj pasqyre.

➤ **TË ARDHURAT**

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:

Llogaria 70 “*Të ardhurat nga taksat e tatimet*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 66,931,050 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 53,626,444 lekë ose me ulje në vlerën 13,304,606 lekë. Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në **Aneksin PF32**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 71 “*Të ardhura jotatimore*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 40,844,608 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 85,680,323 lekë ose me rritje në vlerën 44,835,715 lekë. Të ardhurat jotatimore janë paraqitur të detajuara në **Aneksin PF33**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

2. Të ardhura të tjera:

Llogaria 72 “*Grante korente*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 512,559,977 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 533,931,758 lekë ose me rritje në vlerën 21,371,781 lekë. Në zërin 7207 “*Sponsorizime te brendshme*” për vitin 2020 është 319,700 lekë, për vitin 2021 është në vlerën 1,108,500 lekë, pra me një rritje prej 788,800 lekë. Në llogarinë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 19,881,588 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 20,691,275 lekë ose me ulje në vlerën 809,687 lekë.

Grantet korente, të ardhurat e tjera dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve janë paraqitur të detajuara në **Aneksin PF34**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **SHPENZIMET**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 165,680,870 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 187,463,435 lekë ose me rritje në vlerën 24,872,565 lekë.

Llogaria 601 “*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 28,856,318 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,344,525 lekë ose me rritje në vlerën 1,488,207 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Lushnjë me të njëjtën vlerë. Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqitur në **Aneksin PF35**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Testimi i llogarisë 600 “*Paga dhe shpërblime*”**

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 300 datë 29.12.2020. Numri i miratuar i punonjësve të Bashkisë Divjakë, funksioneve të transferura dhe gjendjes civile ka qenë 462 punonjës. Sipas listëpagesave janë paguar mesatarisht 346 punonjës për Bashkinë Divjakë dhe 106 punonjës për Ndërmarrjen e shërbimeve publike, në total 452 punonjës. Sa më sipër, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve. Numri i punonjësve sipas listëpagesave është paraqitur në **Aneksin PF36**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Numri i punonjësve sipas Vendimit nr. 300 datë 29.12.2020 është i ndarë si më poshtë:

1. Administrata e Bashkisë 141 punonjës

2. Njësia Administrative Gradishtë	27 punonjës
3. Ndërmarrja e Shërbimeve publike	106 punonjës
4. Njësia Administrative Remas	22 punonjës
5. Njësia Administrative Tërbuf	32 punonjës
6. Njësia Administrative Grabian	18 punonjës
7. Funksione të deleguara arsimit	71 punonjës
8. Sektori MZSH(funksion deleguar)	14 punonjës
9. Specialist i bujqësisë (funksion i deleguar)	26 punonjës
10. Gjendja civile	5 punonjës
Totali:	462 punonjës

Auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit (me arsim të lartë).

Në auditimin e dosjeve të personelit krahasuar me nivelin e klasave, kategorinë, pagën e grupit, shtesat për vjetërsi, vështirësitë, pozicionin, etj, u konstatua se janë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të VKM-së nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar dhe në dosjet personale të nëpunësve administrohet:

Dokumenti i identifikimit (fotokopje letërnjoftimi); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor në fushën e studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokument i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti); raporti mjeko ligjor; librezë pune; fotografi; CV; letër Motivimi; Dëshmi të tjera kualifikimi. Disa nga dosjet që u audituan janë paraqitur në **Aneksin PF37**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ Hartimi i listëpagesave për vitin 2021

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e muajve mars, gusht dhe nëntor 2021, nga ku u konstatua se janë plotësuar konform rregullave të përcaktuara. Listëprezencat janë të konfirmuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore znj. A.M., Administratorët e Njësive përkatëse dhe drejtorët për funksionet e deleguara. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Listëpagesat për çdo muaj janë firmosur nga Specialitja e financës znj. A.S., Drejtorja e Buxhetit dhe financës znj. F.M. dhe Kryetari Bashkisë z. F.K..

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Divjakë, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 79,475,537 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 103,352,366 lekë ose me rritje në vlerën 23,876,829 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Lushnjë me të njëjtën vlerë. Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime janë paraqitur në **Aneksin PF38**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dyja palët. Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë të dokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaramet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➤ **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare në katër njësi administrative dhe Bashki Qendër, Njësia Tërbuf, Njësia Grabian, Njësia Gradishtë, Njësia Remas dhe Njësia Qendër si arkëtime të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjoba të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Për vitin 2021, janë prerë 4,380 Mandat Arkëtime në vlerën 63,915,730 lekë dhe libri i arkës është mbyllur me datë 30.12.2021.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2021 janë derdhur totalisht në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është 0 (zero) lekë. Gjithashtu, është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 63, 64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Divjakë për të ardhurat.

U kryen procedura testimi analitik me përzgjedhje kampionesh për zona të ndryshme llogarish, duke bërë verifikim të fondeve të planifikuara dhe të përdorura, të përlllogaritjeve të vlerave për transaksione financiare të kryera si rezultat i ndodhjes së ngjarjeve ekonomike si dhe verifikimi i përputhshmërisë ligjore i dokumentacionit shoqërues mbështetës nëse ato ishin kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 40 “Shpenzimet” pika 1.

Titulli i gjetjes: Probleme në lidhje me kryerjen e veprimeve kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet

buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivitetit.

Situata:

➤ **Kontratat e lidhura për vitin 2021**

Për vitin 2021, vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 497,139,142 lekë, të cilat janë me fonde të deleguara. Vlera e kontraktuar (me TVSh), për investimet në proces gjatë vitit 2021 është 497,148,142 lekë, nga të cilat 496,126,333 lekë për objektin “Furnizim me ujë për zonat bregdetare Remas, Bashkia Divjakë” me kontratë nr. 360/12 datë 02.04.2021 me operator ekonomik “A.C.” shpk dhe 1,021,809 lekë për “Mbikëqyrje punimesh për objektin furnizim me ujë zonat bregdetare Remas”, me kontratë nr. 545/1 datë 01.04.2021, me operator C.E.C.G..

Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njëzia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.3., faqe 43-63.

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, UMF nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”; SKK nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale” pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Divjakë.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të

llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivitetin e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. F.K., me funksion Kryetar aktual i Bashkisë Divjakë, znj. F.M., Drejtorë i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës dhe z. P.T., me detyrë përgjegjës i zyrës së financës.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për periudhën 01.07.2021-30.09.2022, Bashkia Divjakë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej 8 procedura prokurimi me vlerë kontrate 56,771 mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 4,363 mijë lekë ose 8%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.07.2021-30.09.2022	Nr.	Vl. Fond Limit	Vl. Kontrate
GJITHSEJ	8	61,134,620	56,771,600
- Të hapura	2	38,195,404	37,778,738
- E hapur e thjeshtuar	6	22,939,216	18,992,862
- Shërbim konsulence		0	0
- Negocim pa shpallje		0	0
Sipas objekteve			
- Objekte në fushën e punëve publike		0	0
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	8	61,134,620	56,771,600

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej 26 OE/BOE, nga të cilat janë skualifikuar 1 OE/BOE.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

- 5 procedura prokurimi për periudhën Korrik 2021-Shtator 2022 me vlerë kontrate 47,315 mijë lekë, ose 83% të fondit të kontratave të lidhura për periudhën objekt auditimi. *Pasqyruar në tabelën në Kapitullin “Anekse – Procedurat e prokurimit”.*

➤ **Likuidimi i kontratave të lidhura për vitin 01.07.2021-30.09.2022.**

Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, në lidhje me likuidimin e kontratave të lidhura për periudhën Korrik 2021-Shtator 2022, konstatohet se:

Për 5 procedurat e audituara me vlerë kontrate 567,785 mijë lekë me TVSH, nga Bashkia Divjakë në respektim të afatit të kontratave është bërë likuidimi i vlerës prej 19,447,711 lekë me TVSH, duke mbetur për likuidim vlera 37,330,881 lekë me TVSH, ose 72% e vlerës së kontratave të lidhura.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën për auditimin procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant për nevojat e Bashkisë Divjakë për vitin 2022”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 148, Nr. 1913 prot., datë 26.04.2022	3.2 Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 148, datë 26.04.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Nr. 148/1, datë 27.04.2022 1. F.V. (Kryetar) 2. A.B. (Anëtar) 3. L.T. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E hapur	1. S.SH. (Juriste) 2. E.H. (Inxhinier) 3. R.M. (Ekonomist)	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 26,528,738 lekë 31,834,486 lekë me TVSH Likujduar 13,518,372 deri 30.09.2022	6. Oferta fituese: “G.C.G.” shpk Vlera e shprehur me normë fitimi: 11.9 lekë/litër, lidhur me kontratë nr. 1913/14 prot., datë 31.05.2022 me afat deri 31.12.2022.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 13.05.2022	9. Burimi Financimit: "Të Ardhurat e Bashkisë Divjakë + Grant".	10. Operatorët Ekonomike: a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE G.C. shpk me normë fitimi 11,9 lekë/litër K.O. shpk me normë fitimi 28 lekë/litër
11. Ankimime në AK JO	12. Përgjigje ankesës nga AK JO	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP: JO

Titulli i gjetjes: Mangësi të konstatuara në llogaritjen e fondit limit, copëzimin e fondeve dhe shmangie nga procedurat standard të prokurimit, si dhe mungesa e specialistëve të fushës në KVO.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme, u konstatua se nuk argumentohet dhe dokumentohet përlllogaritja e fondit limit, si më poshtë vijon:

Me urdhër nr. 143, datë 14.04.2022 nr. 1766 prot., të titullarit të AK Bashkia Divjakë, është ngritur Komisioni “Për përlllogaritjen dhe argumentimin e fondit limit” me objekt “Karburant për nevojat e Bashkisë Divjakë për vitin 2022”, i përbërë nga z. A.Ç., z. D.Z., znj. Z.M. dhe z. F.N..

- Sasia totale e nevojshme për konsum për vitin 2022 është bërë sipas kërkesave nga 4 sektorë, përkatësisht: Agjencia e Shërbimeve Komunale; Drejtoria e Bujqësisë, Administrimi i Ujrave, Pyjeve dhe Mjedisit; Sektori për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin; Drejtoria e Rrugëve Rurale dhe Mjeteve për tenderin më objekt “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Divjakë për vitin 2022”.

Komisioni për llogaritjen e fondit limit, është bazuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 76, gërma “b” ku citohet: “studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”.

- Në përfundim është caktuar çmimi mesatar për një litër naftë 226 lekë/litër si dhe çmimin mesatar për një litër benzinë 209 lekë/litër me TVSh (përfshirë akcizën, taksën e karbonit, markim karburanti) me marzh fitimi 11.9 lekë/litër dhe sasia 133,410 litra naftë dhe 8,056 litra benzinë pra vlera totale 26,528,738 lekë pa TVSH dhe 31,834,486 lekë me TVSH.

- Në procedurën e mësipërme, gjatë fazës së hartimit të kërkesave sipas sektorëve përkatës, për sasinë e nevojshme të kaburantit, rezulton se është kërkuar edhe sasia prej 1,980 litra naftë, që do të përdoret për kaldajat në 3 shkolla, përkatësisht Grabian, Çërme e Sipërme dhe Çermë Sektor. Grupi i auditimit me qëllim vlerësimin nëse kërkesa për naftë për kaldajat është e argumentuar, shqyrtoi inventarin e 3 shkollave të mësipërme (llogaria 214), me qëllim verifikimin nëse shkollat e mësipërme kanë të instaluar kaldaja për ngrohje. Nga ky verifikim rezultoi se në inventar, nuk rezultoi që në inventarin e shkollave të mësipërme të kishte kaldaja. Kjo situatë krijon bindjen e arsyeshme të grupit të auditimit, se kërkesa për 1,980 litra naftë është e paargumentuar me dokumentacion justifikues.

- Gjithashtu për policinë bashkiake është miratuar sasia prej 9,000 litra naftë (sasi e nevojshme për aktivitetin e kësaj strukture përgjatë vitit 2022). Për këtë sasi, nga shqyrtimi i dosjes së procedurës së mësipërme nuk administrohet kërkesa e policisë bashkiake, përfaqësuar nga kryeinspektori i saj. Për më tepër që sasia e karburantit për policinë bashkiake, nuk dokumentohet me program pune vjetor, ku përcaktohen punët/aktivitetet që do të kryhen, për të arritur në vlerësimin e sasisë së nevojshme për karburant, e cila kushtëzon edhe përcaktimin e fondit limit.

- Gjithashtu u konstatua se ka pasur një rast copëzim fondi për procedurën blerje karburanti për MZSH dhe ASHK - nga arsyetimi që na është dhënë nga subjekti rezulton se këtë procedurë prokurimi e kanë realizuar në kushtet e emergjencës për shërbimet e MZSH dhe Agjensisë së Shërbimeve Komunale si dhe janë konsultuar me APP për këtë rast, por komunikimi me APP-në nuk është dokumentuar. Për procedurën Blerje karburanti është shmangur procedura e prokurimit publik. Ky veprim ka shmangur konkurrencën dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, veprime për të cilin mban përgjegjësi AK z. F.K. në cilësinë e titullarit si dhe znj. S.SH. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.

- Veç sa më sipër, u konstatua mungesa e specialistëve të fushës në përbërjen e KVO-së. Konkretisht me urdhërin nr. 146/1, datë 27.04.2022, nga titullari i AK z. F.K. është krijuar komisioni për vlerësimin e ofertave me përbërje z. F.V. kryetar dhe anëtarët znj. E.H. dhe znj. V.L.. Nga verifikimi i profilit të përbërjes së anëtarëve të KVO rezulton se asnjë prej tyre nuk është ekspert i fushës së objektit të prokurimit.

Vlerësimi i ofertave

- Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 2 dhe 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

- G.C. shpk me normë fitimi 11,9 lekë/liter;

- K.O. shpk me normë fitimi 28 lekë/liter.

- Në përfundim është skualifikuar OE “K.O. ShPK” Sh.P.K, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit. Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së mësipërme, skualifikimi i OE “K.O. ShPK”

Sh.P.K qëndron.

-Është shpallur fitues OE "G.C." shpk me marzh fitimi 11.9 lekë/litër. Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së mësipërme, kualifikimi dhe shpallja fitues i OE "G.C." Sh.P.K qëndron.

-Për mangësitë e konstatuara në procedurën e mësipërme, mban përgjegjësi z. F.K., Kryetari i Bashkisë Divjakë, njëkohësisht Nëpunësi Autorizues, si dhe komisioni për përllogaritjen dhe argumentimin e fondit limit, i përbërë nga z. A.Ç., z. D.Z., znj. Z.M. dhe z. F.N..

Kriteri: Pika 4 në nenin 12, pika 2 në nenin 34, neni 73, pika 2 në nenin 74, paragrafi i parë në nenin 75 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; Pika 2 në nenin 56, paragrafi 2 pika 3 dhe pika 11 në Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar; Neni 8 dhe neni 9 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Copëzimi i vlerës së kontratës sjell që kontrata me vlerën 959,960 lekë pa tvsh të përjashtohet nga disa kriteret të përcaktuara në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të cilat aplikohen në rastin e kontratave për blerje mallrash me vlerën ndërmejt kufirit të ulët dhe kufirit të lartë monetar për rrjedhojë shmangien nga procedura përkatëse sipas rregullave të prokurimit publik. Procedura e prokurimit paraqet një risk në përgatitjen e dokumentacionit të duhur ligjor, si dhe fazën e vlerësimit të ofertave.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik. Planifikim i gabuar i kohës së nevojshme për të zhvilluar procedurën e prokurimit publik për blerjen dhe sigurimin e mallit të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të institucionit.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat që në:
- Hartimin e regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve, si dhe në raste emergjencash procedura duhet të jetë e dokumentuar.

- Ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

Rekomandimi: Njëësia e Prokurimit Bashkia Divjakë, në rast se detyra e përllogaritjes së fondit limit nuk i është caktuar një grupi tjetër, të marrë masat e nevojshme, që në rastin e prokurimit të karburantit, të argumentoj dhe dokumentoj përllogaritjen e fondit limit.

2. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Shërbim dezinfektimi i zonës urbane qyteti Divjakë dhe i strugave ujëmbajtëse në zonën e parkut dhe të plazhit për vitin 2022"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 115 Nr. 1220 prot., datë 10.03.2022	3. Hartuesit e DT: Urdhër nr. 115, datë 10.03.2022 1. S.SH. (Jurist) 2. D.S. (S. Mjedisi) 3. R.M. (Ekonomist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 115/2 datë 16.03.2022 1. F.V. (kryetar) 2. A.B. (anëtar) 3. E.H. (anëtar)
2. Lloji i Procedurës Prokurimit: Procedurë e Hapur		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 11,666,666 lek pa Tvsh	6. Oferta fituese: N. shpk 11,250,000 lekë pa Tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 416,666 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 13.05.2022	9. Burimi Financimit: Nga të Ardhurat e Bashkisë Divjakë	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Kualifikuar "N." shpk c) Skualifikuar "A." shpk
11. Ankim AK: Po, Nga subjekti "M." shpk date 28.03.2023	12. Përgjigje ankesës nga AK Po	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Po

Titulli i gjetjes: Mangësi të konstatuara në llogaritjen e fondit limit, vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës së prokuruar. Gjithashtu është konstatuar mëngësi edhe në vlerësimin e ofertës së shpallur fituese.

Situata: Nga auditimi i procedurës së mësipërme, u konstatua se nuk argumentohet dhe dokumentohet përlllogaritja e fondit limit, si më poshtë vijon:

Mbi dokumentimin e procedurës së përlllogaritjes së fondit limit.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Divjakë me nr. 83 datë 09.02.2022 me nr. 655 prot., është ngritur “Komisioni për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit si dhe përcaktimin e specifikimeve teknike” i përbërë nga z. A.Gj. (p/ sektori i veterinarisë së mjedisit dhe pyjeve), z. F.D. (teknik pyjor) dhe z. I.N. (ekonomist). Në dosje nga ky komision është administruar procesverbali nr. 665/1 prot., datë 02.03.2022 “Për hartimin e preventivit, përlllogaritjen e fondit limit si dhe përcaktimin e kriterëve teknike për tenderin me objekt: “Shërbim dezinfektimi i zonës urbane qyteti Divjakë dhe i strugave ujëmbajtëse në zonën e parkut dhe të plazhit”.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se komisioni i përlllogaritjes së fondit limit nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përcaktimin e sipërfaqeve dhe zonave problematike ku duhet të kryhet shërbimi i dezinfektimit. Administrrohet plan vendosja, por rezulton se nuk janë bërë matjet në terren dhe sipërfaqja prej 300 Ha nuk është e argumentuar dhe dokumentuar.

Mbi përcaktimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Në pikën 1 është kërkuar përdorimi i agjentit biologjik për mushkonja varieteti Bti: *Bacillus thuringensis israelensis*, shtami AM65-52 i kombinuar me *Bacillus sphaericus*, shtami ABTS 1743, i cili do të përdoret në të gjitha sipërfaqet me ujë të ndenjtur ku depozitohen larvat e mushkonjave në zonat e mbrojtura mjedisore siç është Parku Kombëtar “Divjakë-Karavasta”. Këto produkte kanë karakteristikën e të qenurit efektiv, të padëmshme dhe duke mos ndikuar në mjedis mbi organizmat e tjerë ujore - Nuk argumentohet pse duhet kërkuar një produkt specifik ndërkohë që në treg ka edhe produkte ekivalente dhe efektive të cilët nuk kushtëzojnë pjesmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomike, si psh produktet me bazë vetëm Bti me 3000 ITU në formë të tretshme në ujë dhe gjithashtu është një produkt efektiv - Nuk argumentohet pse duhet kërkuar një produkt specifik ndërkohë që në treg ka edhe produkte ekivalente dhe efektive të cilët nuk kushtëzojnë pjesmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomike, si psh produktet me bazë vetëm Bti me 3000 ITU në formë të tretshme në ujë dhe gjithashtu është një produkt efektiv).

Në pikën 2 është kërkuar instalimi i kurtheve të monitorimit me akull të thatë për vlerësimin e mushkonjave të rritura.

Në pikën 8 është kërkuar që përpara kryerjes së shërbimit sipas preventivit dhe grafikut të shërbimeve, Drejtuesi Teknik i operatorit ekonomik duhet të bëjë fillimisht inspektimin e situatës dhe terrenit të jashtëm e të brendshëm për të përcaktuar në mënyrë sa më të saktë që të jetë e mundur vendet e nevojshme dhe më të përshtatshme në cilat duhet të kryhen shërbimet që të jenë sa më efektive. Më pas, sipas frekuencës së kërkuar, punonjësit e Operatorit duhet të bëjnë monitorimin e situatës dhe verifikimin e rezultatit të shërbimit në pikat kritike dhe nëse shërbimi nuk ka dhënë rezultat, të bëhet rivlerësim i pikave apo vendeve kritike - Në lidhje me pikën 2 dhe pikën 8, këto detyra nuk mund ti lihen OE pasi mund të ketë abuzime në raportimin e të dhënave. Nëse Bashkia e ka të pamundur të bëjë një vlerësim për përcaktimin e madhësisë së popullatës së mushkonjave, pra sa mushkonja ka në një zonë të caktuar mbi të cilën të bëhet dhe vlerësimi i ilaçit që do të përdoret atëherë si fillim duhet të prokurorë shërbimin e projektimit/studimit të rastit në fjalë e më pas prokurimin e procedurës për luftimin e mushkonjave).

Në pikën 4 është kërkuar shpjegimi i trajtimeve me teknika të ndryshme sipas zonave në fjalë (mjegullimi i ftohtë me atomizues, pompë me presion të lartë për lëngje, atomizator shpine për

granula dhe lëngje, granulator dore).

Pika 2.3.3 – Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë të paktën 3 (tre) aparate mjegulluese për mjegull të ftohte dhe pompë me presion të lartë, të montuar në kamionçinë - Kërkesa e sipërcituar nuk është e argumentuar si dhe nuk është në përputhje me produktin e specifikuar nga AK, nga verifikimet që kemi kryer produkti Bti+Bs, është në trajtën e ngurtë granulare, pra kërkohet dicka që nuk e justifikon përdorimin e saj.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, S.SH., D.S. dhe R.M..

Vlerësimi i ofertave

- Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me pikën 4 paragrafi 2 në nenin 80, dhe nenin 84 të VKM-së nr. 285, datë 18.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

- N. shpk me ofertën në vlerën 11,250,000 lekë.

- A. shpk me ofertën 0 lekë.

-Është shpallur fitues OE “N.” ShPK me ofertën ekonomike në vlerën 11,250,000 lekë, me diferencë nga fondi limit 416,666 lekë, ose 3.5% më pak.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së mësipërme, konstatohet se OE shpallur fitues nuk ka paraqitur dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, pasi në dosje administrohen furnizime të ngjashme vetëm për vitin 2020.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO, me përbërje F.V., Kryetar, A.B. dhe E.H. Anëtar.

Kriteri: Pika 2 në nenin 2, pika 3 në nenin 34, pika 4 në nenin 36, pika 3 në nenin 73, pika 1 në nenin 80, Shkronja “d” në pikën 1 në nenin 98 dhe pika 3 në nenin 92 në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

Pikën 2 në nenin 76, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Procedura e prokurimit paraqet mungesë transparencë në llogaritjen e fondit limit. Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit duke favorizuar drejtpërdrejtë operatorë prodhues ose operatorë të cilët janë distributor të vetëm i një produkti/marke të caktuar specifik. Nuk sigurohet mirëpërdorim i fondeve publike, si dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e punimeve të kryera/cilësinë e mallit të prokuruar.

Shkaku: Mungesa e respektimit të kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Divjakë, në lidhje me vendosjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike për zbatimin e kontratës në DST, të mbajë në konsideratë kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

- NJP Bashkia Divjakë, në rast se detyra e përlllogaritjes së fondit limit nuk i është caktuar një grupi tjetër, të marrë masat e nevojshme, që në rastin e prokurimit të shërbimit të dezinfektimit, të argumentojë dhe dokumentojë përlllogaritjen e fondit limit.

3. Procedura Prokurimit objekt: “Blerje ushqime për kopshtin Divjakë dhe kopshtin Çermë Sektor Nj/Adm Tërbuf Bashkia Divjakë, për vitin 2022”

1. Urdhër Prokurimi nr. 313

3. Hartuesit e DT:

4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:

Nr. 5374 prot., datë 28.12.2021	Urdhër nr. 313, datë 28.12.2021	Urdhër nr. 313/1 datë 30.12.2021
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”	1. V.L. (Juriste) 2. E.H. (Inxhinier) 3. I.K. (Ekonomiste)	1. F.V. (Kryetar) 2. E.N. (Anetar) 3. S.SH. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,262,673 lekë, realizimi për Loti II dhe Loti III, fondi limit është në vlerën 3,323,461 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese: “P.” Për Loti II dhe Loti III është në vlerën 3,030,954 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Për Lotin II dhe Lotin III është në vlerën 292,507 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: datë, 14.01.2022 Ora 10	9.Burimi Financimit: Të ardhura e Bashkisë Divjake	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE, N. shpk dhe P. shpk b) Kualifikuar P. shpk
11.Ankim AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK Jo	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo
	14. Data e lidhjes së kontratës: dt. 01.02.2022	15. Afati i kontratës Deri më 31.12.2020

Titulli i gjetjes: Shpallja fitues e OE në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuar në DST.

Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të larta, u konstatua se në procedurën me objekt: “**Blerje ushqime për kopshtin Divjakë dhe kopështin Cermë Sektor Nj/Adm Tërbuf Bashkia Divjakë**” OE është shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të përcaktuara nga NJP në DST, si më poshtë vijon:

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE “N.” shpk i cili ka ofertuar me vlerë 3,142,102 lekë pa TVSH dhe OE “P.” shpk i cili ka ofertuar me vlerë 3,030,954 lekë pa TVSH.

- Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 80, pika 4 dhe nenin 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Në përfundim të procedurës së vlerësimit të ofertave KVO ka vendosur skualifikimin e OE “N.” ShPk. Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së mësipërme, skualifikimi i OE “N.” Sh.P.K qëndron.

- KVO ka shpallur fitues OE “P.” shpk, me ofertën ekonomike 3,030,954 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit në vlerën 292,507 lekë, ose 9.6% më pak.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përse i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:

- OE shpallur fitues nuk ka sjellë xhiron e realizuar përgjatë 3 viteve të fundit. Nga verifikimi në QKB rezulton se OE është i regjistruar në datë 04.10.2019. OE ka sjellë vetëm xhiron e vitit 2020.

- OE nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, si dhe nuk ka sjellë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratave të kryera me sukses.

Për sa më sipër mban përgjegjës KVO, me përbërje, z.F.V., znj.E.N. dhe znj.S.SH..

Kriteri: Pika 1 në nenin 80, Shkronja “d” në pikën 1 në nenin 98, pika 3 në nenin 73 dhe pika 3 në nenin 92 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

Neni 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,

Shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e RPP” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Nuk sigurohet mirëpërdorim i fondeve publike, si dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e punimeve të kryera/cilësinë e mallit të prokuruar.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë

masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

4. Procedura e Prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e Bashkisë Divjakë”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 146 Nr. prot.1809, datë 19.04.2022	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit: Urdhër nr. 146, datë 19.04.2022 1.S.SH. (Juriste) 2.A.J. (Ekonomiste) 3.L.T. (Inxhiniere)	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 146/1 datë 27.04.2022 1.F.V. (Kryetar) 2.E.H. (Anetar) 3.V.L. (Anëtare)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,294,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: “M.” shpk 4,998,500 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 295,500 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 09.05.2022	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e Bashkisë + Granti	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)Kualifikuar OE “M.” shpk
11.Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK Jo	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO
	14. Data e lidhjes së kontratës: 25.05.2022	15. Afati i kontratës Deri më 31.12.2022

Titulli i gjetjes: Në Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka specialistë të fushës. Vendosija e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara ligjërisht dhe teknikisht, si dhe jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës së prokuruar. Shpallja fitues e OE në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuar në DST.

- Me urdhërin nr.146, datë 27.04.2022, nga titullari i AK z. F.K. është krijuar Njësia e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e Bashkisë Divjakë për vitin 2022”, me përbërje znj. S.SH. kryetar dhe anëtarët znj. A.J. e z. R.M.. Nga verifikimi i profilit të përbërjes së anëtarëve të NjP rezulton se asnjë prej tyre nuk është specialist i fushës së objektit të prokurimit. Gjithashtu titullari i AK nuk ka marrë masat e duhura për krijimin e komisioneve me përbërje specialist dhe ekspert të fushës.

- Gjithashtu me urdhërin nr. 146/1, datë 27.04.2022, nga titullari i AK z. F.K. është krijuar komisioni për vlerësimin e ofertave me përbërje z. F.V. kryetar dhe anëtarët znj. E.H. dhe znj. V.L.. Nga verifikimi i profilit të përbërjes së anëtarëve të KVO rezulton se asnjë prej tyre nuk është ekspert i fushës së objektit të prokurimit.

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. F.K. në cilësinë e titullarit të AK.

Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Pika 2.3.5 – AK ka kërkuar që OE duhet të jetë i pajisur me çertifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë BS OHSAS 18001:2007 ose BS OHSAS 45001:2018 mbi “Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015

- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015

NjP ka argumentuar se “Pajisja me certifikatat e mësipërme, bën të mundur që në kryerjen e riparim-shërbimeve të kërkuara, të kemi një besueshmëri më të lartë në raport me menaxhimin e cilësisë, me menaxhimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë si dhe në raport me menaxhimin e ruajtjen e mjedisit”, por vendosja e këtyre kriterëve, në kushtet kur ka institucione përkatëse të specializuara dhe të ngarkuara me dispozita ligjore për të monitoruar dhe siguruar kushtet e sigurisë në punë, por dhe mbrojtjen e mjedisit, në gjykimin e grupit të auditimit kufizojnë konkurrencën.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, S.SH., A.J., L.T..

Vlerësimi i ofertës.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE “M.” shpk i cili ka ofertuar me vlerë 4,998,500 lekë pa TVSH dhe shpallur fitues, me diferencë nga fondi limit në vlerën **295,500 lekë pa TVSH, ose 5.5% më pak.**

- Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 80, pika 4 dhe nenin 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përsa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:

- OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur makineri teknologjike, si trapano magnetike, bareno.

- Në DST kërkohet që OE duhet të kryej riparim – shërbim dhe furnizimin me pjesë këmbimi të eskavatorëve dhe mjeteve të transportit – nga verifikimi i kryer OE nuk rezulton të ketë pikë të tregëtimit të pjesëve të këmbimit për eskavatorë dhe mjete të transportit, si dhe ne QKB rezulton se nuk e ka të përfshirë si objekt të aktivitetit.

- Nga verifikimi i dëshmimeve profesionale të punonjësve rezulton se punonjësi që punon pranë OE si xhenerik, ka përfunduar kursin si mekanik i përgjithshëm dhe punonjësi që punon si tornitor ka përfunduar kursin si mekanik.

- OE nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e kryera gjatë tre viteve të fundit, si dhe për përvojën e mëparshme nuk ka vërtetime të lëshura nga një ent publik.

Për sa më sipër mban përgjegjës KVO, me përbërje: z. F.V., z.E.H. dhe znj. V.L..

Kriteri: Pika 2 dhe neni 73, neni 74, paragrafi i parë në nenin 75 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Pika 2 në nenin 2, pika 4 në nenin 36, pika 3 në nenin 73, pika 1 në nenin 80, pika 3 në nenin 92, shkronja “d” në pikën 1 në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Procedura e prokurimit paraqet një risk në përgatitjen e dokumentacionit të duhur ligjor, si dhe fazën e vlerësimit të ofertave. Mos nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit duke favorizuar drejtpërdrejtë operatorë prodhues ose operatorë të cilët janë distributor të vetëm i një produkti/marke të caktuar specifik. Nuk sigurohet mirëpërdorim i fondeve publike, si dhe mund të ndikojë negativisht në cilësinë e punimeve të kryera/cilësinë e mallit të prokuruar.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat e duhura që në ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Divjakë, në lidhje me vendosjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike për zbatimin e kontratës në DST, të mbaj në konsideratë kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

5. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje lubrifikantë, vajra, graso, filtra, për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë”

1. Urdhër Prokurimi nr. 96 Nr. 879 prot., datë 21.02.2022	3.Hartuesit e DT: Urdhër nr. 96, datë 21.02.2022 1. V.L. (Juriste) 2. E.H. (Inxhinier) 3. A.S. (Ekonomist)	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. 879/2 datë 21.02.2022 1. F.V. (Kryetar) 2. L.T. (Anëtar) 3. S.SH. (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës: “E hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,907,111 lekë pa Tvsh	6.Oferta fituese: OE “E.”sha 1,507,300 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 399,811 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 04.03.2022, Ora 10:00	9.Burimi Financimit: Të ardhura e Bashkisë Divjakë + Granti për mjetet e Drejtorisë së Bujqësisë Bordi Ujitje -Kullim	10.Operatoret Ekonomik a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) Kualifikuar 1 “E.” sh.a
11. Ankim AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK Jo	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo
	14. Data e lidhjes së kontratës: 29.03.2022	15. Afati i kontratës 10 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës

-Nga auditimi i procedurës së mësipërme, rezultoi se përcaktimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe vlerësimi i ofertës së shpallur fituese, janë bërë në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës.

Komisioni për argumentimin e fondit limit

Me kërkesë nr. 578/1 prot., datë 14.02.2022 të Drejtorit të Rrugëve Rurale z. A.Ç. drejtuar Sektorit Juridik, Bashkia Divjakë është kërkuar zhvillimi i procedurës së prokurimit “*Blerje lubrifikantë, vajra, graso, filtra, për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë*”.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Divjakë nr. 76 prot., datë 04.02.2022, nr. 578 prot., është ngritur “*Komisioni për argumentimin e fondit limit*” i përbërë nga z. A.Ç., zj. G.Gj., dhe zj. S.K.. Në dosje janë të administruara dhe formulari i deklaramit të konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Përlllogaritja e fondit limit është bërë duke testuar çmimet e tregut duke marrë 3 oferta nga operatorë të ndryshëm OE “K.” sha datë 07.02.2022, OE “K.O.” shpk, datë 08.02.2022 dhe OE “A.R.” shpk, datë 08.02.2022).

Njësia e prokurimit

a. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, “*Zhvillimi i procedurave*”, pika 2, “*Hartimi i dokumenteve të tenderit*”. Në dosje ndodhen dhe formularët e deklaramit të konfliktit të interesit të firmosura të gjithë nga NJP.

Me nr. 879/3 prot., datë 21.02.2022 është mbajtur procesverbali nga NJP ku janë vendosur kriteret teknike për dokumentet e tenderit e DST të cilat janë firmosur nga ana e kësaj Njësie në çdo fletë.

Janë administruar procesverbalet “*Mbi hapjen e verifikimin dhe vlerësimin e ofertave të OE*” për tenderin me objekt “*Blerje lubrifikantë, vajra, graso, filtra, për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë*” ku është konstatuar se kanë marrë pjesë OE “E.” shpk i cili ka ofertuar në vlerën 1,507,300 lekë pa tvsh dhe OE “T.O.” shpk i cili ka ofertuar në vlerën 1,555,520 lekë pa tvsh. Ky procesverbal është firmosur nga KVO dhe NJP në të gjitha fletët e tij.

b. Janë administruar formularët e deklaramit të konfliktit të interesit për KVO të cilat janë firmosur prej tyre.

Me nr. 533/3 prot., datë 17.02.2020 është administruar procesverbali “*Mbi hapjen e verifikimin e ofertave të OE për tenderin me objekt “Blerje lubrifikantë, vajra, graso, filtra, për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë 2022”*”, ku është konstatuar se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë, OE “E.” shpk i cili ka ofertuar në vlerën

1,507,300 lekë pa tvsh dhe OE "T.O." shpk i cili ka ofertuar në vlerën 1,555,520 lekë pa tvsh. Ky procesverbal është firmosur nga KVO dhe NJP në të gjitha fletët e tij.

Nga KVO janë administruar procesverbalet "Mbi hapjen dhe verifikimin e vlerësimit e ofertave të tenderit procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike" me objekt OE" për tenderin me objekt "Blerje lubrifikantë, vajra, graso, filtra, për kryerjen e shërbimeve profilaktike për mjetet e Bashkisë Divjakë 2022".

Në lidhje me vlerësimit e kryer nga KVO, audituesit e KLSH konstatojnë se OE "E." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO me ofertën me të ulët 1,507,300 lekë pa tvsh dhe plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST për t'u kualifikuar.

OE "T.O." shpk me ofertën ekonomike 1,555,520 lekë pa tvsh është skualifikuar nga KVO pasi ky OE ka patur ofertën më të lartë.

Komisioni i marrjes në dorëzim

Me urdhër nr. 130 datë 30.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Divjakë është ngritur "Komisioni i Marrjes në Dorëzim" i cili përbëhet nga z. F.N., znj. G.Gj. dhe z. I.N.. Në dosje janë të administruar dhe procesverbalet e dorëzimit të mallit të firmosura nga ky Komision.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4527/23 prot., datë 28.12.2022, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 886/5 prot., datë 30.12.2022 "Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit".

Pretendimet e subjektit:

Nga shqyrtimi i observacioneve të dërguara mbi Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në Bashkinë Divjakë me shkresën nr. 886/2 prot., datë 03.11.2022, nuk vërehen fakte apo prova të reja, por janë të njëjta me ato të dërguara më parë nga ana e Sektorit Juridik dhe i Prokurimeve Publike Bashkia Divjakë, në lidhje me Aktin e Konstatimit nr. 5, datë 18.11.2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit të KLSH-së, shprehet se çështjet e ngritura në observacion janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në mënyrë shteruese dhe për pasojë nuk merren në konsideratë.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Në auditimin e regjistrit të realizimit të fondeve rezultoi se, për periudhën 01.07.2021-30.09.2022, janë realizuar 18 procedura prokurimi "Blerje me vlerë të vogël" me vlerë kontrate 3,032,048 lekë. Për auditim u përzgjedhën 2 procedura me vlerë kontrate 1,575,600 lekë, ose 52% e tyre.

Për periudhën 01.01.2022-30.07.2022 janë realizuar 28 procedura prokurimi "Blerje me vlerë të vogël" me vlerë kontrate 11,578,746 lekë. Për auditim u përzgjedhën 8 procedura me vlerë kontrate 7,293,310 lekë, ose 63 % e tyre.

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i Gjetjes: Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla).

Situata: Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

- Në 1 rast në dosjen e prokurimit nuk administrohen urdhëri i ngritjes së komisionit për përllogaritjen e fondit limit në procedurën "Blerje tubo Çeliku për nevojat e sektorit ujitje – kullim Bashkia Divjakë", si dhe procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nuk është i protokolluar;

- Në 1 rast nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

- Në 9 raste dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 6 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK;
- Në 6 raste nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit nuk nga operatori ekonomik;
- Në 8 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK;
- Në 1 rast rezulton se nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;

Sa më sipër mbanë përgjegjësi komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, me përbërje si vijon: E.D., E.M. dhe S.T..

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.4., faqe 63-108.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, gërma “dh”, “ë”, “gj” të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar. Shkronjën “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. Neni 12, 13 i Ligjit për Normat Tekniko Profesionale për Arkivat.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në transparencën dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për prokurimin me vlerë të vogël.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Komisioni i blerjeve të vogla, të marrin masat e nevojshme, që të dokumentojë çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve. Në rastet kur OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura nga AK, duhet të bëhet skualifikimi dhe kalimi tek operatori ekonomik i rradhës. Gjithashtu në rastet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, të bëhet verifikimi i formës dhe përmbajtjes së tij.

Më hollësisht rastet si më poshtë vijon:

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje tubo Çeliku për nevojat e sektorit ujitje – kullim Bashkia Divjakë”.

Me urdhërin e prokurimit nr. 242 datë 28.09.2021, prokurim me vlerë të vogël “Blerje tubo Çeliku për nevojat e sektorit ujitje – kullim Bashkia Divjakë”.

Me procesverbalin datë 21.09.2021 nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga z. F.T., z. I.N. dhe z. K.K. është përllogaritur fondi limit për blerje tubo çeliku për nevojat e sektorit ujitje-kullim në vlerën 638,400 lekë pa TVSH.

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 3946/1 prot., datë 28.09.2021, me specifikimet teknike bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga operatori ekonomik i renditur i pari, pranë AK përpara se të shpallet fituesi.

Me shkresën nr. 3946/2 datë 29.09.2021, AK Bashkia Divjakë anulon këtë procedurë për të filluar një procedurë të re tenderimi për shkak të përllogaritjes gabim të fondit limit.

Me urdhërin e prokurimit nr. 247 datë 06.10.2021, prokurim me vlerë të vogël “Blerje tubo Çeliku për nevojat e sektorit ujitje – kullim Bashkia Divjakë”.

Me procesverbalin datë 29.09.2021 nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit në vlerën 638,400 lekë pa TVSH, i përbërë nga z. F.T., z. I.N. dhe z. K.K. është përllogaritur fondi limit për blerje tubo çeliku për nevojat e sektorit ujitje-kullim;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 4113/1 prot., datë 06.10.2021, me specifikimet teknike bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje znj. E.Z., z. E.H. dhe z. P.T.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 25 operatorë ekonomik me 25 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 18, ku operatori ekonomik i renditur në vendin e parë OE “G.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 371,448 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 11.10.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 14.10.2021 OE “G.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “G.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “B.C.I.” shpk i renditur i dyti me ofertën 589,000 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 14.0.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 02.12.2021 OE “B.C.I.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “B.C.I.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “O.H.” shpk i renditur i treti me ofertën 591,360 lekë pa TVSH.

Diferenca me fondin limit është 47,040 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 02.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 06.12.2021 OE “O.H.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “O.H.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “S.A.” shpk i renditur i katërti me ofertën 596,600 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 41,800 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 14.0.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 02.12.2021 OE “B.C.I.” shpk nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta skualifikoj OE “B.C.I.”;

AK ka vazhduar me OE “O.H.” shpk i renditur i treti me ofertën 591,360 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 02.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 06.12.2021 OE “O.H.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “O.H.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “S.A.” shpk i renditur i katërti me ofertën 596,600 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 06.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 09.12.2021 OE “S.A.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “S.A.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “S.R.” shpk i renditur në vendin e pestë me ofertën 600,000 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 09.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 16.12.2021 OE “S.R.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “S.R.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara,

bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “R.C.” shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 612,000 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 16.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 20.12.2021 OE “R.C.” shpk nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta skualifikoj OE “R.C.”;

AK ka vazhduar me OE “A.K.M.A.I.G.” shpk i renditur në vendin e shtatë me ofertën 614,000 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 20.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 21.12.2021 OE “A.K.M.A.I.G.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A.K.M.A.I.G.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, njoftimi për tërheqje administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “B.C.” shpk i renditur në vendin e tetë me ofertën 618,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 20,400 lekë pa TVSh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 21.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Malli është marrë në dorëzim në datë 13.01.2021 nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. F.T., z. K.K. dhe z. M.S..

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 1, datë 13.01.2022.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 3/2022 datë 13.01.2022, në vlerën 741,600 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Mungon urdhëri i ngritjes së komisionit për përllogaritjen e fondit limit;

- Procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nuk është i protokolluar;

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit;

- Mungon dokumenti i cili operatori ekonomik të shprehet se është dakort me specifikimet teknike të kërkuara;

- Afati i dorëzimit të mallit nuk është respektuar nga operatori ekonomik;

- Mungojnë vërtetimet për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 dhe 2020 në Bashkitë ku ushtron aktivitet operatori ekonomik sipas QKB-së;

- Mungon deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

Sa më sipër OE shpallur fitues duhej të skualifikohej dhe të vazhdohej me OE e radhës. Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në “dh”, “ë” të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar. Shkronjën “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. Neni 12, 13 i Normave Teknike Profesionale për Arkivat.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për dekorin e qytetit për festat e fundvitit, Krishtlindjet dhe Vitin e Ri”.

Me urdhërin e prokurimit nr. 276/1, me nr. 4909/2 prot., datë 25.11.2021 prokurim me vlerë të vogël “Blerje materiale për dekorin e qytetit për festat e fundvitit, Krishtlindjet dhe Vitin e Ri”.

Me procesverbalin datë 26.11.2021 nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit në vlerën 799,950 lekë pa TVSH, ngritur me urdhër nr. 276 datë 24.11.2021 i përbërë nga z. E.N., z. P.T.

dhe z. R.M., është përlogaritur fondi limit për blerje materiale për dekorin e qytetit për festat e fundvitit, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik të ndryshëm (B.C., A.G. dhe S.B.). Ky procesverbal i dorëzohet Njësisë së prokurimit znj. E.Z., z. E.H. dhe z. P.T.; Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 4909/3 prot., datë 26.11.2021, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK përpara se të shpallet fituesi.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje z. P.T., z. E.H. dhe znj. E.Z.. Në këtë procedurë janë dorëzuar 17 oferta nga operatorë ekonomik nga të cilët janë kualifikuar të gjithë operatorët ekonomik pjesmarrës, ku është shpallur fituesi OE "B.C.I." me ofertën më të ulët, në vlerën 655,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 02.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datën 06.12.2021 OE "B.C.I." është tërhequr nga gara, Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit arsyeja e tërheqjes së OE të shpallur fitues;

AK ka vazhduar me OE "E.V." i renditur i dyti me ofertën 695,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 104,950 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 06.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Malli është marrë në dorëzim në datë 09.12.2021 nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhërin nr. 276/2 datë 09.12.2021.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 33, datë 09.12.2021, në vlerën 834,000 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, si psh., formulari i ofertës ekonomike të OE shpallur fitues etj;

- Afati i dorëzimit të mallit duhet të bëhet brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit

- nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se malli është marrë në dorëzim jashtë afatit të vendosur nga AK.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje ushqime për kopështin Divjakë dhe kopështin Çermë Sektor Nj/Adm Tërbuf Bashkia Divjakë, për vitin 2022", (Loti I. Blerje buke dhe Loti IV. Blerje mishi dhe nënproduktet e tij).

Me urdhërin e prokurimit nr. 85 datë 09.02.2022, prokurim me vlerë të vogël "Blerje ushqime për kopështin Divjakë dhe kopështin Çermë Sektor Nj/Adm Tërbuf Bashkia Divjakë".

Nuk administrohet procesverbali për përlogaritjen e fondit limit;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 668/1 prot., datë 09.02.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK ditën e nesërme nga shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje znj. E.D., znj. E.M. dhe z. S.T.. Në këtë procedurë janë dorëzuar 6 oferta nga operatorë ekonomik nga të cilët janë kualifikuar 5 operator ekonomik pjesmarrës, ku për Lotin I, dhe Lotin IV është shpallur fituesi OE "S.A." me ofertën më të ulët, në vlerën 866,400 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 11.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 15.02.2022 OE "S.A." shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "S.A." ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE "M.M." i renditur i dyti me ofertën 919,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 15.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Midis Bashkisë Divjakë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë F.K. dhe Operatorit Ekonomik "M.M." Shpk është lidhur kontrata me nr. 668/4 prot., datë 25.02.2022 për mallin e prokuruar "Blerje ushqime për kopështin Divjakë dhe kopështin Çermë Sektor Nj/Adm Tërbuf Bashkia Divjakë, për vitin 2022 (Loti I, Blerje Buke dhe Loti IV, Blerje mishi dhe nënproduktet e tij)".

Realizimi i kësaj kontrate është 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Me urdhër nr. 58/1, me nr. 5374/26 prot., datë 02.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Divjakë është ngritur komisioni për ecurinë e zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të ushqimeve të kopështit Divjakë dhe Kopështit Çermë Sektor Nj/Adm Tërbuf Bashkia Divjakë, si dhe me nr. 668/6 prot., datë 04.03.2022 është miratuar plani i zbatimit të kontratës.

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 46, datë 24.12.2021.

- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 126, datë 24.12.2021, në vlerën 916,356 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit;

- Pika 3, Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve – mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve;

- Pika 6, Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet ne fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetëdeklarim ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konfrom kërkesave ligjore - mungon vetëdeklarimi nga operatori ekonomik;

- Pika 7, Operatori ekonomik pjesëmarres, duhet të ketë në pronesi ose me qira, ambjente për magazinimin e mallrave të kërkuara, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet e kërkuara duhet të jenë të pajisur me certifikatë pronësie ose kontratë qiraje – nga dokumentacioni i vënë në dispozicion OE i shpallur fitues rezulton se nuk ka paraqitur certifikatë pronësie apo kontratë qiraje për për magazinat e kërkuara nga AK në ftesën për ofertë.

Sa më sipër OE shpallur fitues duhej të skualifikohej dhe të vazhdohej me OE e radhës. Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në "dh", "k", "i" të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike", shkronjën "a" në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, "Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës".

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje rimorkiator për mjetet e rënda për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë, Bashkia Divjakë".

Me urdhërin e prokurimit nr. 104 me nr. 974 prot., datë 21.10.2021 prokurim me vlerë të vogël "Blerje rimorkiator për mjetet e rënda për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë, Bashkia Divjakë".

Me procesverbalin nr. 836 prot., datë 18.02.2022 nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ngritur me urdhër nr. 94 datë 18.02.2022 i përbërë nga z. I.N., z. Q.Sh. dhe z. J.L. është përlllogaritur fondi limit për blerje rimorkiator për mjetet e rënda për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë me vlerën 800,000 lekë pa TVSH, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik të ndryshëm (A.S.N., L.Sh. dhe V.K.), ky pocesverbal i dorëzohet Njësisë së prokurimit z. S.T., znj. E.D. dhe znj. E.M.;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 974/1 prot., datë 25.02.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga operatori ekonomik, pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje znj. E.D., znj. E.M. dhe z. S.T.. Në këtë procedurë janë dorëzuar 13 oferta nga operatorë ekonomik, nga të cilët janë kualifikuar 12 operatorë ekonomik pjesmarrës, ku është shpallur fituesi OE “A.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 748,600 lekë pa TVSH. Diferenca nga fondi limit është 51,400 lekë pa TVSH;

OE Fitues është njoftuar në datë 01.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datën 01.03.2022 OE “A.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “A.K.M.A.I.G.” i renditur i dyti me ofertën 756,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 44,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 16.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datën 17.03.2022 OE “A.K.M.A.I.G.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A.K.M.A.I.G.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes e cila administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “B.C.” shpk i renditur i treti me ofertën 759,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 41,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 18.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- Malli është marrë në dorëzim në datë 04.04.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhërin nr. 129, datë 30.03.2022.

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 44, datë 04.04.2022.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 11, datë 04.04.2022, në vlerën 910,800 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit;

- Tek specifikimet Teknike është kërkuar që i gjithë dokumentacioni duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara – nga verifikimi i dokumentacionit ky kriter nuk është plotësuar pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk janë origjinale apo të noterizuara.

- Në lidhje me specifikimet teknike të kërkuara nga AK për gjendjen e Rimorkiatorit, OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me gjendjen teknike e rimorkiatorit.

- Afati i dorëzimit të mallit duhet të bëhet brenda 10 ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit – ky kriter nuk është zbatuar nga OE.

- Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 vitet e fundit nga shoqëria – OE i shpallur fitues ka dorëzuar vërtetim nga administrata tatimore me xhiron e 2 viteve, konkretisht për vitin 2019 dhe vitin 2020.

Sa më sipër OE shpallur fitues duhej të skualifikohej dhe të vazhdohej me OE e radhës. Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në gërmën “dh” dhe “gj” të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar, shkronjën “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje bazë materiale për kopështet, Bashkia Divjakë”.

Me urdhërin e prokurimit nr. 128, datë 29.03.2022, prokurim me vlerë të vogël “*Blerje bazë materiale për kopështet, Bashkia Divjakë*”.

Me procesverbalin nr. 1219/2 prot., datë 28.03.2022 nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ngritur me urdhër nr. 114 me nr 1219 prot., datë 10.03.2022 i përbërë nga znj. N.N., z. J.Z. dhe znj. A.J. është përlllogaritur fondi limit, Blerje materiale për kopështet Bashkia Divjakë në vlerën e 740,733 lekë pa TVSH, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik të ndryshëm (E.M., U.P. dhe Dh. M.), ky pocesverbal i dorëzohet Njësisë së prokurimit z. S.T., znj. E.D. dhe znj. E.M.;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1440/1 prot., datë 29.03.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga OE i rendituri i pari pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje znj. E.D., znj. E.M. dhe z. S.T.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 30 operatorë ekonomik, nga të cilët janë kualifikuar 27 operatorë ekonomik pjesmarrës. Operatori i renditur i pari është OE “A.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 499,500 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 31.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 04.04.2022 OE “A.” shpk nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur të skualifikoj OE “A.”;

AK ka vazhduar me OE “E.S.” shpk i renditur i dyti me ofertën 590,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 150,733 lekë pa TVSh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 04.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Malli është marrë në dorëzim në datë 15.04.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga znj. R.L., znj. M.B. dhe znj. A.H..

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 54, datë 15.04.2022.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 3, datë 15.04.2022, në vlerën 708,000 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit;

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “*Blerje karburanti për nevojat e sektorit të MZSH dhe Agjensisë së Shërbimeve Komunale*”.

Me urdhërin e prokurimit nr. 137, datë 06.04.2022, prokurim me vlerë të vogël “*Blerje karburanti për nevojat e sektorit të MZSH dhe Agjensisë së Shërbimeve Komunale*”.

Me procesverbalin nr. 1588/1 prot., datë 06.04.2022 nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ngritur me urdhër nr. 136 datë 05.04.2022 i përbërë nga z. L.Sh., z. A.Gj. dhe z. F.N. është përlllogaritur fondi limit Blerje karburanti për nevojat e sektorit të MZSH dhe Agjensisë së Shërbimeve Komunale në vlerën 959,960 lekë pa TVSH, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik (K.O. ShPK, E.S. dhe M.), ky pocesverbal i dorëzohet Njësisë së prokurimit z. S.T., znj. E.D. dhe znj. E.M.;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1626/1 prot., datë 06.04.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga operatori ekonomik i renditur i pari pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga znj. E.D., znj. E.M. dhe z. S.T.. Në këtë procedurë janë dorëzuar 4 oferta nga 4 operatorë ekonomik nga të cilët janë kualifikuar 2 dhe skualifikuar 2 operatorë ekonomik pjesmarrës, përkatësisht:

OE "G.C.G." shpk me normë fitimi 29 lekë/litër, i Kualifikuar;
OE "K.O. ShPK" shpk me normë fitimi 24 lekë/litër, i Kualifikuar;
OE "M.M." shpk me fond limit në vlerën 994,000 lekë pa tvsh, i Skualifikuar;
OE "P.A." shpk me fond limit në vlerën 988,800 lekë pa tvsh, i Skualifikuar;
Operatori ekonomik i shpallur fitues është OE "K.O. ShPK" shpk me normë fitimi më të ulët në vlerën 24 lekë/litër dhe me fondin limit në vlerën 959,960 lekë pa tvsh.
OE Fitues është njoftuar në datë 08.04.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;
- Midis Bashkisë Divjakë përfaqësuar nga Kryetari F.K. dhe Operatorit Ekonomik "K.O. SHPK" shpk është lidhur kontrata me nr. 1626/7 prot., datë 14.04.2022 për mallin e prokuruar "Blerje karburanti për nevojat e sektorit të MZSH dhe Agjensisë së Shërbimeve Komunale". Realizimi i kësaj kontrate duhet të realizohet 45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
- Malli është marrë në dorëzim në datë 11.05.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim, i ngritur me urdhër nr. 137/1 datë 15.04.2022 i përbërë nga znj. G.Gj., z. Ç.T. dhe z. G.P..
- Likujdimi i OE është bërë sipas faturave tatimore nr. 59, 60 datë 29.04.2022, nr. 63 datë 11.05.2022, nr. 66 datë 16.05.2022, në vlerën 1,199,942 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Në kriteret për kapacitetet teknik nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i protokoll-matjeve/verifikimi metrologjik për saktësinë e sasisë së hedhjes së karburantit për instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit) detyrim ligjor për subjektet që përdorin instrumente matës¹¹ me qëllim mbrojtjen e interesave të AK në sasinë e karburantit në furnizimin pranë stacionit të shitjes.
- OE shpallur fitues nuk është shprehur me deklaratë se është dakort me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Sa më sipër OE shpallur fitues duhej të skualifikohej dhe të vazhdohej me OE e radhës. Për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në gërmën "gj" të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike", i ndryshuar.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje materiale të ndryshme për nevojat e Drejtoisë së Bujqësisë, Sektori ujitje-kullim, Bashkia Divjakë".

Me urdhërin e prokurimit nr. 118 me nr. 15.03.2022 prot., datë 15.03.2022, prokurim me vlerë të vogël "Blerje materiale të ndryshme për nevojat e Drejtoisë së Bujqësisë, Sektori ujitje-kullim, Bashkia Divjakë".

Me procesverbalin nr. 1199/3 prot., datë 11.03.2022 nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit ngritur me urdhër nr. 112 datë 09.03.2022 i përbërë nga z. F.T., z. I.N. dhe z. S.Gj. është përllogaritur fondi limit blerje materiale të ndryshme për nevojat e Drejtoisë së Bujqësisë, Sektori ujitje-kullim, Bashkia Divjakë në vlerën 868,063 lekë pa tvsh, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik të ndryshëm (A.K., V.Q. dhe E.T.), ky pocesverbal i dorëzohet Njësisë së prokurimit z. S.T., znj. E.D. dhe znj. E.M.;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1283/1 prot., datë 15.03.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK ditën e nesërme nga shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

¹¹ Neni 19 dhe 20 në Ligjin nr. 126/2020 "Për Metrologjinë", i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur janë hartuar dhe miratuar kriteret e veçanta të kualifikimit.

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga znj. E.D., znj. E.M. dhe z. S.T., ku është shpallur fituesi OE “G.Xh.” shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 695,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 17.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 23.03.2022 OE “G.Xh.” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “G.Xh.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “J.Sh.” i renditur i dyti me ofertën 795,900 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 23.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.03.2022 OE “J.Sh.” nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur të skualifikoj OE “J.Sh.”;

AK ka vazhduar me OE “S.R.” i renditur i treti me ofertën 800,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 30.03.2022 OE “S.R.” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “S.R.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “A.B.” i renditur i katërti me ofertën 810,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 30.03.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.04.2022 OE “A.B.” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A.B.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “M.M.” i renditur i pesti me ofertën 818,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 01.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 05.04.2022 OE “M.M.” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “M.M.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “H.Xh.” i renditur i gjashti me ofertën 820,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 07.12.2021 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 05.04.2022 OE “H.Xh.” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “H.Xh.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “B.” i renditur në vendin e shtatë me ofertën 827,700 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 06.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 13.04.2022 OE “B.” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “B.” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “B.C.” i renditur në vendin e tetë me ofertën 828,000 lekë pa TVSH.

Diferenca me fondin limit është 40,063 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 17.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Malli është marrë në dorëzim në datë 10.05.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhërin nr. 118/1 datë 2.04.2022.

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 77 datë 10.05.2022.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 22, datë 10.05.2022, në vlerën 993,600 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit.

- Afati i dorëzimit të mallit duhet të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit – nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se malli është marrë në dorëzim jashtë afatit të vendosur nga AK.

OE shpallur fitues duhej të skualifikohej dhe të vazhdohej me OE të rradhës se nuk e plotëson këtë kriter të vendosur nga AK.

Veprimet e mësipërme ngarkon me përgjegjësi anëtarët e NJP.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 40, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar, shkronja “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

8. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale ndërtimi për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë, Sektorit Ujitje – Kullim, Bashkia Divjakë”.

Me urdhërin e prokurimit nr. 156 me nr. 2050 prot., datë 06.05.2022, prokurim me vlerë të vogël “Blerje materiale ndërtimi për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë, Sektorit ujitje-kullim, Bashkia Divjakë”.

Me procesverbalin nr. 1268 prot., datë 29.04.2022 nga komisioni i përllogaritjes së fondit limit në vlerën 496,680 lekë pa TVSH, ngritur me urdhër nr. 122 datë 23.03.2022 i përbërë nga z. I.N., z. F.T. dhe z. S.Gj. është përllogaritur fondi limit materiale ndërtimi për Drejtorinë e Bujqësisë, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik të ndryshëm (K.N., P.G. dhe A.B.), ky procesverbal i dorëzohet Njësisë së prokurimit znj. J.L., z. S.T. dhe znj. E.D.;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 2050/1 prot., datë 06.05.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga operatori ekonomik i renditur i pari, pranë AK përpara se të shpallet fituesi.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje znj. E.D., znj. J.L. dhe z. S.T.. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 18 operatorë ekonomik me 18 oferta të ndryshme, nga të cilët janë kualifikuar 12 operatorë ekonomik pjesëmarrës. Operatori i renditur i pari, OE “B.L.” Shpk me ofertën më të ulët në vlerën 350,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 146,680 lekë pa TVSh.

- OE Fitues është njoftuar në datë 10.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 12.05.2022 OE “B.L.” shpk nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta skualifikoj OE B.L.”;

AK ka vazhduar me OE “B.B.” shpk i renditur i dyti me ofertën 444,300 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 12.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 16.05.2022 OE “B.B.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “B.B.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “M.” shpk i renditur i treti me ofertën 456,000 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 16.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 18.05.2022 OE “M.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “M.” shpk nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta skualifikoj OE M.”; AK ka vazhduar me OE “S.R.” shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 465,000 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 18.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 24.05.2022 OE “S.R.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “S.R.” nuk është paraqitur sipas kërkesës ftesa për ofertë, në këto kushte komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka vendosur ta skualifikoj OE “S.R.”;

AK ka vazhduar me OE “O.T.” shpk i renditur në vendin e pestë me ofertën 466,667 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 24.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.05.2022 OE “O.T.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “O.T.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “B.C.” shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 479,000 lekë pa TVSH. Diferenca nga fondi limit është 17,680 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 25.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

- Malli është marrë në dorëzim në datë 16.06.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhërin nr. 156/1 datë 06.06.2022, i përbërë nga z. S.Gj., z. A.L. dhe z. F.T..

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me faturën nr. 141, datë 16.06.2022.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 40 datë 16.06.2022, në vlerën 574,800 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit;

- Afati i dorëzimit të mallit duhet të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit – nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se malli është marrë në dorëzim jashtë afatit të vendosur nga AK.

Veprimet e mësipërme ngarkon me përgjegjësi anëtarët e NJP.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 40, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar, shkronja “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

9. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje tubo betoni për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë, Sektori i Ujitje – Kullim, Bashkia Divjakë”.

Me urdhërin e prokurimit nr. 197 me nr. 2775 prot., datë 20.06.2022, prokurim me vlerë të vogël “Blerje tubo betoni për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë, Sektorit ujitje-kullim, Bashkia Divjakë”.

Me procesverbalin nr. 2612/2 prot., datë 14.06.2022 nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit në vlerën 991,800 lekë pa TVSH, ngritur me urdhër nr. 194 datë 13.06.2022 i përbërë nga z. F.T., z. I.N. dhe z. S.Gj. është përlllogaritur fondi limit blerje tubo betoni për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë, Sektori i ujitje-kullim, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator

ekonomik të ndryshëm (P.G., G. dhe V.D.), ky pocesverbal i dorëzohet Njesisë së prokurimit znj. J.L., z. S.T. dhe znj. E.D.;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 2775/1 prot., datë 20.06.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga fituesi pranë AK ditën e nesërme nga shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Me shkresën nr. 2775/2 datë 22.06.2022, konstatohet se janë doreëzuar 23 oferta nga operatorë ekonomik të ndryshëm, ky pocesverbal i dorëzohet Njesisë së prokurimit znj. E.Z., z. E.H. dhe z. P.T., ku OE i renditur pari është “V.K.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 846,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 24.06.2022 OE “V.K.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “V.K.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “G.” shpk i renditur i dyti me ofertën 870,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 121,800 lekë pa TVSH.

- OE Fitues është njoftuar në datë 24.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Malli është marrë në dorëzim në datë 29.08.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhërin nr. 197/1, datë 18.07.2022.

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 191, datë 29.08.2022.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 187, datë 29.08.2022 në vlerën 1,044,000 lekë me TVSH.

Në procedurën e mësipërme konstatohet se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, si psh., formulari i ofertës ekonomike të OE shpallur fitues;

- Afati i dorëzimit të mallit duhet të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit – nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se malli është marrë në dorëzim jashtë afatit të vendosur nga AK.

Veprimet e mësipërme ngarkon me përgjegjësi anëtarët e NJP.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 40, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar, shkronja “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

10. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë Divjakë”.

Me urdhërin e prokurimit nr. 218 datë 19.07.2022, urdhërohet prokurimi me vlerë të vogël “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë Divjakë” me fondin limit prej 703,389 lekë pa TVSH.

Me procesverbalin nr. 2627/1 prot., datë 15.07.2022 nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit ngritur me urdhër nr. 91 datë 10.06.2022 i përbërë nga z. E.N., z. E.H. dhe znj. A.J., është përlllogaritur fondi limit për blerje materiale elektrike për nevoja të Bashkisë Divjakë, pas administrimit të 3 ofertave nga 3 operator ekonomik të ndryshëm (G.G.C., B.C. dhe S.B.), ky pocesverbal i dorëzohet Njesisë së prokurimit, znj. J.L., z. S.T. dhe znj. E.D.;

Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 3245/1 prot., datë 19.07.2022, me specififikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet dorëzimi i dokumentacionit nga operatori i renditur i pari pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

Ftesa për ofertë drejtuar minimalisht 5 OE;

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje znj. E.D., znj. J.L. dhe z. S.T.. Në këtë procedurë janë dorëzuar 24 oferta nga operatorë ekonomik të ndryshëm, nga të cilët janë kualifikuar 17 operatorë ekonomik pjesëmarrës, ku operatori i renditur në vendin e parë është “E.K.T.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 498,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 21.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.07.2022 OE “E.K.T.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “E.K.T.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “X.S.” shpk i renditur i dyti me ofertën 622,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 26.07.2022 OE “X.S.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “X.S.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “Z.” shpk i renditur i treti me ofertën 629,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 26.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 27.07.2022 OE “Z.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “Z.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “O.H.” shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 632,800 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 70,589 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 27.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

- Malli është marrë në dorëzim në datë 08.08.2022 nga komisioni i marrjes në dorëzim ngritur me urdhërin nr. 218/1 datë 01.08.2022.

- Fletë-Hyrja në magazinën e institucionit me nr. 185 dhe nr. 185 datë 08.08.2022.

- Likujdimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 71, datë 08.08.2022, në vlerën 759,360 lekë me TVSH.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit;

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4527/23 prot., datë 28.12.2022, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 886/5 prot., datë 30.12.2022 “*Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit*”.

Pretendimet e subjektit:

Nga shqyrtimi i observacioneve të dërguara mbi Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në Bashkinë Divjakë me shkresën nr. 886/2 prot., datë 03.11.2022, nuk vërehen fakte apo prova të reja, por janë të njëjta me ato të dërguara më parë nga ana e Sektorit Juridik dhe i Prokurimeve Publike Bashkia Divjakë, në lidhje me Aktin e Konstatimit nr. 6, datë 18.11.2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit të KLSH-së, shprehet se çështjet e ngritura në observacion janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në mënyrë shteruese dhe për pasojë nuk merren në konsideratë.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

Kjo pikë e programit të auditimit nuk u trajtua, pasi në Bashkinë Divjakë, për periudhën objekt auditimi nuk kishte kontrata të përfunduara, për të cilat të mund të auditohej zbatimi i kontratave të punimeve, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera. Kontratat të cilat kanë qenë në fazë punimesh, do të auditohen në auditimin e ardhshëm.

2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit

2.5.1. Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor;

2.5.2. Auditimi mbi organizimi dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Sistemit GIS;

2.5.3. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike;

2.5.4. Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve;

2.5.5. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Bashkia Divjakë ka të miratuar Planin e Ri të Përgjithshëm Vendor.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastruktura.
4. Dhënia e Certifikatës së Përdorimit
5. Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik
6. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit në bashkinë Divjakë për periudhën korrik 2021 deri në shtator 2022 rezultojnë të jenë miratuar lejet e mëposhtme:

Për vitin 2021

S.L., shtëpi banimi 2 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 2710/4 datë 17.08.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastukturë- 143,255 lekë, vlera e investimit 8,088,129 lekë;

B.P., kapanon shërbimi për bujqësinë 1 kat, fshati Babunjë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 2883/5 datë 26.08.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastukturë 94,070 lekë, vlera e investimit 2,667,693 lekë.

Q.K., shtëpi banimi 2 kat, fshati Babunjë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3047/4 datë 20.08.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastukturë 90,308 lekë, vlera e investimit 4,425,088 lekë;

E.K., rikonstruksion, shtesë anësore + shtesë kati banimi mbi objektin ekzistues 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot.

3407/4 datë 13.09.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 86,183 lekë, vlera e investimit 4,309,217 lekë;

E.Gj., banesë individuale 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3368/4 datë 14.09.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 125,428 lekë, vlera e investimit 6,044,356 lekë;

T.P., rikonstruksion dhe shtesë anësore në objektin ekzistues 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3343/4 datë 20.09.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 36,463 lekë, vlera e investimit 1,823,148 lekë;

S.Rr., shtesë anësore+shtese kati mbi objektin ekzistues 1 kat, fshati Babunjë, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3705/4 datë 24.09.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 80,275 lekë, vlera e investimit 3,411,483 lekë;

A.B., banesë individuale 2 kat, fshati Bishtçukas, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3921/4 datë 22.10.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 156,785 lekë, vlera e investimit 74,509,542 lekë;

I.D., shtëpi banimi 1 kat, fshati Xeng, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3981/4 datë 22.10.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 68,770 lekë, vlera e investimit 3,438,440 lekë;

M.G., shtëpi banimi 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3796/5 datë 02.11.202, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 71,390 lekë, vlera e investimit 3,422,870 lekë;

G.Ç., shtesë kati banimi mbi objektin ekzistues, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 4187/4 datë 03.11.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 68,050 lekë, vlera e investimit 3,325,746 lekë;

E.Zh., shtesë objekti banimi + ndërtim çati e shfrytëzueshme, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 4394/4 datë 16.11.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 156,785 lekë, vlera e investimit 5,840,287 lekë;

Y.Z., shtëpi banimi 1 kat + çati e shfrytëzuar, fshati Gur, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 4734/4 datë 23.11.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 110,380 lekë, vlera e investimit 4,988,924 lekë;

G.K., shtëpi banimi 1 kat, fshati Mizë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 4632/5 datë 20.12.2021, vlera e ndikimit të taksës në infrastrukturë 76,470 lekë, vlera e investimit 2,897,753 lekë.

Për vitin 2022

A.L., shtëpi banimi 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 5145/4 datë 05.01.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 133,820.00 lekë, vlera e investimit 6,690,965 lekë;

E.M., shtëpi banimi 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 5144/5 datë 10.01.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 147,615 lekë, vlera e investimit 7,380,755 lekë;

A.R.M., shtesë anësore + shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 1 kat, Tërbuf, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 5257/4 datë 10.01.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 95,950 lekë, vlera e investimit 4,646,939 lekë;

E.P., godinë banimi 1 kat, Xeng, Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 300/8 datë 02.03.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 94,811 lekë, vlera e investimit 4,740,577 lekë;

J.V.Gj., prishje pjesore + rindërtim + shtesë kati ne objektin ekzistues 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 86/5 datë 07.03.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 38,203 lekë, vlera e investimit 6,910,173 lekë;

A.S., rikonstruksion kat përdhe ekzistues, shtesë anësore dhe ngritje një kat mbi ekzistuesin, Babunjë, Gradishtë, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 772/4 datë 23.03.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 144,780 lekë, vlera e investimit 72,139,171 lekë;

S.B., shtëpi banimi 2 kat, Gradishtë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 1030/4 datë 24.03.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 97,617 lekë, vlera e investimit 4,880,857 lekë;

F.K., magazinë për grumbullim, përpunim, tregëtim të produkteve bujqësore, Cermë Shkumbin, Tërbuf, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe me të madhe se 250 m²*, Nr. Prot. 747/5 datë 01.04.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 1,016,834 lekë, vlera e investimit 31,187,393;

M.B., godinë banimi 1 kat Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 1181/5 datë 01.04.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 114,776 lekë, vlera e investimit 5,635,047 lekë;

A.Z., shtëpi banimi 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²* Nr. Prot. 771/4 datë 07.04.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 53,896 lekë, vlera e investimit 2,694,845 lekë;

R.N., magazinë bujqësore 1 kat për paketim, kalibrim dhe agropërpunim, Mërtish, Gradishtë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m²*, Nr. Prot. 1329/5 datë 14.04.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 267,265 lekë, vlera e investimit 10,690,616 lekë;

R. sh.p.k., ndërtim magazinë bujqësore, fshati Mizë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m²*, Nr. Prot. 1179/5 datë 11.05.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastruktura 1,590,231 lekë, vlera e investimit 39,755,790 lekë;

S.M.V., shtesë kati mbi objekt ekzistues 1 kat Tërbuf, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 1600/5 datë 19.05.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 91,278 lekë, vlera e investimit 4,563,918 lekë;

H.Ç., shtesë kati banimi 1 kat në objektin ekzistues 1 kat, fshati Babunjë, *Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 1835/4 datë 27.05.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 57,383, vlera e investimit 2,842,290 lekë;

S.M.A., shtëpi banimi 1 kat Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 3150/5 datë 08.09.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 68,962 lekë, vlera e investimit 3,448,138 lekë;

A.Sh., shtëpi banimi 1 kat, qyteti Divjakë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m²*, Nr. Prot. 2764/4 datë 05.10.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 69,085 lekë, vlera e investimit 3,454,269 lekë;

D.T., godinë bujtinë 2 kate + papafingo, Kamenicë, *Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m²*, Nr. Prot. 4202 datë 08.09.2022, vlera e taksës së ndikimit në infrastukturë 608,439 lekë, vlera e investimit 20,381,307 lekë.

Nga kontrolli në sistemin e-leje të lejeve të ndërtimit të miratuara për periudhën e mësipërme konstatohen problematika si më poshtë:

Titulli i gjetjes: Nuk është respektuar distanca e objektit nga kufiri i pronës.

Situata: Për lejet e ndërtimit: Shtesë anësore + shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat me zhvillues A.M., me adresë Tërbuf, Rikonstruksion dhe shtesë anësore + shtesë kati 1 kat me zhvillues A.S., me adresë Babunjë, Shtëpi banimi 1 kat në A.Z. adresë Divjakë nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 108-113.

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”,

i ndryshuar, neni 35 “*Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës*”.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i distancave nga kufiri i pronës ndikon në funksionalitetin dhe komoditetin e përdorimit të objektit që do ndërtohet, në lidhje me pronat dhe objektet e tjera që janë ndërtuar apo do ndërtohen.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Divjakë

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga DPKZHT Divjakë të merren masa për të respektuar distancat e lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Nuk është respektuar intesiteti i lejuar sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar.

Situata: Për lejet e ndërtimit: Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve buqësore, me zhvillues F.K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf si dhe Magazinë bujqësore me zhvillues R. ShPK, me adresë fshati Mizë nuk është respektuar intesiteti i lejuar. *Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 108-113.*

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 38 “*Intensiteti i ndërtimit*”.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i intesitetit në ndërtim ndikon në parametrat e zhvillimit të territorit duke krijuar volume më të mëdha se ato të lejuara.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Divjakë

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga DPKZHT Divjakë të merren masa për të respektuar intesitetin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Nuk është marrë mendim pozitiv nga ana e AKZM.

Situata: Për lejen e ndërtimit: Godinë bujtinë 2 kate + papafingo, me zhvillues D.T., në adresë Kamenicë, Divjakë nuk është marrë mendim pozitiv nga AKZM.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 108-113.

Kriteri: Sipas shkresës me nr. 3338 datë 07.10.2022 të Agjensisë së Zhvillimit të Territorit, DPZHTK Bashkia Divjakë duhet të marrë mendim pozitiv nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura sepse leja e miratuar bën pjesë në territorin e zonave të mbrojtura.

Ndikimi/Efekti: Marrja e mendimit pozitiv nga ana e AKZM konfirmon ligjshmërinë e miratimit të kësaj leje ndërtimi.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Divjakë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga DPKZHT Divjakë të merren masa për të respektuar marrjen e mendimeve pozitive nga instucionet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Miratimi i Certifikatës së Përdorimit.

Situata: Për lejen e ndërtimit: Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve buqësore, me zhvillues F.K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 108-113.

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 27 “*Certifikata e përdorimit*”.

Ndikimi/Efekti: Marrja e certifikatës së përdorimit për objekte të cilat nuk kanë respektuar lejen e miratuar, ndikon në kequrbanizim të zonave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Divjakë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga ana e DPZHTK bashkia Divjakë të merren masa për të mos mirtuar leje përdorimi për objekte të cilat nuk kanë respektuar projektin e miratuar.

Titulli i Gjetjes: Ndryshime në zbatimin e projektit nga projekti i miratuar.

Situata: Nga vëzhgimi i objektit në lidhje me zbatimin e projektit të miratuar, u konstatuan ndryshime në fasadë dhe volume.

Trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Auditimit, pika 2.5., faqe 108-113.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i projekteve të miratuara ndikon në kequrbanizim të zonave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IMT Divjakë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga ana e IMT të merren masa për tu inspektuar të gjithë objektet të cilat janë me leje ose pa leje dhe të vazhdojë procedurat ligjore për objektet të cilat kanë shkelur lejen e ndërtimit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4527/23 prot., datë 28.12.2022, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 886/5 prot., datë 30.12.2022 “Observacion mbi Projekt Raportin e Auditimit”.

Pretendimet e subjektit:

Nga shqyrtimi i observacioneve të dërguara mbi Projekt Raportin e Auditimit, dërguar në Bashkinë Divjakë me shkresën nr. 886/2 prot., datë 03.11.2022, nuk vërehen fakte apo prova të reja, por janë të njëjta me ato të dërguara më parë nga ana e DPZHKT Divjakë, në lidhje me Aktin e Konstatimit nr. 7, datë 18.11.2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit të KLSH-së, shprehet se çështjet e ngritura në observacion janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit në mënyrë shteruese dhe për pasojë nuk merren në konsideratë.

2.6. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

2.5.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.5.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

2.5.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Titulli i gjetjes: Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 4680/63 Prot., datë 25.01.2022 “Kthim përgjigje për raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e lëna”, Bashkia Divjakë ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

2. Bashkia Divjakë nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-mujsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Shkalla e zbatimit: Ky detyrim ligjor nuk është zbatuar.

3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Divjakë:

Nga KLSH janë lënë 57 rekomandime gjithsej, nga këto:

20 masa organizative;

2 masa shpërblim dëmi;

6 masa për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;

10 masa administrative.

19 masa disiplinore;

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, **8** janë zbatuar, **2** zbatuar pjesërisht, **4** janë në proces zbatimi dhe **6** nuk janë zbatuar.

Pra janë zbatuar 40% e masave organizative dhe 30% nuk janë zbatuar.

- Për shpërblimin e dëmit janë lënë **2** rekomandime për 2 subjekte në vlerën 986,789 lekë dhe janë pranuar plotësisht, të cilat nuk janë zbatuar.

- Për eliminimin e efekteve negative financiare në menaxhimin e fondeve publike janë lënë **6** rekomandime në vlerën 552,673,447 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, **1** është zbatuar, **2** janë në proces zbatimi, **2** nuk janë zbatuar dhe **1** masë është zbatuar pjesërisht.

- Janë rekomanduar **19** masa disiplinore, të cilat janë zbatuar plotësisht.

- Janë rekomanduar **10** masa administrative, të cilat nuk janë zbatuar.

Në mënyrë të përmblodhur, në numër, rezulton se nga **57** rekomandime të lëna, janë zbatuar 28 ose 49% prej tyre janë zbatuar.

Nga 20 masa organizative të rekomanduara janë zbatuar 8, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces zbatimi 4 dhe nuk janë zbatuar 6 prej tyre.

Nga 2 masa për shërblim dëmi të rekomanduara në vlerën 9,867 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, të cilat nuk janë zbatuar.

Nga 6 masa për eliminimin e efekteve negative financiare në menaxhimin e fondeve publike të rekomanduara në vlerën 552,673 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, 1 masë është zbatuar, 2 janë në proces zbatimi në vlerën 481,313 mijë lekë, 1 masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 28,000 mijë lekë dhe 2 masa nuk janë zbatuar në vlerën 120,000 mijë lekë.

Nga 19 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 19.

Nga 10 masa administrative të rekomanduara në vlerën 6,100 mijë lekë, në zbatim të shkresës së APP për mangësitë e evidentuara, rezulton se nuk është arkëtuar asnjë nga gjrobat, rekomandimi nuk është zbatuar. Pasqyruar në formë tabelare, në Aneksin mbi zbatimin e rekomandimeve, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Zbatimi:

Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë, të marrë masa për plotësimin e organikës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik” neni 10, “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm” dhe VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm”.

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, në përfundim të procesit të auditimit në subjekt, të raportojë gjetjet nga auditimi në raportin përmbledhës, të shoqëruar me shkresë përcjellëse dhe t’i kërkohet menaxherit të njësisë së audituar të reagojë në lidhjet me rekomandimet, si dhe të kryhet monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara menaxhimit sipas Manualit të AB.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimet e mësipërme rezulton se nuk është bërë plotësimi i organikës së Njesisë së Auditit të Brendshëm si dhe nuk është bërë planifikimi i auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka marrë masa për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

Rekomandimi 2.2 nuk është zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Divjakë nëpërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, të marrë masa për një planifikim të studiuar të zërave të buxhetit, si për të ardhurat edhe për shpenzimet, me qëllim që buxheti i realizuar të jetë sa më afër vlerës së buxhetit të planifikuar.

Planifikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve të mbështetet në të ardhurat reale të pritshme dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshme.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se plani i të ardhurave që i është përcjellë Drejtorisë së Financës është bërë mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2021, dhe planifikimin e tarifave dhe taksave vendore sipas paktës fiskale 2022.

Rekomandimi 3.1 është zbatuar pjesërisht.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Të mos merren angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të mos krijohen detyrime të reja. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe plani për likuidimin e tyre.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se janë zbatuar pjesërisht (është hartuar grafiku i likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe është përcjellë në MFE raportimi mbi vështirësinë financiare të Bashkisë. (Trajtuar më gjerësisht në pikën 2 mbi Zbatimin e Buxhetit).

Rekomandimi 4.1 është në proces zbatimi.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë, në kushtet e konstatimit të mos kompetencës lëndore për procesin e zhvillimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës, të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për shpalljen absolutisht të pavlefshme të kontratës të lidhur nga N/Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe marrjen e masave për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezulton se Bashkia Divjakë ka marrë të gjitha masat për pavlefshmërinë e dy kontratave të lidhura me Shoqërinë “A.H.C”

shpk, me Administrator z. Z.T. dhe Shoqërinë “I.T.” shpk, me Administrator zj. E.O., duke vijuar me proces gjyqësor në gjykatën Administrative të shkallës së parë Vlorë.

Rekomandimi 5.1 është në proces zbatimi.

6.4. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për vlerësimin e 9 rezervuarëve të transferuar nga Bordi i Kullimit Lushnje në vitin 2015 në bazë të VKM. nr. 1108, datë 30.12.2015 dhe ti pasqyrojë në AAM me vlerën e drejtë.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 6.1, për vlerën e oponencës së projektit të mësipërm nga AKUM është marrë me shkresën e cila është në dosjen e dokumentacionit të pasqyrave financiare si dhe është paraqitur në kontabilizimin e kl. 2 dhe në formatin 7a dhe 7b të pasqyrave financiare me vlerë 562,899 lekë sipas udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018.

Lidhur me rekomandimi 6.2, janë regjistruar asetet “*Rehabilitimi i kanaleve ujtëse dega Krutje*” me vlerë 41,585,517 lekë, “*Rehabilitimi i kanaleve ujtëse dega Tërbuf*” me vlerë 119,257,568 lekë në administrimin e Bashkisë Divjakë në llog. 2134100 te kl. 2. është paraqitur në kontabilizimin e kl. 2 si dhe në formatin 7a, 7b të pasqyrave financiare të vitit 2021.

Lidhur me rekomandimi 6.3, grumbullimi i aktivitet të llog. 218 “kompjutera” pranë magazinës së Bashkisë Divjakë e cila pasqyrohet me fletëhyrjen nr. 13 datë 09.03.2022.

Lidhur me rekomandimi 6.4, për këtë rekomandim është kryer punë kërkimore pranë dokumentacionit të arkivës së Bashkisë Divjakë si dhe është dërguar shkresë pranë Bordit rajonal Fier me nr. 334 datë 25.01.2022 por nuk është marrë përgjigje. Këto asete janë transferuar nga Ministria e Bujqësisë që në vitin 2013 pranë ish-komunave. Ndërkohë nga kërkimi në dokumentacionin arkivor është gjetur një pjesë e të dhënave si Rezervuari Xeng 1 me vlerë 270,000 lekë, Rezervuari Xeng 2 me vlerë 200,000 lekë, Rezervuari Mizë me vlerë 900,000 lekë dhe Rezervuari Dushk-Can me vlerë 120,000 lekë. Rezervuaret Babunjë dhe Gradishtë nuk janë funksionale prej shumë kohësh sipas specialisteve.

Rekomandimi 6.4 është në proces zbatimi.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës të marrë masa për kontabilizimin e detyrimeve në shumën 53,447,482 lekë, detyrime këto të trashëguara nga viti 2011. Në bashkëpunim me IMTV të marrë masa për pasqyrimin e saktë dhe të drejtë të gjobave të vendosura nga kjo strukturë.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe me Drejtorinë Juridike të merren masa për arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore ndër vite nëpërmjet masave shtrenguese, si dhe duke proceduar me kërkesë padi në gjykatë, në zbatim të kërkesave ligjore.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin e mësipërm rezultoi se “Për kontabilizimin e detyrimeve në shumën 53,447,482 lekë e cila pasqyron “tarifa vendore për periudhën 2011-2020” dhe kontabilizimin e gjobave të IMTV-së, gjendja e llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është shtuar në vlerën 53,447,482 lekë e cila pasqyron vetëm tarifa vendore për periudhën 2011-2020. Kjo vlerë është pasqyruar në pasqyrën “*Debitorë të Bashkisë Divjakë për vitin 2021*” si dhe është e kontabilizuar në klasën 4 e cila është bashkëlidhur dokumentacionit të pasqyrave financiare 2021. Është kryer kontabilizimi i gjobave të IMTV-së deri më 31.12.2021 e cila është pasqyruar në përmbledhësen e debitorëve për vitin 2021 dhe është pasqyruar në kl.4 dhe në pasqyrat financiare vjetore. Në përmbledhësen e Debitorëve janë pasqyruar veç individëve për taksë pasurie ose tarifa vendore dhe individë apo operatorë ekonomike të cilët kanë detyrime ndaj Bashkisë Divjakë. Debitorët për vitin 2021 kapin vlerën 433,614,622 leke, është shtuar vlera prej 53,447,482 lekë nga rekomandimi i KLSH-së dhe totali i llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për vitin 2021 është 487,062,104 lekë.

Rekomandimi 8.1 është zbatuar pjesërisht.

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit dhe të njësisë së prokurimit,

të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, ku të aplikojnë kritere në përputhje me natyrën e procedurës së zhvilluar, si dhe ti trajnojë ata në vijimësi lidhur me fushën e veprimtarisë së tyre.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 12.1, Kryetari i Bashkisë Divjakë nuk ka marrë masa që në komisionet e hartimit të dokumentave standarte të tenderit dhe njësisë së prokurimit të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës.

Rekomandimi 12.1 nuk është zbatuar.

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të analizojë situatën me qëllim përcaktimin e arsyeve që kanë ndikuar në përcaktimet e gabuara të kritereve të veçanta për kualifikim dhe mos argumentimin e tyre nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Komisionet e ngritura për këtë qëllim, të shmangin anomalitë gjatë hartimit të kritereve të DST.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 13.1, Kryetari i Bashkisë Divjakë nuk ka marrë masa për të analizuar situatën, këto problematika vijojnë të jenë evidente.

Rekomandimi 13.1, nuk është zbatuar.

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratohen leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës si dhe sipas përcaktimit të “Planit të Përgjithshëm Vendor” të Bashkisë Divjakë.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 14.1, Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nuk kanë marrë masa që lejet zhvillimore dhe lejet e ndërtimit të plotësojnë distancat e objektit të zhvilluar, këto problematika vijojnë të jenë evidente.

Rekomandimi 14.1, nuk është zbatuar.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimin plotësisht të rekomandimeve të dhëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 241/51 datë 13.04.2021. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara dhe të përshpejtohet puna për ato që janë në proces. Për këtë nga Titullari i njësisë vendore të hartohet plan pune me struktura dhe persona konkret për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, konkretisht: a-Për 3 masa organizative me vlerë 1,351 mijë lekë, konkretisht për pikat; 1.1; 2.1; 3.1; b-Për 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 364 mijë lekë;

c- Për masa për uljen e borxhit tatimor, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën 7,543 mijë lekë.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 15.1, Bashkia Divjakë ka kontabilizuar vlerën 6,489,647 lekë si dhe është njoftuar OE “O.Z.” me shkresën nr. 4398 Prot, datë 29.09.2022. nga Bashkia Divjakë nuk janë marrë masa shtrënguese ose të fillojë proces gjyqësor për arkëtimin e vlerës debitorë.

Lidhur me rekomandimin 2.1, Bashkia Divjakë nuk ka marrë masa shtrënguese për OE “F.” shpk për arkëtimin e vlerës 1,960,560 lekë, për punime të pakryera.

Lidhur me rekomandimin 3.1, nga verifikimi i kryer rezulton se OE “S.” shpk ka arkëtuar vlerën 756,254 lekë.

Lidhur me rekomandimin pika b – nga verifikimi i kryer rezulton se BOE “A.S.” & “C.R.” & “M.S.” ka arkëtuar vlerën 364,646 lekë më datë 29.07.2021.

Lidhur me rekomandimin pika c- Për masa për uljen e borxhit tatimor, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën 7,543 mijë lekë, rezulton se

detyrimet nga qiradhënia janë arkëtuar ndërsa për taksën e ndikimit në infrastrukturë procesi i arkëtimit vazhdon. Ecuria e arkëtimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë është trajtuar më gjerësisht në pikën e auditimit të të ardhurave.

Rekomandimi 15.1 është në proces zbatimi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 986,789 lekë si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 884,588 lekë pa Tvsh nga shoqëria “C.R.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3142 prot., datë 23.08.2019, me objekt “Rikonstruksion dhe shtesë anësore 2 kate, Shkolla e mesme e bashkuar “Mihal Nako”, fshati Fier Seman, Nj/Adm Gradishtë”, Bashkia Divjakë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 1.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar, si dhe nga titullari i institucionit është njoftuar subjekti me shkresën nr. 4788 prot., datë 15.11.2021 si dhe me shkresën nr. 5180 prot., datë 13.12.2021 për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të krijuar ndaj Bashkisë Divjakë. Vlera e mësipërme nuk është arkëtuar nga subjekti “C.R.” për llogari të Bashkisë Divjakë.

Rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 102,210 lekë, nga tre anëtarët e Komisionit të argumentimit të fondit limit: z. Ll.V. z, L.Xh. dhe z. S.T., në vlerën 34,070 lekë për secilin person.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 2.1 për shpërblimin e dëmit të krijuar, rezulton se ky rekomandim është pranuar, si dhe janë dërguar njoftimet për arkëtim vullnetar por nuk na u vendos në dispozicion dokumentacion mbi masat e marra për arkëtimin e vlerës 102,210 lekë.

Rekomandimi 2.1 nuk është zbatuar.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrin masa për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 513,808,991 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

d- Për debitorët familjar, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifave familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 1.1 për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 513,808,991 lekë është dërguar shkresa me nr. 1384 datë 23.03.2022 në Drejtorinë Rajonale të Transporteve Rrugore me kërkesën për vendosjen e Barrës Sigurorese;

Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat është aplikuar gjopa për pagesë të vonuar në masën 21.9% në vit;

Nga ana e Bashkisë Divjakë janë kryer bllokimet e llogarive për subjektet debitore por nuk janë marrë masa për ti dërguar për kallëzim penal;

Për debitorët familjarë është realizuar dërgimi me postë i detyrimeve të prapambetura duke përfshirë edhe detyrimet e vitit 2022 duke përfshirë edhe Njësitë Administrative;

janë realizuar edhe bllokime fizike të bizneseve ku për 21 subjekte janë kryer akt-marrëveshje që pagesat të kryhen me këste nga të cilat janë arkëtuar në vlerën 2,226,952 lekë;

Për debitorët biznes dhe familjar janë arkëtuar deri më datën 31.09.2022 në vlerën e mëposhtme:

Nr	Segmenti	31.12.2021		Janar-Shtator 2022		Totali	
		Nr.	Vlerë lek	Nr.	Vlerë lek	Nr.	Vlerë lek
1	Biznes	132	6,544,090	52	2,357,547	184	8,901,637
2	Familjar	2413	33,674,899	2084	28,583,817	4497	62,258,716
	Total	2545	40,218,989	2136	31,121,364	4681	71,160,353

Me shkresën nr. 1424 prot., datë 28.03.2022 i është dërguar zyrës juridike për vazhdimin e procedurave me ndjekje penale për subjektet debitore, si dhe me shkresën nr. 1385 prot., datë 25.03.2022 i është drejtuar AKSH Tiranë me një listë debitorësh për verifikimin dhe vendosjen e barrës hipotekore por nga ana e AKSH nuk ka pasur kthim përgjigje.

Rekomandimi 1.1 është në proces zbatimi.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 23,764,456 lekë, për objektet ndërtimore që janë legalizuar nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Lushnje.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 2.1 Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit ka marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura si dhe janë bërë bllokime të llogarive. (Trajtuar më gjerësisht në pikën 2.6 mbi auditimin e të ardhurave).

Rekomandimi 2.1 është në proces zbatimi.

3.1. Rekomandimi: Inspektoriati Vendor i Mbrojtës Territorit (IVMT) në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa për arkëtimin e 18 gjobave në vlerën 9,000,000 lekë. Të bëhet

kërkesë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, për shndërrimin e vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, me qëllim shmangien e afatit të parashkrimit.

3.2. Rekomandim: Të merren masa për vendosjen dhe në vijim arkëtimin e gjobave ndaj 6 personave që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Divjakë, në vlerën totale 3,000,000 lekë.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin 3.1, IVMT dhe Sektori Juridik nuk ka marrë asnjë masë për arkëtimin e gjobave si dhe nuk kanë bërë kërkesë pranë Gjykatës Administrative të shkallës së Parë për shndërrimin e vendimit për kundërvajtjet administrative në titull ekzekutiv si dhe nuk është arkëtuar asnjë nga gjobat e vendosura për personat që kanë kryer ndërtime pa leje në territorin e Bashkisë Divjakë.

Rekomandimi 3.1 nuk është zbatuar.

Rekomandimi 3.2 nuk është zbatuar.

4.1 Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa të menjëhershme për pajisjen me licencën e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, për katër subjektet dhe arkëtimin prej tyre të vlerës së tarifës prej 3,100,000 lekë, respektivisht:

- për subjektin "K.O. ShPk" shpk me NIPT L.....M, vlera 1,000,000 lekë;
- për subjekti "L." shpk me NIPT J.....L, vlera 1,000,000 lekë;
- për subjekti "V.M." shpk me NIPT K.....I, vlera 1,000,000 lekë;
- për subjekti "O.G." shpk me NIPT L.....D, vlera 100,000 lekë.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me Rekomandimin 4.1 - Subjektit "K.O. ShPk" shpk me NIPT L61326501M janë bllokuar llogaritë në të gjitha Bankat e Nivelit të II si dhe është bërë bllokimi fizik i aktivitetit. Subjekti ka arkëtuar vlerën 100,000 në datën 23.02.2022 dhe 100,000 lekë në datën 04.11.2022.

- Subjekti "L." shpk me NIPT J.....V i është bërë bllokimi i llogarive në të gjitha Bankat e nivelit të II, si dhe është bërë bllokimi fizik i aktivitetit.
- Vëllezërit "M." shpk me NIPT K.....I nga ana e Bashkisë Divjake janë kryer bllokimet e llogarive Bankare, sipas raportit të QKR subjekti vazhdon të jetë aktiv.
- Subjekti "O.G." shpk me NIPT L.....D ka arkëtuar vlerën 100.000 lekë në datën 10.10.2022.

Rekomandimi 4.1 është zbatuar pjesërisht.

D. MASA ADMINISTRATIVE

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", si dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj 10 punonjësve, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit), për shkeljet në procedurat e prokurimit, si më poshtë:

1. Znj. V.L., me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve publike, në cilësinë e përgjegjëses të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në 3 procedura prokurimi, të zhvilluara në vitin 2020, si dhe 1 procedurë prokurimi të zhvilluar në vitin 2021.

2. Znj. S.SH., me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve publike, në cilësinë e përgjegjëses të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në 9 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2020.
3. Z. E.H. me detyrë inxhinier-specialist, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, Për shkeljet e konstatuara në 9 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2020 dhe 2 procedura të zhvilluara në vitin 2021.
4. Znj. I.K. me detyrë specialiste buxheti, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në 9 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2020 dhe 3 procedura prokurimi të zhvilluar në vitin 2021.
5. Z. R.M. me detyrë përgjegjës i sektorit të vlerësimit dhe kontrollit për taksat dhe tarifatat vendore, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit (NJP), për shkeljet e konstatuara në 2 procedura prokurimit të zhvilluara në vitin 2020.
6. Znj. E.N. me detyrë specialiste e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në 4 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2020 dhe 2 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2021.
7. Z. L.Xh., me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në cilësinë e kryetarit të komisionit të hartimit të kriterëve të veçanta.
8. Znj. M.N., me detyrë specialiste e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të kriterëve të veçanta, për shkeljet e përbashkëta të konstatuara në 2 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2021.
9. Z. S.T., me detyrë specialist inxhinier, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkeljet e konstatuara në 2 procedura prokurimi të zhvilluar në vitin 2021.
10. Z. R.M., me detyrë përgjegjës sektori/ekonomist, anëtar i NJHDT për shkeljet e konstatuara në 3 procedura prokurimi të zhvilluar në vitin 2021.

Zbatimi:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

Referuar rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm nga KLSH, drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, duke vendosur marrjen e masave administrative.

Bashkia Divjakë, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 458 prot., datë 01.02.2022 i është drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik, për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara gjatë auditimit nga KLSH.

Agjencia e Prokurimit Publik me vendim nr. 1778/5 datë 29.09.2022 i është drejtuar Bashkisë Divjakë si dhe për dijeni të KLSH, për shkeljet e konstatuara gjatë auditimit të mëparshëm si dhe për marrjen e masave administrative ka vendosur si më poshtë vijon:

1. Znj. V.L., të dënojë me gjobë në masën 30,000 lekë;
2. Znj. S.SH., të dënojë me gjobë në masën 60,000 lekë;
3. Z. E.H., të dënojë me gjobë në masën 150,000 lekë;
4. Znj. I.K., të dënojë me gjobë në masën 60,000 lekë;
5. Z. R.M., të dënojë me gjobë në masën 30,000 lekë;
6. Znj. E.N., të dënojë me gjobë në masën 30,000 lekë;
7. Z. L.Xh., të dënojë me gjobë në masën 120,000 lekë;
8. Znj. M.N., të dënojë me gjobë në masën 100,000 lekë;
9. Z. E.Z., të dënojë me gjobë në masën 30,000 lekë;
10. T'i propozojë titullarit të AK për marrjen e masave disiplinore, ndaj Z. S.T., Z. L.V., Z. A.C., Z. D.Z., Z. F.N., Z. A.K. për mangësi të evidentuara, sipas konstatimeve në këtë vendim. Rezulton se asnjë nga gjobat nuk janë arkëtuar.

Zbatimi:

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me rekomandimin për zbatimin e masave administrative të dhëna nga APP për mangësi të evidentuara, rezulton se ky rekomandim është pranuar, si dhe

nga titullari i institucionit nuk janë nxjerrë urdhërat për arkëtimin vullnetar të gjobave, si dhe nuk janë marrë masat për arkëtimin e vlerës 6,100 mijë lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

Kriteri: Shkronja (j) e nenit 15 dhe pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar në aktivitetin e Bashkisë Divjakë, ku mangësi të konstatuara në auditimin e mëparshëm vazhdojnë të përsëriten.

Shkaku: Mosmarrje e masave për vënien në zbatim të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve ende të pa zbatuara.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Nuk është hartuar “Harta e procesit për proceset kryesore të veprimtarisë së institucionit”.
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Nuk është miratuar plani i zhvillimit strategjik me afat 5 vjeçar.
- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të liçencuara.
- Drejtoria e Financës nuk përdor program të licencuar për mbajtjen e kontabilitetit por operon me programin “EXCEL” ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të bashkisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin 2 herë në vit të risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investime në programe kompjuterike të liçencuara (për mbajtjen e kontabilitetit) në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve të brendshme për ngritjen profesionale të stafit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Divjakë, mbi funksionimin dhe veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm gjatë vitit 2021, u konstatua se:

- Sektori i auditimit të brendshëm ka dy punonjës, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës.

- Nuk është kryer auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

- Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se nuk është planifikuar kryerja e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

- Në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2021 nuk është dhënë opinion i auditimit.

- Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, Prokurimet publike etj.

- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e sektorit të auditimit të brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me shkronjën “ç” të nenit 6, nenin 13, shkronjën “ç” të nenit 14 të Ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”, Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020 të MFE “*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016*”; Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 “*Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik*”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në njësinë e auditimit të brendshëm Divjakë, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar.

- Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Divjakë, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk të lartë, siç janë ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkinë Divjakë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

2.3. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Divjakë, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

2.4. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Divjakë, të marrë masa që çdo vit të kryejë auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe këshillave për titullarin e njësisë publike, nëse sistemet e MFK janë ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit financiar.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat e ndjekura për hartimin e PBA-së dhe dokumentimit të procesit rezulton se:

- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;
- Nuk është dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga Ekipe të Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;
- Në dokumentin e PBA-së nuk janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, nuk janë analizuar risqet financiare dhe fiskale të bashkisë, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtorja e Financës e Buxhetit, të marrin të gjitha masat që për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm:

- Të dërgojnë për miratim në Këshillin Bashkiak raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;
- Procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së dhe puna e bërë nga Ekipe të Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të dokumentohet në çdo fazë;
- Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë, të cilat cenojnë drejtpërdrejt arritjen e objektivave të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit rezultoi si vijon:

1. Niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2021 paraqitet i realizuar në vlerën **805,745** mijë lekë nga **1,056,589** mijë lekë të planifikuara, ose në masën 76%. Në nivelin e realizimit të buxhetit ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të të ardhurave për vitin 2021 i cili paraqitet në 44%. Për periudhën Janar-Shtator 2022 paraqitet i realizuar në vlerën **540,220** mijë lekë nga vlera **767,543** mijë lekë të planifikuara, ose në masën 70%.

2. Në fund të 9 muhorit 2022 (30.09.2022), Bashkia Divjakë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlerën **63,690,532 lekë**. Ndërsa detyrimet nga buxheti i shtetit janë në vlerën **4,154,257 lekë**.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura në fund 9 muhorit 2022 (30.09.2022), janë të pa likuiduara gjithsej 149 raste me vlerë **49,698,550 lekë**. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:

- a. 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 32,200,102 lekë.
- b. 37 fatura për mallra në vlerën 6,725,906 lekë.
- c. 78 fatura për shërbime në vlerën 6,169,113 lekë.
- d. 4 vendime gjyqësore në vlerë 4,603,429 lekë.

3. Për vitin 2022 janë planifikuar fonde për projekte dhe investime në shumën 166,252 mijë lekë, me burim financimi nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar. Aktualisht Bashkia Divjakë ka 41 kontrata të lidhura që nga viti 2018-2022 me vlerë totale 902,972,468 lekë, ku 3 kontrata janë për afate që përfshijnë vitin 2023 dhe 2024 për likuidim. Për të gjitha këto kontrata është likuiduar deri më 31.12.2020 vlera 217,033,450 lekë, gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 196,789,674 lekë, deri më 30.09.2022 është likuiduar vlera 75,122,971 lekë dhe mbetet ende për t'u likuiduar vlera **39,326,998 lekë** që i përket kontratave të përfunduara.

Vlera e detyrimeve të prapambetura më 30.09.2022 është 9.85% e shpenzimeve vjetore të miratuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave në Bashkinë Divjakë u konstatua se për vitin 2021 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat paraqitet në masën 44%, nga 316,869 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 139,357 mijë lekë, ose 117,512 mijë lekë më pak. Niveli i ulët i realizimit i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat ka ardhur si rezultat i:

1. Mos planifikimi i saktë i të ardhurave sipas zërave. Lidhur me planifikimin e taksave të ndara apo atyre që vilen nga agjentët tatimore si tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale, taksa mbi automjetet e përdorura, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore në Bashkinë Divjakë nuk ka një bazë të dhënash të subjekteve që duhet të paguajnë këtë detyrim.

2. Mos marrjen e masave të duhura ligjore ndaj taksapaguesve familjarë dhe privat për mos pagesën e taksave dhe tarifave në mënyrë vullnetare brenda afatit.

Procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar si duhet. Nuk ka dokumentacion të plotë lidhur me kërkesat që Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore dërgon për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar të dhëna lidhur me planifikimin e të ardhurave vjetore. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DTV për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021*” dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë.

Të marrë masa që të vendosë një korrespondencë me institucionet e tjera që administrojnë të dhënat lidhur me taksat e ndara me qëllim marrjen prej tyre të informacionit të duhur për të bërë një planifikim sa më të saktë të të ardhurave për këto taksa. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Administrimi i dokumentacionit dhe procesi i menaxhimit të të ardhurave nga taksapaguesit privat dhe abonentët familjarë në Bashkinë Divjakë kryhet në

programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe të Ardhura Vendore nuk kryen regjistrim manual të dhënave (nuk ka regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Divjakë i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTAV që mund të rezultojë në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike të kompjuterave me pasojë humbjen e të dhënave të DTAV. Gjithashtu, administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Divjakë të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit , ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifatat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Dhjetor 2023

7. Gjetje nga auditimi: 1. Nga krahasimi i pasqyrave financiare hartuara nga Bashkia Divjakë, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 5,329,592,175 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 5,239,247,615 lekë, me një diferencë prej 90,344,560 lekë më pak në PF në subjekt. Kjo diferencë tregon se në sistemin e thesarit nuk është paraqitur vlera 90,344,560 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo diferencë korrespondon në Pasivin e Bilancit me shumën e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 30,589,616 lekë dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”, në vlerën 59,754,945 lekë.

2. Nga auditimi, u konstatua se llogaria 215 “Mjete transporti” është shtuar për vlerën neto 62,201,067 lekë, për makineri dhe pajisje sipas Aneksit PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilat i përkasin llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, e cila është pakësuar për të njëjtën vlerë. Sa më sipër, këto dy llogari të aktivitetit nuk paraqesin vlerën reale.

3. Nga verifikimi i regjistrave të aktiveve, u konstatua se për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, paraqiten probleme në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëposhme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Regjistrat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për këtë arsye, vlera e këtyre dy llogarive (214 dhe 215) në pasqyrat financiare, nuk jep siguri të arsyeshme se është e saktë.

4. Nga Bashkia Divjakë nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të aseteve, përkatësisht në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” dhe rrjedhimisht nuk është kryer marrja në dorëzim, kolaudimi, vlerësimi, nuk

është kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, nuk është aplikuar në ASHK Lushnjë për regjistrimin e të gjitha aseteve, resurseve dhe pasurive të tjera, si dhe nuk është bërë regjistrimi në kontabilitet i këtyre pasurive veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikat 37, 42-60, 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

5. Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të ardhurat dhe debitorët nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitorë të familjarëve, bizneseve, etj, nuk janë kontabilizuar në mënyrë të saktë dhe të plotë. Në listën e debitorëve mungojnë disa persona të cilët janë gjobitur nga IMTV, lista e debitorëve progresivë, e disponueshme në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore mbyllet me numër rendor 418, ndërkohë që lista analitike e kontabilitetit mbyllet me numër rendor 162, etj. Gjithashtu, konstatohet se nuk janë përlllogaritur dhe kontabilizuar kamatëvonesat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

7.2. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

7.3. Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Divjakë të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

7.4. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH, duke llogaritur edhe kamatëvonesat përkatëse. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 99,323,241 lekë për llogarinë 231, në total 99,148,142 lekë. Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 497,139,142 lekë, të cilat janë me fonde të deleguara. Vlera e kontraktuar (me TVSh), për investimet në proces gjatë vitit 2021 është 497,148,142 lekë, nga të cilat 496,126,333 lekë për objektin “Furnizim me ujë për zonat bregdetare Remas, Bashkia Divjakë” me kontratë nr. 360/12 datë 02.04.2021 me operator ekonomik “A.C.” shpk dhe 1021,809 lekë për “Mbikëqyrje punimesh për objektin

furnizim me ujë zonat bregdetare Remas”, me kontratë nr. 545/1 datë 01.04.2021, me operator C.E.C.G..

Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2021 nuk paraqet vlerën reale, pasi duhet të pasqyronin vlerën 497,139,142 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Divjakë.

Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32, etj. Investimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2021, janë paraqitur në Aneksin PF24, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Financës të marrë masa për analizimin e saktë dhe sistemimin e vlerave me saktësi sipas posteve në bilancin kontabël, për llogaritë 230/231 “Investime në proces”.

8.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve kontabël duke respektuar të gjitha hapat e regjistrimit në kontabilitet, si më poshtë:

1. Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumatat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

2. Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

3. Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

4. Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

5. Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizimi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT),

për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

6. Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivitetet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021 ka qenë 30,589,616 lekë ose me rritje në vlerën 8,026,368 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë Divjakë ndaj subjekteve për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga verifikimi analitik i llogarisë 466 rezultojnë një diferencë prej 116,905 lekë e pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare. Për sa më sipër, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk paraqet vlerën e saktë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022 për punë publike dhe mallra, rezultojnë se në 5 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me tipologjinë e objektit të prokuruar dhe kontratës së lidhur. Veç sa më sipër, në përbërjen e NJP dhe KVO, për 2 raste është konstatuar mungesa e specialistëve të fushës, në përputhje me objektin e prokurimit, ndërsa në 1 rast rezultojnë se ka pasur copëzim të fondeve dhe shmangie nga procedurat standarde të prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, 3 të nenit 34, neni 73, pika 1 në nenin 80, pika 3 në nenin 92, shkronja “d” në pikën 1 në nenin 98 në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Nenin 73, pika 2 e nenit 74, paragrafi 1 i nenit 75, pika 2 në nenin 76, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e NJP dhe KVO, të ketë specialist të fushës në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që vendimmarrja, menaxhimi dhe vlerësimi të jenë objektiv.

10.2. Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Divjakë të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

10.3. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat e nevojshme, për eliminimin e copëzimit të fondeve në procedurat e prokurimit publik.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, rezultoi se në 2 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbyshjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe shkronjën “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetin e institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, rezultoi se:

Në 8 raste nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit;

Në 9 raste dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit të përcaktuar në ftesën për ofertë, si dhe një rast nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion;

Në 6 raste OE shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret fituese të kërkuara nga AK;

Në 6 raste nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit nga operatori ekonomik, si dhe nuk janë llogaritur penalitetet për mosdorëzimin e mallit në afat sipas afatit të kontratave. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52. Gërma “dh”, “ë”, “gj” të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar. Shkronjën “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. Neni 12, 13 i Normave Teknike Profesionale për Arkivat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Kryetari Bashkisë Divjakë dhe komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që të dokumentojë çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve. Në rastet kur OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura nga AK, duhet të bëhet skualifikimi dhe kalimi tek operatori ekonomik i rradhës. Gjithashtu në rastet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, të bëhet verifikimi i formës dhe përmbajtjes së tij, si dhe të llogariten penalitetet për mos dorëzimin e mallit në afat sipas kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit: Shtesë anësore + shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat, me zhvillues A.M. adresë Tërbuf, Rikonstruksion dhe shtesë anësore + shtesë kati 1 kat, me zhvillues A.S. adresë Babunjë, Shtëpi banimi 1 kat në A.Z., adresë Divjakë, rezultoi se nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës.

2. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit: Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve buqësore, me zhvillues F.K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf si dhe Magazinë

bujqësore me zhvillues R. ShPK, adresë fshati Mizë, rezultoi se nuk është respektuar intesiteti i lejuar sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, të miratuar për lejet e ndërtimit.

3. Nga auditimi i lejes së ndërtimit: Godinë bujtinë 2 kate + papafingo, me zhvillues D.T., me adresë Kamenicë, Divjakë, rezultoi se nuk është marrë mendim pozitiv nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi” pika “ë”, neni 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës” dhe neni 38 “Intensiteti i ndërtimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 103-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga ana e DPZHKT, Bashkia Divjakë, të merren masa që në lejet e ndërtimit të respektohet distanca e lejuar nga kufiri i pronës, si dhe intesiteti i lejuar, sipas planit të përgjithshëm vendor dhe legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejes së ndërtimit “Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore me zhvillues F.K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf”, rezultoi se:

1. Objekti i ndërtuar nuk ka zbatuar plotësisht projektin e miratuar, duke u pajisur dhe me Certifikatë përdorimi, në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27 “Certifikata e përdorimit”.

2. Në lidhje me zbatimin e projektit të miratuar u konstatuan ndryshime në fasadë dhe volume, konkretisht në pjesën anësore nuk është respektuar vendosja e dritareve sipas projektit të miratuar dhe në fasadën ballore, në pjesën e majtë ka një shtesë volumi e cila nuk paraqitet në projektin e miratuar. Nga ana e IMT Bashkia Divjakë nuk është mbajtur asnjë procedurë në lidhje me këto ndryshime të projektit të miratuar me zbatimin e tij në terren në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 103-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga ana e DPZHKT, Bashkia Divjakë, të merren masa për të mos miratuar certifikatë përdorimi për objekte të cilat nuk kanë respektuar projektin e miratuar.

14.2. Rekomandimi: Nga ana e IMT të merren masa për tu inspektuar të gjithë objektet të cilat janë me leje ose pa leje ndërtimi dhe të vazhdojë procedurat ligjore për objektet të cilat kanë shkelur lejen e ndërtimit dhe ato pa leje.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 57 rekomandime të dhëna janë pranuar plotësisht nga subjekti, ndërsa 28 rekomandime ose 49% prej tyre janë zbatuar.

Nga 20 masa organizative të rekomanduara janë zbatuar 8, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces zbatimi 4 dhe nuk janë zbatuar 6 prej tyre.

Nga 2 masa për shërblim dëmi të rekomanduara në vlerën 9,867 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, por nuk janë zbatuar.

Nga 6 masa për eliminimin e efekteve negative financiare në menaxhimin e fondeve publike të rekomanduara në vlerën 552,673 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, 1 masë është zbatuar, 2 janë në proces zbatimi në vlerën 481,313 mijë lekë, 1 masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 28,000 mijë lekë dhe 2 masa nuk janë zbatuar në vlerën 120,000 mijë lekë.

Nga 19 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 19.

Nga 10 masa administrative të rekomanduara në vlerën 6,100 mijë lekë, në zbatim të shkresës së APP për mangësi të evidentuara, rezulton se nga titullari i institucionit nuk janë nxjerrë

urdhërat për arkëtimin vullnetar të gjobave, si dhe nuk janë marrë masat për arkëtimin e vlerës, rekomandimi nuk është zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 107-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 686/22 datë 07.01.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Divjakë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Menjëherë

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatesisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 174 qytetarë me vlerë totale **8,009,732 lekë**, ndërsa për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin 25 qytetarë me vlerë totale **1,091,511 lekë**. Gjithashtu, nuk kanë paguar ende detyrimin 416 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 me vlerë totale **14,144,742 lekë**. **Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi në 23,245,985 lekë për 615 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021”, dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masat e duhura ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 615 debitorë në vlerën 23,245,985 lekë**, si dhe në vijimësi për të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Divjakë rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën **86,473,273 lekë** dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifatat për personat fizikë/juridikë, detyrimet nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet dhe detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e vaditjes.

Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive në Bashkisë Divjakë më datë **31.12.2021** janë në vlerën **440,270,998 lekë**.

Më datë **30.09.2022** janë në vlerën **507,492,800 lekë** të përbëra nga:

- Detyrime për taksën e ndërtesës në vlerën **31,869,336 lekë**;

- Detyrime për taksën e tokës bujqësore në vlerën **326,826,181 lekë**;
- Detyrime nga taksa e truallit në vlerën **1,204,743 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **32,823,179 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **8,664,192 lekë**;
- Detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.) në vlerën **104,945,289 lekë**;
- Detyrime nga tarifa e ujitjes në vlerën **409,050 lekë**.

Gjithashtu, nga auditimi rezulton se deri më datë 31.12.2021 shuma e arkëtuar nëpërmjet Ujësjetllës Kanalizime SH.A Divjakë në rolin e agjentit tatimor të bashkisë është 1,368,100 lekë dhe detyrime progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë **1,754,400 lekë**. Deri më datë 30.09.2022 sipas akt rakordimit shuma e arkëtuar për taksat e bashkisë është 1,033,000 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë në vlerën **2,684,100 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën totale **507,492,800 lekë**, e përbërë nga:

- **31,869,336 lekë** detyrime për taksën e ndërtesës;
- **326,826,181 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore;
- **1,204,743 lekë** detyrime nga taksa e truallit;
- **32,823,179 lekë** detyrime nga biznesi i vogël;
- **8,664,192 lekë** detyrime nga biznesi i madh;
- **104,945,289 lekë** detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.);
- **409,050 lekë** detyrime nga tarifa e ujitjes.

a- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DTAV të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DTAV të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Divjakë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për të koordinuar punën me strukturat e Ujësjetllësit me qëllim kalimin e detyrimeve që ky i fundit ka ndaj Bashkisë Divjakë për taksat dhe tarifave të arkëtuara për llogari të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi, ka lidhur 12 kontrata për dhënie me qira të tyre me qëllim krijimin e të ardhurave. Këto kontrata janë lidhur me afat kohor nga 1-20 vjet. Nga auditimi rezulton se pagesat e qirasë për vitin 2021 janë kryer rregullisht nga të gjithë qiramarrësit, ndërsa për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë 4 qiramarrës (P.M., H.M., L. SHPK, F.S.), me **vlerë totale të detyrimit 1,159,880 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kushteve të kontratave përkatëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Divjakë të marrë masa që qiramarrësit P.M., H.M., L. SHPK, F.S. të zbatojnë me përpikmëri kushtet e kontratave me qëllim pagesën e detyrimeve për qiranë në afat. Për qiramarrësit që tejkalojnë afatet e pagesës të aplikohet kamata vonesa referuar kushteve të kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Divjakë, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 19 subjekte. Këto subjekte përpara fillimit të aktivitetit pajisen me autorizimet përkatëse, referuar kuadrit ligjor në fuqi për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje. Lidhur me pagesën e autorizimit Bashkia Divjakë përgjithësisht për subjektet që nuk kanë paguar menjëherë të gjithë vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite, ka ndjekur praktikën e pagesës me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë duke i pajisur ato me autorizime 1 vjeçare.

Nga auditimi rezulton se:

6. Subjekti “M.” është pajisur me autorizim 5 vjeçar më datë 11.02.2020 dhe është dakordësuar për të kryer pagesën e autorizimit me këste vjetore 200,000 secili. Nga auditimi rezulton se, subjekti ka kryer vetëm një pagesë deri në Nëntor 2022 nga 3 pagesa që duhet të bënte. Vlera totale e detyrimit ndaj Bashkisë Divjakë është **800,000 lekë**.

7. Subjekti “K.O. SHPK” ka qenë i pajisur me autorizim deri më datë 04.12.2020 në vijim nuk është pajisur me autorizim të ri për ushtrimin e aktivitetit. Subjekti “K.O. SHPK” ka paguar një vlerë prej 100,000 lekë në vitin 2022 por nuk është pajisur me autorizim. Detyrimet që ka ndaj bashkisë për autorizimin janë në vlerën **900,000 lekë**, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë. Për subjektin K.O. ShPk nga Bashkia Divjakë është dërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare në të gjitha bankat e nivelit të dytë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë është bllokuar aktiviteti me urdhrin nr. 180 datë 11.10.2022.

8. Subjekti “M.S.F. SHPK” nuk ka paguar vlerën prej **200,000 lekë** për vitin 2022.

9. Subjekti “L. ShPk” që nga viti 2020 nuk është i pajisur me autorizim, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën **1,000,000 lekë**. Për subjektin L. ShPk është dërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare të gjitha bankave të nivelit të dytë, si dhe është bërë bllokimi i aktivitetit nga Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore me urdhrin nr. 182 datë 11.10.2022.

Për periudhën objekt auditimi është konstatuar se subjektet “M.”, “K.O. SHPK”, “M.S.F. SHPK”, “L. ShPk” kanë ushtruar aktivitet në kundërshtim me përcaktimet ligjore duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën totale 2,900,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e gjyqësore në arkëtimin e vlerës 1,000,000 lekë, nga e cila:

- Vlera 800,000 lekë në ngarkim të subjektit “M.”.
- Vlera 200,000 në ngarkim të subjektit “M.S.F. SHPK”.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Juridik Bashkia Divjakë, të ndjekin të gjitha hapat ligjore ndaj subjekteve “K.O. SHPK” dhe “L. ShPk” me qëllim fillimin e aktivitetit vetëm pas pajisjes me autorizimin përkatës dhe kryerjes së pagesave për llogari të bashkisë për shumën 1,900,000 lekë, nga e cila:

- Vlera 900,000 lekë nga subjekti “K.O. SHPK”.
- Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “L. SHPK.

Menjëherë

4.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të ndërpresë praktikën e ndarjes e këste të pagesës së tarifës për licencat/autorizimet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Divjakë gjatë vitit 2021 ka konstatuar 23 raste të shkeljes së legjislacionit në fushën e mbrojtjes së territorit. Për këto raste janë mbajtur proces verbalet përkatëse të konstatimit të kundërvajtjes ku në 22 raste është vendosur masa administrative “gjobë” me vlerë 500,000 lekë për secilin kundërvajtës, ndërsa në 1 rast është marrë vendim për pezullim punimesh. Vlera totale e gjobave të vendosura është 11,000,000 lekë. Për gjobat e vendosura në vitin 2021 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, Kryeinspektori i IMTV në bashkëpunim me Sektorin Juridik nuk ka ndjekur procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimin e tyre. Përkatësisht, IMTV dhe Sektori Juridik nuk kanë “dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë”, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, rrjedhimisht nuk kanë ndjekur as hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë. Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, në vlerën 6,600,000 lekë. Si rezultat, **për vitin 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 17,600,000 lekë (11,000,000 nga gjobat dhe 6,600,000 nga kamatëvonesat).**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të ndjekin të gjitha hapat për të dërguar në gjykatë 22 gjobat e vendosura me qëllim shndërrimin e tyre në “titull ekzekutiv”, si dhe të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitin 2021 në vlerën **11,000,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Divjakë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. **Znj. F.M.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së financës dhe buxhetit, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me planifikimin dhe realizimin e buxhetit, si dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

2. **Z. P.T.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Inventarëve, për problemet e konstatuara në lidhje me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe në lidhje me problemet e konstatuara në blerjet me vlerë të vogël;
3. **Znj. Zh.A.**, me detyrë specialiste në sektorin e auditimit të brendshëm, (*nga data 01.07.2021 deri më 02.03.2022 ka qenë specialist finance në Njësinë Administrative Tërbuf, nga data 03.03.2022 e në vazhdim specialiste auditit*), për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm;
4. **Z. F.V.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në pesë procedura prokurimi, si dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;
5. **Z. R.B.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Tërbuf, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;
6. **Z. D.Q.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Gradishtë, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;
7. **Z. Xh.M.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Remas, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;
8. **Z. E.M.**, me detyrë Inspektor i Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;
9. **Z. J.Z.**, me detyrë Inspektor i Vlerësimit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;
10. **Z. A.B.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, për veprimet dhe mosveprimet në aktivitetin e IMTV-së, si dhe për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në dy procedura prokurimi;
11. **Znj. S.SH.**, me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike, në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kritereve jo në përputhje me natyrën e kontratës në tre procedura prokurimi, si dhe për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në dy procedura prokurimi;
12. **Z. E.H.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të zbatimit të Projekteve dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kritereve jo në përputhje me natyrën e kontratës në tre procedura prokurimi, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në dy procedura prokurimi, për problemet e konstatuara në blerjet me vlerë të vogël, si dhe për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
13. **Znj. L.T.**, me detyrë Specialiste e Projekteve dhe Investimeve, në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kritereve jo në përputhje me natyrën e kontratës në një procedurë prokurimi, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në dy procedura prokurimi si dhe për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
14. **Znj. I.K.**, me detyrë Specialiste Buxheti, në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kritereve jo në përputhje me natyrën e kontratës në një procedurë prokurimi;
15. **Znj. V.L.**, me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike, në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kritereve jo në përputhje me natyrën e kontratës në dy procedura prokurimi, si dhe për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në një procedurë prokurimi;

16. **Znj. A.J.**, me detyrë Inspektore e Taksave Vendore dhe Kadastres Fiskale, në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës në një procedurë prokurimi;
17. **Znj. E.Z.**, me detyrë Specialiste Juriste, për problemet e konstatuara në blerjet me vlerë të vogël;
18. **Znj. E.M.**, me detyrë Inspektore Biznesi, për problemet e konstatuara në blerjet me vlerë të vogël;
19. **Znj. E.D.**, me detyrë Specialiste Juriste, për problemet e konstatuara në blerjet me vlerë të vogël;
20. **Znj. J.L.**, me detyrë Inspektore Biznesi, për problemet e konstatuara në blerjet me vlerë të vogël;
21. **Z. S.T.**, me detyrë Specialist Inxhinier, për problemet e konstatuara në blerjet me vlerë të vogël;
22. **Znj. A.L.**, me detyrë Specialiste Inxhiniere, për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “*Masa Disiplinore*”, kontratën individuale të punës, neni 8 “*Masat Disiplinore*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Divjakë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse nga “*Vërejtje*” deri në “*Zgjidhje e kontratës së punës*”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. **Znj. A.M.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, (nga data 01.07.2021 deri më 06.02.2022 ka qënë specialiste menaxhimit të burimeve njerëzore, nga data 07.02.2022 e në vazhdim është drejtore e burimeve njerëzore dhe shërbimeve të brendshme), për problemet e konstatuara në lidhje me Menaxhimin financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;
2. **Z. R.M.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore, (nga data 01.07.2021 deri në datën 31.01.2022 ka qënë përgjegjës sektori i vlerësimit dhe kontrollit, nga data 01.02.2022 e në vazhdim drejtor i drejtorisë së taksave e të ardhurave vendore), për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor, si dhe në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës në dy procedura prokurimi;
3. **Znj. E.H.**, me detyrë Inspektore e Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Grabian, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;
4. **Z. I.K.**, me detyrë Punonjës i Menaxhimit të Mjeteve, (nga data 01.07.2021 deri në datën 17.01.2022 ka qënë Inspektor IVMT, nga data 18.01.2022 deri në datën 30.09.2022 ka qënë Kryeinspektor IVMT dhe nga data 03.10.2022 është punonjës i menaxhimit të mjeteve), për veprimet dhe mosveprimet në aktivitetin e IMTV-së, për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;
5. **Z. D.S.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës dhe Aseteve, në lidhje me problemet e konstatuara për vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës në një procedurë prokurimi;

6. **Znj. E.N.**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 31.01.2022, ka qënë specialiste e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nga data 01.02.2022 e në vazhdim është drejtore e drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit), në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në një procedurë prokurimi, për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

C. 3. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

1. **Znj. A.S.**, me detyrë ish Përgjegjëse e sektorit të auditimit të brendshëm, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, si dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;
2. **Z. R.L.**, me detyrë ish Kryeinspektor pranë Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 16.01.2022 ka qënë Kryeinspektor IVMT, në datën 17.01.2022 largohet nga puna), për veprimet dhe mosveprimet në aktivitetin e IMTV-së;
3. **Z. L.Xh.**, me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 31.01.2022 ka qënë drejtor i Drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në datën 01.02.2022 është larguar nga puna) për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. **Z. L.M.**, me detyrë Inspektor pranë Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 16.01.2022 ka qënë Kryeinspektor IMTV, në datën 17.01.2022 është larguar nga puna.) për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
5. **Z. S.M.**, me detyrë Inspektor pranë Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 16.01.2022 ka qënë Kryeinspektor IMTV, në datën 17.01.2022 është larguar nga puna) për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
6. **Z. Xh.K.**, me detyrë Kryeinspektor pranë Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 16.01.2022 ka qënë Kryeinspektor IMTV, në datën 17.01.2022 është larguar nga puna) për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

D. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Divjakë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecuresë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHITIT